

KOMENTIMI I XHUZIT AMME

Ligjëroi: Hoxhë Lulzim Perçuku

Transkriptoi: Albiona Olluri

Kopertina: Florentina Sadiku

Surja Nebe – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ○ عَنِ النَّبَاِ الْعَظِيمِ ○ الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ○ كَلَّا
سَيَعْلَمُونَ ○ ثُمَّ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ○ أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهْدًا ○ وَالْجِبَالَ
أَوْتَادًا ○ وَخَلَقْنَاهُ أَرْوَاجًا ○ وَجَعَلْنَا نُومَكُمْ سُبَاتًا ○ وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا ○
وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا ○ وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا ○ وَجَعَلْنَا سِرَاجًا
وَهَّاجًا ○ وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا ○ لَنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا ○
وَجَبْتِ أَلْفَافًا ○ إِنَّ يَوْمَ الْفَصْلِ كَانَ مِيقَاتًا ○ يَوْمَ يُنفَخُ فِي الصُّورِ
فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا ○ وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ أَبْوَابًا ○ وَسُيِّرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ
سَرَابًا ○ إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا ○ لِلطَّغْيِينَ مَبَاٍ ○ لَّيْسِينَ فِيهَا أَحْقَابًا ○
لَا يَدْخُونَ فِيهَا بُرْدًا ○ وَلَا شَرَابًا ○ إِلَّا حَمِيمًا ○ وَغَسَّاقًا ○ جَزَاءً ○ وَفَاقًا ○
○ إِنْهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا ○ وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كَذَابًا ○ وَكُلُّ شَيْءٍ
أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا ○ فَدُوقُوا فَلَنْ نَزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا ○ إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا ○
حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا ○ وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا ○ وَكَأَسَاءَ دِهَاقًا ○ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا
لُغْوًا ○ وَلَا كَذِبًا ○ جَزَاءً ○ مِنَ رَبِّكَ عَطَاءً حِسَابًا ○ رَبِّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ
وَمَا بَيْنَهُمَا ○ الرَّحْمَنُ ○ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا ○ يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ
صَفًّا ○ لَا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ ○ الرَّحْمَنُ ○ وَقَالَ صَوَابًا ○ ذَلِكَ ○ الْيَوْمُ ○ الْحَقُّ ○
فَمَنْ شَاءَ ○ اتَّخَذْ إِلَىٰ رَبِّهِ مَآبًا ○ إِنَّا ○ أَنْذَرْنَاهُ ○ عَذَابًا ○ قَرِيبًا ○ يَوْمَ يَنْظُرُ ○ الْمَرْءُ
مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ ○ وَيَقُولُ ○ الْكَافِرُ ○ يَلَيْتَنِي ○ كُنْتُ تَرَبًّا ○

1. Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin?
2. Për Lajmin e madh,
3. rreth të cilit ata kanë kundërshtime.
4. Ani, shpejt do ta marrin vesh!
5. Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!
6. A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat
7. e malet si shtylla?!
8. Ne ju kemi krijuar në çifte

9. dhe gjumin jua kemi bërë për prehje.
10. Natën jua kemi bërë mbulesë,
11. ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar.
12. Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë
13. dhe kemi vënë kandil (diell) të shndritshëm!
14. Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme
15. për rritjen e drithërave, bimëve
16. dhe të kopshteve të dendura.
17. Sigurisht, Dita e Ndarjes vendimtare është caktuar.
18. Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe.
19. Dyert e qiellit do të hapen
20. dhe malet do të shtyhen tutje e do të bëhen si mirazh.
21. Me të vërtetë, Xhehenemi do të bëhet pusi,
22. vendbanim i caktuar (vendkthim) për ata që kanë tejkaluar kufijtë,
23. që aty të mbeten për kohë të gjatë (përgjithmonë).
24. Aty nuk do të shijojnë as freski, as pije,
25. përpos ujit të valuar dhe qelbësirave,
26. si shpërblim përkatës (të veprave të tyre).
27. Në të vërtetë, ata as që e çonin nëpër mend se do të jepnin llogari
28. dhe shpalljet Tona i mohonin prerazi.
29. Por Ne çdo gjë e kemi shënuar në një libër (Leuhi Mahfudh).
30. Prandaj do t'u themi: "Shijojeni këtë! Ne nuk do t'ju shtojmë gjë tjetër përveçse dënim!"
31. Vërtet, për të devotshmit do të ketë fitore të shumta:
32. kopshte dhe vreshta,
33. vajza të reja, të së njëjtës moshë,

34. dhe kupa të plota.

35. Atje nuk do të dëgjojnë biseda të kota e as gënjeshtër.

36. Kështu është shpërblimi nga Zoti yt - dhuratë sipas meritës

37. Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, i Gjithëmëshirshmi, të Cilit askush nuk do të mund t'i flasë (nga frika).

38. Në ditën, kur Shpirti (Xhebraili) dhe engjëjt do të jenë të rreshtuar, nuk do të flasë askush, përveç atij që do t'i japë lejë i Gjithëmëshirshmi e që do të thotë të vërtetën.

39. Ajo është Dita e Vërtetë, prandaj kush të dojë, le të kthehet te Zoti i vet (që në këtë jetë).

40. Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: "Ah, sikur të isha pluhur!"

Komentimi

“عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ - Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin?” – ata që e përgënjeshtrojnë Kuranin dhe njerëzit e tjerë në përgjithësi.

“عَنِ النَّبِإِ الْعَظِيمِ - Për Lajmin e madh” – Allahu i përgjigjet kësaj pyetje. Ky lajm është ai me të cilin ka ardhur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Është për qëllim argumentet e qarta dhe udhëzimi të cilin e ka sjell ai. Sidomos lajmet që kanë të bëjnë me Ditën e Gjykimit, ringjalljen dhe shpërblimin.

“الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ” - **rreth të cilit ata kanë kundërshtime**” – Prej njerëzve ka që e kanë besuar këtë lajm, ka që e kanë mohuar e ka që janë në mëdyshje rreth tij.

“كَلَّا سَيَعْلَمُونَ” - **Ani, shpejt do ta marrin vesh!**” – Një ditë do ta dinë bindshëm, me bindje të plotë, se ai Lajm që e ka sjell Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka qenë i vërtetë. Kjo është dita kur e shohin me sytë e tyre Ditën e Gjykimit. Me këtë ajet Allahu i kërcënon ata që e kanë përgënjeshtuar Lajmin.

“ثُمَّ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ” - **Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!**” – Konfirmim (në aspektin kuptimor).

Pas kësaj, Allahu fillon të numërojë mirësitë që ua ka dhënë njerëzve – robërve të Tij, duke i detyruar ta falënderojnë Atë dhe ta dinë se Ai ua ka dhënë ato.

“أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهْدًا” - **A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat**” – E ka bërë tokën të përshtatshme për njerëzit, në dobi të tyre; nuk e ka bërë as të fortë (duke mos arritur ta punojnë apo të mos mundin të ecin mbi të), nuk e ka bërë të butë (duke mos pasur dobi prej saj apo duke mos mundur të qëndrojnë mbi të).

“وَالْجِبَالِ أَوْتَادًا” - **e malet si shtylla?!**” – Malet për tokën janë sikur shtyllat që mbajnë ndërtesën, shtëpinë etj. Përmes tyre toka qëndron e palëvizshme. Edhe nëse është erë e fortë, nuk mundet t'i luhatë ato. Kjo tregon për përsosmërinë e forcës së Allahut dhe se Ai e ka plotësuar këtë mirësi ndaj njerëzve.

وَخَلَقْتُمْ أَزْوَاجًا - **Ne ju kemi krijuar në çifte**” – Allahu i ka krijuar njerëzit në lloje të ndryshme. Ka meshkuj, ka femra, ka të vegjël, të mëdhenj, të zi, të kuq, të bardhë, kjo sipas urtësisë së Allahut, i Cili dëshiron që njeriu të marrë mësim dhe ta njohë Fuqinë e Tij. Allahu, prej një njeriu të vetëm – Ademit, ka nxjerr njerëz të ndryshëm e të shumëllojshëm.

وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا - **dhe gjumin jua kemi bërë për prehje**” – Subete ka kuptimin e ndërprerjes së lodhjes. Njeriu kur të lodhet dhe bie të flejë, gjen prehje dhe i largohet ajo. Nëse nuk fle, i shtohet lodhja. Kjo është një mirësi e madhe për njerëzit. Kjo është prej argumenteve të Allahut. Secili njeri duhet të meditojë rreth kësaj. Allahu thotë në një ajet: “**Të tjera shenja të Tij janë gjumi jua natën...**” Rum 23.

وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا - **Natën jua kemi bërë mbulesë**” – sikur një rrobë me të cilën vishet toka.

وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا - **ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar**” – Dita është koha kur kërkohet furnizimi, përmes të cilit ne vazhdojmë të jetojmë. Edhe kjo është një prej mirësive të shumta.

وَبَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا - **Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë**” - qiej të ashpër, të fortë.

وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا - **dhe kemi vënë kandil (diell) të shndritshëm!**” – një kandil që digjet, jep dritë. Qëllimi është për diellin. Ai është sikurse kandili apo llamba, që ndriçon dhe digjet. Dielli vazhdimisht lëshon nxehtësi. E megjithatë, Allahu e ka bërë që njeriu të ketë dobi të shumta prej diellit.

Pas kësaj, Allahu menjëherë përmend një gjë të kundërt me të, e cila ka freski dhe lagështi: shiu.

“وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرِ مَاءً ثَجَّاجًا” - **Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme**” - Shiu, pas nxehtësisë së diellit, e freskon ajrin dhe e lag tokën, dhe përmes tij pastaj ngjallet toka e mbinë bimët e shumta. Allahu në ajet tregon se ky shi zbret prej reve ashtu siç del uji prej rrobës kur shtrydhet. Shiu është brenda reve dhe pastaj zbret në tokë.

“لِنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا” - **për rritjen e drithërave, bimëve**” - Përmes shiut, Allahu e ka bërë të mbinë llojet e kokrrave/drithërave dhe bimëve (që nuk janë kokrra).

“وَجَنَّتِ الْأَفَّا” - **dhe të kopshteve të dendura**” – Për shkak të shiut të cilin e zbret Allahu, ato aq shumë rriten dhe zgjaten saqë e mbulojnë njëra-tjetrën, dhe njeriu kur është nën to është sikur nën një strehë që nuk laget nga shiu. Prej një shiu (dhe ujit të lumenjve apo përroskave që burojnë prej tokës), Allahu ka bërë që të mbinë bimë të llojllojshme e të ndryshme nga njëra-tjetra. Kjo është një prej mrekullive të Tij.

Pasi Allahu përmendi mirësitë që ia ka dhënë njerëzve në këtë botë, atëherë përmend gjendjen e njerëzve në Ditën e Gjykimit.

“إِنَّ يَوْمَ الْفَصْلِ كَانَ مِيقَاتًا” - **Sigurisht, Dita e Ndarjes vendimtare është caktuar**” – Dita e Gjykimit. Është quajtur Dita e Ndarjes sepse Allahu do të ndajë dhe do të gjykojë mes robërve të Tij (secili do të marrë të drejtën që i takon), gjithashtu do të ndajë pasuesit e së vërtetës dhe të kotës, do të ndajë ata që kanë bërë padrejtësi nga ata që kanë qenë të

drejtë. Në përgjithësi Allahu do t'i ndajë njerëzit në dy grupe të mëdha: banorët e Xhenetit dhe banorët e Xhehenemit. Kjo Ditë është e Caktuar, atë Allahu e ka caktuar për shpërblim (secili do të marrë shpërblimin për atë që ka vepruar, nëse ka vepruar keq do të dënohet e nëse ka vepruar mirë do të shpërblehet). Po ashtu kjo Ditë patjetër se do të ndodhë, nuk shtyhet dhe nuk përshpejtohet për asnjë moment. Njeriu duhet të meditojë rreth kësaj Dite të Caktuar, të cilës për çdo ditë i afrohet.

“يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا” – Atë Ditë do të fryhet në Sur dhe ju do të vini grupe-grupe” – Engjëlli i ngarkuar me detyrën e fryrjes në Sur është Israfil. Ai do t'i fryjë Surit në herën e parë dhe të gjithë njerëzit (prej zërit të madh) do të vdesin. Ndërsa, do t'i fryjë Surit në herën e dytë dhe të gjithë njerëzit do të ringjallen për të dalë para Allahut. Qëllimi me këtë ajet është fryrja e dytë në Sur. Secili grup do të vijë në këtë qëndrim madhështor, ku toka do të rrafshohet e do të jetë si një fushë e shkretë (pa lugina e pa kodra) dhe njerëzit do të vijnë sipas Librit që u është zbritur.

“وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ أَبْوَابًا” – Dyert e qiellit do të hapen” – Qielli do të çahet dhe do të bëhen dyer të shumta, pasi ka qenë një kulm mbrojtës për tokën. Kjo tregon për madhësinë e fuqisë së Allahut. Më parë Allahu i përshkruajti qiejt se janë të fortë, e kur t'i shkatërrojë, do të hapen e do të duken sikur janë dyer të shumta.

“وَسُيِّرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ سَرَابًا” – dhe malet do të shtyhen tutje e do të bëhen si mirazh” – malet e kodrat do të lëvizin e do të

goditen me njëra-tjetrën dhe do të bëhen sikur pluhur, rërë, dhe do të jenë sikur një mirazh që shihet në shkretëtirë.

“إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا” – **Me të vërtetë, Xhehenemi do të bëhet pusi**” – Allahu do ta vendosë si pritë për jobesimtarët. Xhehenem është prej emrave të Zjarrit. Për shkak të thellësisë dhe errësirës së madhe është quajtur Xhehenem. Zjarri i ahiretit ka nxehtësi, por nuk bën dritë (në të është errësirë).

“لِلظَّالِمِينَ مَأْبَأٌ” – **vendbanim i caktuar (vendkthim) për ata që kanë tejkaluar kufijtë**” – Kufiri i njeriut është të adhurojë vetëm Allahun, pa i shoqëruar të tjerë, siç sqarohet tek ajeti: “Unë nuk i krijova xhindet dhe njerëzit përveçse që të më adhurojnë.” Dharijat 56. Nuk lejohet të tejkalohet ky kufi duke adhuruar dikë tjetër, apo duke neglizhuar obligimet, apo duke vepruar ndalesa e mëkate. Kush e tejkalon këtë kufi, atëherë xhehenemi do të jetë vendkthim për të. Njeriu mund të tejkalojë kufijtë edhe në raport me njerëzit e tjerë, si: duke iu bërë padrejtësi në pasuri e tyre, në jetën dhe nderin e tyre (këto janë të ndaluara).

Allahu e ka quajtur Xhehenemin vendkthim për të tillët, sepse kjo tokë nuk është vendqëndrimi, por është urë kalimi për në ahiret. Zjarri i xhehenemit kurrë nuk do të shuhet e nuk do të zhduket dhe banorët e tij do të jenë aty përgjithmonë. Është obligim të besojmë se Xheneti dhe Xhehenemi ekzistojnë qysh tani, janë të krijuara që tani dhe ato janë dy banesa të përhershme. Ai që hyn në xhenet, do të jetë përherë në të dhe kurrë nuk do të dalë prej aty. Ndërsa, në Xhehenem do të mbesin përherë jobesimtarët, mirëpo është një grup i njerëzve që do të hyjnë në

Xhehenem, por nuk do të mbesin përherë në të, ata janë: Mëkatarët prej besimtarëve- ata që kanë vdekur pa u penduar prej mëkateve, apo ata të cilëve Allahu nuk ua ka pranuar pendimin dhe dëshiron t'i ndëshkojë (për ato që kanë bërë). Këta do të futen në Xhehenem për aq sa dëshiron Allahu, pastaj përfundimi i tyre do të jetë Xheneti.

“لَبِثِينَ فِيهَا أَحْقَابًا” - **që aty të mbeten për kohë të gjatë (përgjithmonë)**” – Kjo kohë e gjatë nuk ka përfundim, ata do të jenë përherë në të (Xhehenem).

“لَا يَذُوقُونَ فِيهَا بَرْدًا وَلَا شَرَابًا” - **Aty nuk do të shijojnë as freski, as pije**” – Banorët e Xhehenemit nuk do të kenë freski prej jashtë e as nuk do të pinë diçka që ua freskon nxehtësinë e brendshme. Kur ata i kap etja e madhe, u jepet ujë i nxehtë sikur xehja e shkrirë, i cili ua përcëllon fytyrat dhe ua copëton zorrët.

“إِلَّا حَمِيمًا وَغَسَّاقًا” - **përpos ujit të valuar dhe qelbësirave**” – Nuk do të kenë asnjë pije tjetër përveç këtij uji të valuar dhe ujit me erë të keqe e të neveritshme e që është shumë i ftohtë, apo papastërtive/fëlliqësive që dalin prej banorëve të xhehenemit. Kur bashkohen këto lloje të ndëshkimeve, atëherë kjo tregon se ndëshkimi është shumë i madh për ata që janë banorë të xhehenemit.

“جَزَاءً وَفَاءً” - **si shpërblim përkatës (të veprave të tyre)**” – Allahu nuk u bën padrejtësi atyre, Ai nuk ka nevojë për robërit e Tij, Ai është i vetëmjaftueshëm. Por kjo gjë është shpërblim përkatës – në pajtueshmëri me veprat që kanë bërë. “Në të vërtetë, Allahu nuk u bën njerëzve asnjë të keqe, por njerëzit i bëjnë keq vetvetes.”. Junus 44.

“إِنَّهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا” - Në të vërtetë, ata as që e çonin nëpër mend se do të jepnin llogari” – Nuk e kanë çuar ndërmend se do të dalin para Allahut për të dhënë llogari, por e kanë ndje veten të lirë.

“وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كِذَابًا” - dhe shpalljet Tona i mohonin prerazi” – ka prej tyre që e kanë mohuar llogarinë me gojët e tyre.¹ Kanë mohuar se do të dalin para Allahut për të dhënë llogari, kanë thënë: “Kjo është gënjeshtër, çmenduri, këto janë trillime e përralla!” Edhe sot ka nga njerëzit të cilët përgënjeshtrojnë të Dërguarit e Allahut dhe Librat e zbritur.

“وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا” - Por Ne çdo gjë e kemi shënuar në një libër (Leuhi Mahfudh)” – Këtu hyjnë Veprat e Allahut – krijimi e drejtimi i universit dhe gjithashtu veprat e thëniet e njerëzve. “أَحْصَيْنَاهُ” - e ka llogaritur me llogaritje precize, të hollësishme, dhe e ka shënuar atë. Siç ka ardhur në hadith, Allahu çdo gjë që do të ndodhë e ka shkruar pesëdhjetë mijë vjet para se të krijoheshin qiejt e toka.

“فَذُوقُوا فَلَنْ نَزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا” - Prandaj do t’u themi: “Shijojeni këtë! Ne nuk do t’ju shtojmë gjë tjetër përveçse dënim!” – Kjo si poshtërim e nënçmim. Sikur u thuhet: Kurrë nuk do t’ua largojmë ndëshkimin e as nuk do t’ua lehtësojmë, përveçse do t’ua shtojmë atë.

Pastaj Allahu përmend shpërblimet dhe kënaqësitë e përgatitura për të devotshmit.

“إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا” - Vërtet, për të devotshmit do të ketë fitore të shumta (Xheneti)” – Të devotshmit janë ata që a kanë

¹ Edhe sot thonë “Me vdekjen përfundon çdo gjë!”

frikë ndëshkimin e Allahut, duke vepruar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave. Për ta Allahu ka përgatitur fitore.

Pastaj Allahu na sqaron një pjesë të kësaj fitore:

“حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا - **kopshte dhe vreshta**” – rrushi është pjesë e kopshtit, mirëpo Allahu e ka veçuar në këtë ajet në mesin e të gjitha gjërave që gjenden në kopsht, për të treguar vlerën e këtij fruti.

“وَكَوَاعِبَ أُنْرَابًا - **vajza të reja, të së njëjtës moshë**” – të cilave u dallohen gjokset. Kjo formë është pjesa më e përsosur e gjoksit të grave.

“وَكَأْسًا بِهَاقًا - **dhe kupa të plotë**” – të mbushura plotë, me verë.

“لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا كِدْبًا - **Atje nuk do të dëgjojnë biseda të kota e as gënjeshtër**” – Kur njeriu dehet flet fjalë të kota, andaj ato kupa edhe pse janë të mbushura me verë, nuk dehen ata që pinë prej tyre. Banorët e Xhenetit nuk gënjejnë. Allahu do të largojë urrejtjen apo zilinë apo xhelozinë prej zemrave të tyre ndaj njëri-tjetrit. Ata i bën vëllezër për njëri-tjetrin në kuptimin e plotë të fjalës.

“جَزَاءً مِّن رَّبِّكَ عَطَاءً حِسَابًا - **Kështu është shpërblimi nga Zoti yt - dhuratë sipas meritës**” – për shkak të veprave të mira që kanë bërë, për largimin nga ndalesat etj. Ai është shpërblim i mjaftueshëm (ato kupa të mbushura u mjaftojnë atyre ndaj pijeve të tjera).

“رَبِّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الرَّحْمَنُ ۖ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا - **Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, i Gjithëmëshirshmi, të Cilit askush nuk do të mund t'i**

flasë (nga frika)” – midis tokës e qiellit siç janë: retë, planetët, yjet dhe të tjera që i dimë apo që nuk i dimë. Allahu është Zoti i gjithçkaje, i tërë universit. Ai është err Rrahman – i Gjithëmëshirmi, Ai që posedon mëshirë gjithëpërfshirëse. Para Atij njerëzit nuk kanë mundësi të flasin përveçse me lejen e Tij. Kur njerëzit të dalin para Allahut në Ditën e Gjykimit askush nuk flet atë Ditë veçse me lejen e Tij.

يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا لَا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَقَالَ صَوَابًا - **Në ditën, kur Shpirti (Xhebraili) dhe engjëjt do të jenë të rreshtuar, nuk do të flasë askush, përveç atij që do t’i japë leje i Gjithëmëshirshmi e që do të thotë të vërtetën**” – Në Ditën e Gjykimit do të zbresin engjëjt e qiellit të dunjasë dhe do t’i rrethojnë krijesat. Pastaj do të vijnë engjëjt e qiellit të dytë pas tyre, e të qiellit të tretë, të katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë, të rreshtuar në rreshta, duke i rrethuar të gjithë njerëzit e xhindet që janë duke pritur të fillojë gjykimi. Numrin e shumtë të engjëjve nuk e di askush përveç Allahut. Këta engjëj dhe çdokush tjetër, nuk do të flasë atë Ditë, përveçse me Lejen e Allahut, por me kusht që të flasë me fjalë të vërteta me të cilat Ai është i kënaqur. Qëllimi është se Allahu do t’i japë leje ndokujt prej njerëzve që të ndërmjetësojë për të tjerët, si: u jep leje engjëjve, Pejgamberëve etj. Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Allahu për ndokënd veçse me lejen e Tij dhe për aq sa i jep leje Ai.

ذَٰلِكَ الْيَوْمُ الْحَقُّ ۖ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ مَآبًا - **Ajo është Dita e Vërtetë, prandaj kush të dojë, le të kthehet te Zoti i vet (që në këtë jetë)**” – Këto gjëra do të ndodhin vërtetë në Ditën e

Gjykimit. Allahu na tregon se ajo Ditë është e Vërtetë, e kush dëshiron le të veprojë vepra të mira duke u kthyer tek Ai dhe me të cilat është i kënaqur.

“kush të dojë” – ne jemi të lirë të zgjedhim një rrugë, nuk jemi të detyruar, porse zgjedhja e dëshira jonë kthehet tek Allahu. Dëshira e njeriut është e ndërlidhur ngushtë me Dëshirën e Allahut, siç thotë: **“për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!”** Tekwir 28-29. Kjo na sqarohet në shumë vende në Kuran në mënyrë që njeriu të mos mbështetet në veten, forcat dhe dëshirat e tij. Ai duhet të kërkojë mbrojtje e strehim tek Allahu dhe ta lusë ta udhëzojë në rrugën të cilën e do Ai. Njeriu nuk mund të thotë “Jam i lirë, dëshiroj çfarë të dua!”, porse nuk ka mundësi të dëshirojë diçka veçse pasi atë gjë ta dëshirojë Allahu.

إِنَّا أَنْذَرْنَكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا يَوْمَ يَنْظُرُ الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ وَيَقُولُ الْكَافِرُ “**يَلَيْتَنِي كُنْتُ تُرْبًا**” - **Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç’kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: “Ah, sikur të isha pluhur!”** – Në këtë ajet, Allahu na tërheq vërejtjen ndaj një dënimi i cili është afër të ndodhë: Dita e Gjykimit. Edhe nëse kjo botë vazhdon të ekzistojë me miliona vite, prapëseprapë ajo Ditë është afër, ngaqë do të ndodhë një ditë (çdoherë i afrohemi asaj). **“duart e tij”** – qëllimi është se çfarë ka vepruar njeriu, jo vetëm duart e tij. Veprat e tij janë të shënuara në librin e tij të cilin do ta lexojë me sytë e tij. Atë Ditë kur jobesimtari të shohë vështirësitë e saj dhe dënimin e madh të përgatitur për jobesimtarët, do të

thotë: “**Ah, sikur të isha pluhur!**” – D.m.th.: sikur të isha dhé e të mos isha krijuar fare, apo sikur mos të isha ringjallur fare por të mbetesha dhé i varrit, apo sikur të isha si kafshët që pas gjykimit do të bëhen dhé.

Surja en Naziat – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالنَّازِعَاتِ غَرْقًا ۝ وَالنَّشِيطَاتِ نَشْطًا ۝ وَالسَّابِحَاتِ سَبْحًا ۝ فَالسَّابِقَاتِ سَبْقًا ۝
فَالْمُدَبِّرَاتِ أَمْرًا ۝ يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ ۝ تَتْبَعُهَا الرَّادِفَةُ ۝ قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ
أَبْصُرُهَا خَشِيعَةٌ ۝ يَقُولُونَ أَعْنَا لَمْرُدُونَ فِي الْحَافِرَةِ ۝ أَعْذَا كُنَّا عَظْمًا
نَّخْرَةً ۝ قَالُوا تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ ۝ فَاثْمًا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ ۝ فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ
۝ هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى ۝ إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِالْوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى ۝ أَذْهَبَ إِلَى
فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى ۝ فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَى أَنْ تَزَكَّى ۝ وَأَهْدِيكَ إِلَى رَبِّكَ فَتَخْشَى ۝
فَأَرَاهُ الْآيَةَ الْكُبْرَى ۝ فَكَذَّبَ وَعَصَى ۝ ثُمَّ أَذْبَرَ يَسْعَى ۝ فَحَشَرَ فَنَادَى ۝ فَقَالَ
أَنَا رَبُّكُمْ الْأَعْلَى ۝ فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْآخِرَةِ وَالْأُولَى ۝ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِمَنْ يَخْشَى
۝ ءَأَنْتُمْ أَشَدُّ خُلُقًا أَمْ السَّمَاءُ بَيْنَهُمَا ۝ رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّيَهَا ۝ وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا
وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا ۝ وَالْأَرْضُ بَعْدَ ذَلِكَ دَحُلًا ۝ أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا ۝
وَالْجِبَالُ أُرْسِلَهَا ۝ مَتَعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَمِكُمْ ۝ فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَةُ الْكُبْرَى ۝ يَوْمَ يَتَذَكَّرُ
الْإِنْسَانُ مَا سَعَى ۝ وَبُرَزَتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى ۝ فَأَمَّا مَنْ طَغَى ۝ وَءَاثَرَ الْحَيَاةَ
الدُّنْيَا ۝ فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَى ۝ وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ
الْهَوَى ۝ فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَى ۝ يُسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسِلُهَا ۝ فِيمَ
أَنْتَ مِنْ دَخْلِهَا ۝ إِلَى رَبِّكَ مُنْتَهِلُهَا ۝ إِنَّمَا أَنْتَ مُنْذِرٌ مَنْ يَخْشَاهَا ۝ كَانَتْهُمْ يَوْمَ
يُرُونَهَا لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا عَشِيَّةً أَوْ ضُحَاهَا ۝

1. Për ata (engjëj) që marrin me forcë,
2. për ata që marrin butësisht,
3. për ata që notojnë në hapësirë,
4. për ata që nxitojnë,
5. dhe për ata që i rregullojnë punët!
6. Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima (që lajmëron Kiametin),
7. e cila do ta ndiqet nga një e dytë,
8. disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr
9. e shikimet e tyre do të bien përdhe.
10. Ata thonë: "Vallë, vërtet do të rikthehemi në jetë?!"
11. A thua, edhe kur të bëhemi eshtra të thërrmuara?!"

12. Dhe thonë: “Po qe kështu, atëherë ky kthim do të jetë humbje (për ne)!”

13. Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme (e Surit)

14. dhe ata përnjëherësh do të brofin (të ringjallur) përmbi tokë (të rrafshët).

15. A e ke dëgjuar (o Muhamed) historinë e Musait?

16. Zoti i tij e thirri në luginën e shenjtë të Tuvas dhe i tha:

17. “Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi;

18. dhe thuaji: “A do ta pastrosh veten,

19. dhe të të udhëzoj te Zoti yt, që t’i frikësohesh?”

20. Musai ia tregoi mrekullinë më të madhe,

21. por ai (Faraoni) e mohoi dhe e kundërshtoi.

22. Pastaj i ktheu shpinën, duke u përpjekur (kundër së vërtetës)

23. dhe tuboi njerëzit e u deklaroi:

24. “Unë jam zoti juaj më i lartë!”

25. Prandaj Allahu e goditi atë me dënim në jetën tjetër dhe në këtë jetë. 26. Kjo është këshillë për ata që i frikësohen Allahut.

27. Cili është më i vështirë: krijimi i juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi,

28. ia ngriti lart kupën dhe e përsosi.

29. Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme.

30. Pastaj e shtriu rrafsh Tokën,

31. dhe, nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat,

32. kurse malet i bëri të patundshme,

33. që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja.

34. Kur të arrijë gjëma më e madhe,

35. atë Ditë njeriu do të kujtojë gjithçka që ka bërë
36. dhe Zjarri flakërues do t'i tregohet çdokujt që sheh.
37. Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka
38. dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote,
39. sigurisht që do të ketë për strehë Xhehenemin.
40. Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij
dhe e ka frenuar veten nga dëshirat,
41. pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.
42. Të pyesin ty për Orën (e Kiametit) se kur do të
ndodhë.
43. Po në çfarë gjendje je ti t'ua përkujtosh atë (se kur do
të ndodhë)?!
44. Tek Zoti yt është fundi i (dijenisë rreth) saj.
45. Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i frikësohen asaj.
46. Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t'u duket se
kanë qëndruar (në Tokë) veç një gjysmë dite.

Komentimi

وَالنَّارُ عَتِ غَرْفًا - **Për ata (engjëj) që marrin me forcë** – Naziat janë ata engjëj që janë të ngarkuar të marrin me forcë (me ashpërsi) shpirtrat e jobesimtarëve.

وَالنَّشِيطُ نَشِطًا - **për ata që marrin butësisht** – Këta janë të ngarkuar të marrin butësisht shpirtrat besimtarëve. I përgëzojnë (siç ka ardhur në hadith): **“O ti shpirt i mirë, dil për tek kënaqësia e Allahut!”** Dhe kështu shpirti do ta ketë më të lehtë të ndahet prej trupit me të cilin ka jetuar për një kohë të gjatë.

“وَالسَّحَابِ سَبَّحًا” - **për ata që notojnë në hapësirë**” – engjëjt, kur kryejnë urdhrat e Allahut duken sikur të notojnë nëpër qiell (veprojnë shumë shpejt).

“فَالسَّيِّدَاتِ سَبَّحًا” - **për ata që nxitojnë**” – engjëjt, kryejnë urdhrat e Allahut shumë shpejt, nxitojnë në kryerjen e tyre, më shpejt sesa njerëzit.

“فَالْمُدَبِّرَاتِ أَمْرًا” - **dhe për ata që i rregullojnë punët!**” – engjëjt, rregullojnë të gjitha çështjet/punët me të cilat i ngarkon Allahu, i binden plotësisht. Shembull: Xhibrili ka qenë i ngarkuar me zbritjen e shpalljes së Allahut tek të Dërguarit e Tij, Israfili është ngarkuar me fryrjen e Surit kur të ndodhë Kiameti, Mikaili është ngarkuar me vendosjen e çdo pike të shiut në tokë dhe me bimësinë, engjëlli i vdekjes është ngarkuar me marrjen e shpirtrave të njerëzve, Maliki është ngarkuar të mbikëqyrë zjarrin e xhehenemit, pastaj çdo njeri ka një engjëll në anën e djathtë e një në anën e majtë që shkruajë çfarë vepron etj.

Allahu u betua në engjëjt në këto ajete sepse janë krijesat më të mira. Kur Ai betohet në një krijesë, këtë e bën sepse çështja e asaj krijese është shumë madhore tek Ai apo sepse është prej argumenteve të Tij.

“يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ” - **Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima (që lajmëron Kiametin)**” – Kur t’i fryhet Surit. Pra, përkujtoje ti o Muhamed dhe përkujtoji njerëzit për këtë Ditë kur do të dridhet universi nga ushtima e madhe.

“تَتَّبِعُهَا الرَّاكِبَةُ” - **e cila do ta ndiqet nga një e dytë**” – Pas saj do të jetë edhe një tjetër ushtimë prej së cilës ringjallen njerëzit dhe ngritën prej varreve sikur të ishin një trup i vetëm.

Dhe njerëzit do të ndahen në dy grupe:

“فُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ” - **disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr**” -

“أَبْصُرُهَا خُشِعَةً” - **e shikimet e tyre do të bien përdhe**” – do të shikojnë vetëm përdhe, për shkak të poshtërimit që i kaplon atë Ditë.

Këto janë zemrat e jobesimtarëve.

“يَقُولُونَ أَعْنَا لَمَرْدُودُونَ فِي الْحَافِرَةِ” - **Ata thonë: “Vallë, vërtet do të rikthehem në jetë?!”** – Janë përqeshur me të Dërguarit e Allahut, kur ata kanë treguar për ringjalljen e njerëzve.

“أَعِدَّا كُنَّا عِظْمًا نَخِرَةً” - **A thua, edhe kur të bëhemi eshtra të thërrmuara?!”** – vazhdojnë me fjalët e tyre duke thënë: A po mendoni se do të ringjallemi prapë pasi të bëhemi eshtra të thërrmuara?

“قَالُوا تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ” - **Dhe thonë: “Po qe kështu, atëherë ky kthim do të jetë humbje (për ne)!”** – Në këtë formë janë përqeshur me të Dërguarit e Allahut.

Grupi i dytë janë të kundërtit e tyre, që janë besimtarët, për të cilët flasin ajete të tjera, mirëpo këtu nuk përmenden, por Fjala “**disa zemra**” tregon se atë Ditë do të ketë edhe zemra të tjera që nuk do ta përjetojnë atë nënçmim e poshtërim.

“فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ” - **Por, ajo do të jetë veç një fryrje e vetme (e Surit)**” – nga engjëlli të cilin e urdhëron Allahut të fryjë në Sur. Do të jetë një zë i tmerrshëm që do të dalë prej Surit.

“فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ” - **dhe ata përnjëherësh do të brofin (të ringjallur) përmbi tokë (të rrafshët)**” - dhe njerëzit

ringjallen sikur të ishin një njeri i vetëm, për në sipërfaqen e tokës pasi ishin në brendësinë e saj.

Pastaj Allahu i sqaron Muhamedit salAllahu alejhi ue selem se çfarë ka ndodhur me umetet e mëparshme.

“هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى - **A e ke dëgjuar (o Muhamed) historinë e Musait?**” – Ka ardhur kështu që të nxisë dëgjuesin për të dëgjuar me vëmendje se cila është kjo histori. Musai ka qenë i biri i Imranit. Ai ka qenë i Dërguari më i mirë e më i vlefshëm te Beni Israilët. Ai është njëri prej pesë të Dërguarve të cilët janë ulul azëm – të vendosur.² Allahu e përsëritë në Kuran historinë e Musait me bëni Israilët më shumë se historitë e tjera. Kjo sepse prej ithtarëve të Librit më së shumti jehudët kanë banuar në Medine dhe përreth saj në kohën e të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem.

“إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِالْأَوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى - **Zoti i tij e thirri në luginën e shenjtë të Tuvas dhe i tha**” – Allahu e ka thirr me zërin e Tij dhe Musai u ka dëgjuar zërin e Allahut, “**Ne e thirrëm atë nga ana e djathtë e malit Tur, duke e afruar në një bisedë të fshehtë**” Merjem 52. Allahu i ka folur direkt dhe Musai i ka dëgjuar Fjalët e Allahut.

“أَذْهَبَ إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى - **Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi**” – Faraoni ka qenë sunduesi i Egjiptit. Popullit të tij i ka thënë: “**O pari! Unë nuk di që për ju ka të adhurar tjetër përveç meje!**” Kasas 38. Kështu ka pretenduar për veten e tij, atë që nuk i takon, duke mohuar të drejtën e Allahut. Dhe Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij Musain alejhi ue selem të shkojë te Faraoni.

² Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, Ibrahim, Musai, Isai dhe Nuhu alejhimusselam.

Me këtë urdhër ai është bërë i Dërguar i Allahut. Allahu sqaron shkakun pse të shkojë te Faraoni, dhe arsyeja është sepse ai ka kaluar çdo kufi.

“فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَىٰ أَنْ تَزَكَّىٰ” – **dhe thuaji: “A do ta pastrosh veten”** – një pyetje për ta inkurajuar Faraonin. A do të pastrohesh prej të keqes, mosbesimit në të cilin gjendesh dhe mëkateve?

“وَأَهْدِكَ إِلَىٰ رَبِّكَ فَتُخَشَىٰ” – **dhe të të udhëzoj te Zoti yt, që t’i frikësohesh**” – të të orientoj tek Allahu, te feja e Tij, dhe në këtë mënyrë ta kesh frikë Allahun me dije.

“فَارَاهُ أَلْعَايَةَ الْكُبْرَىٰ” – **Musai ia tregoi mrekullinë më të madhe**” – Allahu i ka dhënë Musës mrekulli (prova) për të treguar se ai vërtetë është i Dërguar i Allahut. Mrekullitë e tij: shkopi prej druri, kur e ka hedhur në tokë është bërë gjarpër i gjallë, pasi ka qenë i ngurtë është bërë një gjë që ka shpirt, po ashtu kur e ka nxjerrë dorën i është bërë e bardhë, ka ndriçuar. Në kohën e Musait ka qenë shumë e përhapur magjia, njerëzit kanë bërë trika dhe magji të ndryshme, me to kanë mashtruar të tjerët, ka pasur shumë magjistarë. Dhe Allahu ka dashur t’iu tregojë me të njëjtën mënyrë se Musai është i Dërguar i Tij e nuk bën magji, por këto janë mrekulli e shenja prej Tij përmes së cilave ai do të arrijë të mposhtë magjistarët e Faraonit. Këto mrekulli pra kanë qenë të përshtatshme për kohën e tij.

“فَكَذَّبَ وَعَصَىٰ” – **por ai (Faraoni) e mohoi dhe e kundërshtoi**” – E megjithatë nuk u ka bërë dobi shfaqja e mrekullisë, “**Por shenjat dhe qortimet nuk u bëjnë kurrfarë dobie njerëzve që nuk besojnë**”. Junus 101. Ai mohoi dhe përgënjeshtroi lajmin me të cilin erdhi Musai, “(Faraoni) tha: “Me të

vërtetë, i Dërguari që ju është sjellë, është i çmendur". Shuara 27. Nuk i është bindur fesë me të cilën ka ardhur Musai.

“ثُمَّ أَدْبَرَ يَسْعَى” – Pastaj i ktheu shpinën, duke u përpjekur (kundër së vërtetës)” – Filloi të ecë me nguti dhe u largua.

“فَحَشَرَ فَنَادَى” – dhe tuboi njerëzit e u deklaroi” – i thirri me zë të lartë, kjo që ndalesa e tij të jetë më e fuqishme për mosbindjen ndaj Musait në atë që thërriste.

“فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَى” – “Unë jam zoti juaj më i lartë!” – Në arabisht fjala “el ala” tregon për superlative, pra nuk ka asnjë gjë që është më lartë sesa unë, kështu ka thënë Faraoni për veten e tij duke u treguar mendjemadh dhe arrogant. Ai ka pretenduar për një gjë që nuk i takon. **“Dhe Faraoni i thërriste popullit të vet: “O populli im! Vallë, a nuk më përket mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje? A nuk shihni? Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë...”** Zuhruf 51-52.

“فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ آلِ عَاثِرَةٍ وَالْأُولَى” - Prandaj Allahu e goditi atë me dënim në jetën tjetër dhe në këtë jetë” – E fundosi në ujin me të cilin lavdërohej, për të cilin thoshte se ishte nën sundimin e tij. Ai e ndëshkoi në këtë jetë, por do ta ndëshkojë edhe në jetën tjetër.

“إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّمَن يَخْشَى” - Kjo është këshillë për ata që i frikësohen Allahut” – Ngjarja e Faraonit u bë mësim për të tjerët. Ajo që ka ndodhur mes Musait dhe Faraonit, mendjemadhësia dhe mosbindja e tij, dhe se si ka qenë përfundimi, janë mësim për atë që i frikësohet Allahut.

Dobitë dhe mirësitë që përfitohen prej kësaj historie janë të shumta.

عَأَنْتُمْ أَشَدُّ خَلْقًا أَمْ السَّمَاءُ ۖ بَنَاهَا - **Cili është më i vështirë: krijimi i juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi**” – e sjell këtë pyetje që të vërtetojë dhe pohojë ringjalljen, sepse idhujtarët e Mekës e përgënjeshtrojnë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe e mohojnë ringjalljen. Ata kanë pyetur: **“Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?”** Ja Sin 78. Dhe Allahu u përgjigjet me pyetje (siç ka ardhur në këtë ajet). Krijimi i qiejve është më i rëndësishëm sesa i njeriut, **“Krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e di.”** Gafir 57.

رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّاهَا - **ia ngriti lart kupën dhe e përsosi**” – Allahu na tregon për madhësinë e qiellit. Ai i Cili e ndërtoi dhe e ngriti atë është vetë Allahu, Krijuesi absolut. Ai e ngriti kupën e tij lartë mbi tokë. Allahu i ka ngritur qiejt pa shtylla, ata qëndrojnë të ngritur pa pasur nevojë për shtylla, qëndrojnë me Fuqinë e Allahut.

وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا - **Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme**” – ditët i bëri të ndritshme përmes diellit.

وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَاهَا - **Pastaj e shtriu rrafsh Tokën**” – pas krijimit të qiejve dhe të tokës, qëllimi **“e shtriu rrafsh”** është siç vijon ajeti: **“nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat”**. Toka është krijuar para qiejve: **“e ka krijuar Tokën në dy ditë”**, pastaj tregon: **“Pastaj Ai iu kthye qiellit”** Ajeti 9 dhe 11. Mirëpo, Allahu pas krijimit të qiellit e bëri tokën dehahë – e shtriu rrafsh (nxori prej saj ujërat dhe bimësinë), e rregulloi tokën, e bëri të ketë ujë, burime e bimësi në të.

“أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا - dhe, nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat”.

“وَالْجِبَالِ أَرْسَاهَا - kurse malet i bëri të patundshme” – të paluhatshme prej erërave, që të mos i nxjerrin prej vendit, gjithashtu malet mbajnë tokën e nuk e lënë të lëvizë/tundet.

“مَتَّعَا لَكُمْ وَلَئِنْ كُنْتُمْ تُشْكِرُونَ - që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja” – e ka bërë tokën të atillë që njerëzit dhe bagëtitë e tyre t’i gëzohen të mirave të saj. Allahu e ka bërë tokën kënaqësi për ne. Prej saj hamë dhe pimë, gjithash dhe bagëtitë tona, dhe përmes saj shtojmë pasurinë tonë.

Pasi Allahu përmend këto mirësi të shumta për njerëzit, të cilat tregojnë për përsosmërinë e Fuqisë dhe të Mëshirës së Tij, përmend përfundimin e vulosur për njerëzit dhe krijesat e vendosura në tokë.

“فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَةُ الْكُبْرَى - Kur të arrijë gjëma më e madhe” – Në Ditën e Kiametit. Atë e quan Taammeh – Gjëma që përfshin çdo gjë dhe e shkatërron çdo gjë që është në univers.

“يَوْمَ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ مَا سَعَى - atë Ditë njeriu do të kujtojë gjithçka që ka bërë” –do ta gjejë çdo gjë të shkruar në Libër para vetes, do ta lexojë e do t’i bien ndërmend veprat që ka bërë në këtë dunja, shumë prej të cilave i ka harruar, “Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t’i themi): “Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” Isra 13-14.

“وَبُرُزَّتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى - dhe Zjarri flakëruet do t’i tregohet çdokujt që sheh” – Xhehenemi do të sillet me 70.000 litarë

dhe çdo litar do të ketë nga 70.000 engjëj që e tërheqin atë dhe e sjellin në vendin ku do të gjykojnë njerëzit.

“فَأَمَّا مَنْ طَغَى” – Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka – ka tejkalluar kufijtë e vendosur prej Allahut për njerëzit. Ai që parapëlqen jetën e kësaj bote (përmendet në ajetin vijues) gjithsesi do të tejkalojë kufijtë dhe anasjelltas. Këto dy cilësi tërheqin njëra-tjetrën. Allahu thotë: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.”** Dharijat 56. Ai që adhuron dikë tjetër përveç Allahut, ka tejkalluar kufirin e vendosur prej Allahut për njerëzit. Allahu nuk i ka krijuar njerëzit vetëm që të hanë, të pinë, të kënaqen etj. Por i ka krijuar që ta adhurojnë Atë, andaj duhet ta realizojnë këtë qëllim. Nëse ata nuk e adhurojnë Allahun, apo i shoqërojnë të tjerë në adhurim, atëherë kanë tejkalluar kufijtë.

“وَعَاثَرَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا” – dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote – i ka dhënë përparësi kësaj bote ndaj bindjes dhe adhurimit ndaj Allahut.

Këto janë dy cilësi janë prej cilësive të banorëve të xhehenemit.

“فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَى” – sigurisht që do të ketë për strehë Xhehenemin – Ai që tejkallon kufijtë dhe i jep përparësi jetës së kësaj bote, atëherë do ta ketë vendqëndrim xhehenemin.

Pastaj Allahu tregon cilësitë e kundërtave:

“وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ” – Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat – që frikësohet se një Ditë do të dalë para Allahut dhe do të japë llogari për çdo gjë që ka vepruar. Çdokush do të qëndrojë para Allahut dhe nuk do të ketë përkthyes mes tij dhe Allahut. Cilësia e parë është: i frikësohet qëndrimit para Allahut. Cilësia e dytë: frenon veten prej dëshirave që kundërshtojnë urdhrin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

“فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَىٰ” – pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin – ai është banesa e kënaqësisë e përgatitur për besimtarët. Allahu thotë: “Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.” Sexhde 17.

“يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَلُهَا” – Të pyesin ty për Orën (e Kiametit) se kur do të ndodhë – Njerëzit e kanë pyetur vazhdimisht Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem se kur do të ndodhë Kiameti. Ata që e kanë pyetur për të kanë qenë dy lloje të njerëzve: Ata që e kanë parë të pamundur (jobesimtarët), si përçmim, dhe ata cilët kanë dashur të përgatiten se si do të dalin para Allahut (besimtarët, të cilët besojnë se do të ndodhë).

Pyetja që njeriu duhet t’ia bëjë vetes dhe për të cilën duhet të përgatisë përgjigjen është: “Në çfarë gjendje do të vdes, në çfarë vepra?” Atëherë patjetër dhe do të përgatitet për vdekjen. Andaj, këshilla është që të shtojë kërkim faljen (istigfarin), të kujtojë se Allahu vazhdimisht na mbikëqyrë neve dhe të marrë veten në llogari.

“فِيمَ أَنْتَ مِنْ ذِكْرِهَا” - **Po në çfarë gjendje je ti t’ua përkujtosht atë (se kur do të ndodhë)?!**” – Ti nuk ke mundësi t’i njoftosh ata se kur do të ndodhë Kiameti, sepse dija për të është vetëm tek Allahu.

“إِلَىٰ رَبِّكَ مُنْتَهَاهَا” - **Tek Zoti yt është fundi i (dijenisë rreth) saj**” – Askush nuk e di atë, përveç Allahut, as Xhibrili (engjëlli më i dijsëm për shpalljen e Allahut) dhe as Muhamedi salAllahu alejhi ue selem (më i dijsmi prej njerëzve për shpalljen e Allahut). Ato që thuhet sot: “Kiameti do të ndodhë në këtë e atë datë” janë gënjeshtër dhe shpifje.

“إِنَّمَا أَنْتَ مُنْذِرٌ مِّنْ يَّخْشَاهَا” - **Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i frikësohen asaj**” – Atij që nuk beson në Ditën e kiametit dhe se do të dalë para Allahut për të dhënë llogari, nuk i bën dobi paralajmërimi yt. Allahu do që t’i tregojë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem se ti nuk ke dije rreth Kiametit, porse misioni yt është t’i paralajmërosh njerëzit se një Ditë do të ndodhë Kiameti dhe do të jepni llogari para Allahut. Ky paralajmërim u bën dobi vetëm atyre që i frikësohen asaj Dite, e këta janë besimtarët. Ndërsa, atyre që e përgënjeshtrojnë atë, nuk u bën dobi paralajmërimi.

“كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَهَا لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا عَشِيَّةً أَوْ ضُحَاهَا” - **Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një gjysmë dite**” – Kur njerëzit të ringjallen, do t’iu duket se kanë qëndruar në tokë vetëm një gjysmëdite.

Surja Abese – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

عَبَسَ وَتَوَلَّى ۖ أَنْ جَاءَهُ الْأَعْمَى ۚ وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَّكَّى ۚ أَوْ يَذَّكَّرُ فَتَنْفَعَهُ
الذِّكْرَى ۚ أَمَّا مَنْ أَسْتَعْنَى ۚ فَانْتَ لَهُ تَصَدَّى ۚ وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَّكَّى ۚ وَأَمَّا
مَنْ جَاءَكَ يَسْعَى ۚ وَهُوَ يَخْشَى ۚ فَانْتَ عَنْهُ تَلَهَّى ۚ كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ ۚ فَمَنْ
شَاءَ ذَكَرَهُ ۚ فِي صُحُفٍ مُكَرَّمَةٍ ۚ مَرْفُوعَةٍ مُطَهَّرَةٍ ۚ بِأَيْدِي سَفَرَةٍ ۚ كِرَامٍ
بَرَرَةٍ ۚ قَتَلَ الْإِنْسَانَ مَا اكْفَرَهُ ۚ مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ ۚ مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَرَهُ ۚ
ثُمَّ السَّبِيلَ يَسَّرَهُ ۚ ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَهُ ۚ ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنْشَرَهُ ۚ كَلَّا لَمَّا يَقْضِ
مَا أَمَرَهُ ۚ فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ ۚ أَنَا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ۚ ثُمَّ شَقَقْنَا
الْأَرْضَ شَقًّا ۚ فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا ۚ وَعَبَأَ وَقَضْنَا ۚ وَزَيَّنَّا وَنَحَلَّا ۚ وَحَدَانِ
غُلًّا ۚ وَفَكَّهُهٗ وَأَبَّا ۚ مَتَّعَا لَكُمْ وَلَإِنَّمَكُم ۚ فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاحَةُ ۚ يَوْمَ يَفِرُّ
الْمَرْءُ مِنْ أَخِيهِ ۚ وَأُمُّهُ وَأَبِيهِ ۚ وَصَحْبَتِهِ وَبَنِيهِ ۚ لِكُلِّ أَمْرٍ مِّنْهُمْ يَوْمَئِذٍ
شَأْنٌ يُغْنِيهِ ۚ وَجُودٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفَرَةٌ ۚ ضَاحِكَةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ ۚ وَوُجُودٌ يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا
غَبَرَةٌ ۚ تَرْهَقُهَا قَتَرَةٌ ۚ أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرَةُ الْفَجَرَةُ ۚ

1. Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin,
2. kur i erdhi pranë i verbri.
3. E ku e di ti, ndoshta ai dëshironte të pastrohej (nga gjynahet)
4. ose të merrte këshillë, e këshilla t'i sillte dobi atij?!
5. Sa për atë që është i pasur,
6. ti atij po i kushton vëmendje,
7. megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet.
8. Sa për atë që të vjen duke nxituar
9. dhe ndien frikë (nga Allahu),
10. ti atij nuk po ia vë veshin.
11. Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë,
12. pra, kush të dojë, le të marrë këshillë!

13. Ai ndodhet në Faqe të nderuara,
14. të lartësuar, të pastra,
15. në duart e shkruesve (engjëj)
16. të ndershëm dhe të drejtë.
17. Mallkuar qoftë njeriu! Sa mosmirënjohës që është ai!
18. Prej çfarë gjëje e krijon Allahu atë?
19. Atë e krijoi prej një pije uji dhe e përgatiti (e krijoi në faza të caktuara).
20. Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes)
21. e pastaj e vdes dhe i cakton një varr,
22. dhe, kur të dojë, Ai e ringjall.
23. E megjithatë, njeriu ende nuk i ka plotësuar ato që i ka urdhëruar Ai!
24. Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet:
25. Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk,
26. pastaj e çajmë tokën në thellësi
27. dhe nxjerrim prej saj drithërat,
28. rrushin e perimet,
29. ullirin e palmat,
30. kopshtet e dendura,
31. pemët dhe gjithë barërat,
32. që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja.
33. Por, kur të vijë Ushtima,
34. atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai,
35. nga e ëma dhe nga i ati,
36. nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.
37. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë.
38. Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore,
39. të qeshura e të gëzuara.

40. Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura,

41. që do t'i mbulojë errësira.

42. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët.

Komentimi

“عَبَسَ وَتَوَلَّى - **Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin**” – flet për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem. Kuptimi i fjalës “abese” është vrenjta dhe ngrysja e fytyrës (kur nuk të pëlqen një gjë apo të shqetëson diçka).

“أَنْ جَاءَهُ الْأَعْمَى - **kur i erdhi pranë i verbri**”³- Ai ishte Abudullah ibën UmiMektumi. Ai ka shkuar te Pejgamberi salallahu alejhi ue selem në një rast kur ai ka qenë duke iu folur për Allahun dhe Islamin disa udhëheqësve të Kurejshëve me dëshirë e madhe që ata të pranenin Islamin (sepse ishin pari dhe pastaj të tjerët që janë nën ta hyjnë në Islam). Në këto momente, ka ardhur Abdullah ibën Mektumi, i verbër, për ta pyetur diçka për fenë Islame. Transmetohet se i ka thënë: “*Më mëso diçka prej asaj që të ka mësuar Allahu!*” mirëpo, duke qenë i angazhuar në ato momente me thirrjen ndaj parisë së Kurejshëve, është ngrysur në fytyrë dhe ia ka kthyer shpinën, me dëshirën e madhe që ata ta pranin Islamin (kjo ka qenë arsyeja e parë pse është vrenjtur). Ai është frikësuar se nëse angazhohet me njeriun e verbër dhe ia kthen kurrizin parisë së Kurejshëve, atëherë ata do të largohen prej tij dhe do ta nënçmojnë atë salAllahu alejhi ue selem (arsyeja e dytë, kështu ia ka marrë mendja), ngase për ta ky i verbër nuk ka

³ Këtu ka argument se lejohet t'i drejtohesh dikujt me një llagap nëse është bërë i njohur me atë gjë (i shurdhëri, i verbëri, topalli). Qëllimi këtu është që të dallosh/përcaktosh se për kënd je duke folur. Mirëpo, nëse qëllimi është nënçmimi, atëherë kjo gjë ndalohe.

pasur ndonjë vlerë. Ky ka qenë ixhtihad i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem e nuk e ka bërë për nënçmim ndaj Ibën UmiMektumit.

Në ajetet e para vërejmë se si Allahu është sjell me butësi, nuk i është drejtuar direkt Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem me qortim (por ka folur në vetën e tretë “ai”). Allahu ka folur në këtë mënyrë (në vetën e tretë) gjithashtu që edhe të tjerët të mos bien në atë gjendje.

“وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَكِّيَ” - **E ku e di ti, ndoshta ai dëshironte të pastrohej (nga gjynahet)** – Çfarë të bëri të dyshoje rreth tij? Ndoshta ai dëshironte të pastrohej nga mëkatet dhe moralet e ulëta; përderisa kjo shpresohet prej tij, atëherë ka qenë më meritator për t’u kthyer kah ai.

“أَوْ يَذَّكَّرُ فَتَنْفَعَهُ الْذِكْرَى” - **ose të merrte këshillë, e këshilla t’i sillte dobi atij?!“** - Për të është shpresuar më shumë se do t’i bëjë dobi këshilla dhe përkujtimi sesa parisë së Mekës.

“أَمَّا مَنْ أَسْتَعْنَى” - **Sa për atë që është i pasur“** – që e llogaritë vetën të vetëmjaftueshëm ndaj Allahut ngaqë ka pasuri të madhe, ose që ka pozitë të lartë në popull dhe mendon se nuk është nevojtar për Allahun.

“فَأَنْتَ لَهُ تَصَدَّى” - **ti atij po i kushton vëmendje“** - A kah ai i cili e ndjen vetën të vetëmjaftueshëm po kthehesh dhe po pret të ta pranojë thirrjen tënde?

“وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَكِّيَ” - **megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet“** – nëse ai që e llogarit vetën të vetëmjaftueshëm nuk dëshiron të pastrohet prej kufrit, shirkut dhe mëkateve, atëherë ti nuk ke përgjegjësi, sepse obligimi yt është vetëm komunikimi i fesë deri tek ai,

ndërsa udhëzimi është në Dorën e Allahut. Mëkati që bën ai, bie mbi të, e jo mbi Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem.

“وَأَمَّا مَنْ جَاءَكَ يَسْعَى” - **Sa për atë që të vjen duke nxituar**” – Ka ardhur me nxitim të shfrytëzojë shansin të prezantojë në mexhlisin e ligjëratës së Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe të përfitojë.

“وَهُوَ يَخْشَى” - **dhe ndien frikë (nga Allahu)**” – frikë ndaj Allahut me zemrën e tij, sepse ka dije të mjaftueshme për madhësitë e Tij. Sahabët kanë qenë njerëzit të cilët më së shumti kanë pasur frikë Allahun sepse dija e tyre ka qenë më e madhe. Njeriu sa më shumë që ka dije për Allahun, atëherë do t’i frikësohet më shumë Atij.

“فَأَنْتَ عَنْهُ تَلَهَّى” - **ti atij nuk po ia vë veshin**” – ky është qortim prej Allahut për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem.

“كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ” - **Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë**”- kurrresi mos vepro ashtu herën tjetër nëse ndodh përsëri. Ajetet e Allahut që janë zbritur te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem janë përkujtim dhe këshillë për njeriun ndaj gjërave të dobishme në këtë dunja dhe ahiret dhe ndaj gjërave të dëmshme në këtë dunja dhe ahiret, si dhe prej tyre zemra e besimtarit merr këshillë.

Këto ajete i ka zbritur si edukim e mësim për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe për umetin e tij. Pra, thirrësi në thirrjen që ua bën të tjerëve nuk duhet t’i japë përparësi dikujt pse ka pozitë të lartë, apo pse është në pushtet, apo pse është i afërm i tij, mirëpo të gjithë duhet të jenë të barabartë tek ai.

“فَمَنْ شَاءَ ذَكَرْهُ” - **pra, kush të dojë, le të marrë këshillë!**” – e kush nuk dëshiron, le të mos marrë këshillë. Njeriu zgjedh mes udhëzimit dhe devijimit, Allahu e ka paracaktuar këtë (nga aspekti i kaderit njeriu është i lirë të zgjedhë). Mirëpo, nga aspekti fetar, Allahu nuk dëshiron që robërit e Tij të bëjnë mohim, nuk dëshiron të zgjedhin mohimin në vend të besimit, por ka urdhëruar të besojnë dhe të kryejnë obligimet që kërkon besimi.

“فِي صُحُفٍ مُّكَرَّمَةٍ” - **Ai ndodhet në Faqe të nderuara**”

“مَرْفُوعَةٍ مُّطَهَّرَةٍ” - **të lartësuara, të pastra**”

Kjo që të është zbritur ty (Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem) gjendet në Faqe të nderuara, të lartësuara e të pastra, që kanë pozitë të lartë tek Allahu.

“بِأَيْدِي سَفَرَةٍ” - **në duart e shkruesve (engjëj)**” – shkruesve, engjëjve, që shkruajnë çdo gjë që njeriu vepron, ndërmjetësve (mes Allahut dhe robërve të Tij), shembull: Xhibrili ka qenë ndërmjetës mes Allahut dhe të Dërguarve të Tij në zbritjen e shpalljes.

“كِرَامٍ بَرَرَةٍ” - **të ndershëm dhe të drejtë**” – të ndershëm në moralin e tyre dhe në krijimin e tyre të përsosur. Allahu i ka krijuar të tillë. Ata kanë mirësi të shumta në vetët e tyre. Në të gjitha aspektet janë krijesa të mira.

“قُلْ الْإِنْسَانُ مَا أَكْفَرُهُ” - **Mallkuar qoftë njeriu! Sa mohues i madh që është ai!**” – U vraftë, d.m.th: mallkuar qoftë, ose u shkatërroftë. Këtë formë e kanë përdorur arabët kur kanë dashur të tregojnë se sa e shëmtuar është një vepër e bërë nga dikush. Disa dijetarë kanë thënë se qëllimi me “njeriu” këtu është fjala për jobesimtarin, e disa të tjerë kanë thënë

se qëllimi është për njeriun si lloj, por prej kësaj përjashtohen besimtarët (me argumente të tjera). Pse Allahu e ka sjell këtë ajet në formë të habisë e çudisë? Përgjigja: Së pari, Allahu i ka dhënë njeriut intelekt, logjikë, duke e dalluar prej krijesave të tjera, e pastaj i ka zbritur Libra, i ka dërguar Pejgamberë, për t'ia bërë të qartë besimin, udhëzimin, të vërtetën dhe mosbesimin. E megjithëkëto argumente njeriu është mohues, e mohon Allahun e nuk i bindet Atij. Prej mohimit (kufrit) është mohimi i ringjalljes (jobesimtarët e mohojnë atë, thonë se nuk ka mundësi të ringjallemi kur eshtrat tanë të jenë kalbur).

“مِنْ أَى شَيْءٍ خَلَقَهُ” – **Prej çfarë gjëje e krijoi Allahu atë?** – A ndalet të mendojë se prej çfarë gjëje është krijuar? A nuk ishte në inekzistencë dhe Allahu e krijoi? A ishte një gjë që nuk përmendej fare? Njeriu është prej krijesave të fundit që është krijuar. Nuk ishte i përmendur fare, pastaj Allahu i dha ekzistencë dhe e bëri krijesën më inteligjente, e megjithëkëtë ai e mohon ringjalljen!

“مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَرَهُ” – **Atë e krijoi prej një pije uji dhe e përgatiti (e krijoi në faza të caktuara)**”- Qëllimi është për ujin e paktë të burrit, që del fuqishëm, prej mes eshtrave të gjoksit dhe kurrizit, pastaj vendoset në mitrën e gruas dhe ajo mbetet shtatzënë dhe pastaj lind njeriu. Allahu tregon se e ka krijuar njeriun nëpër faza të caktuara: së pari një pikë uji, pastaj gjak i ngjizur, pastaj si një copë mishi e përtypur, pastaj i fryhet shpirti. Allahu është Ai i Cili e ushqen fetusin në barkun e nënës së vet përmes një kordoni. Ai kujdeset për të qysh kur është në barkun e nënës së vet.

“ثُمَّ السَّبِيلَ يَسَّرَهُ” – Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes)” – Për të dalë prej barkut të nënës, për në jetë. E inspiron të ushqehet prej nënës së vet. Ia lehtëson rrugën e furnizimit. Me e rëndësishmja është se ia lehtëson rrugën e udhëzimit, të shpëtimit. Allahu na ka lehtësuar këtë rrugë duke na zbritur Libra dhe duke na dërguar Pejgamberë.

“ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَهُ” – e pastaj e vdes dhe i cakton një varr” – Vdekja është ndarja e shpirtit prej trupit. Pastaj Allahu e ka nderuar njeriun duke bërë që të varroset (e jo të lihet mbi tokë sikur kafshët).

“ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنشَرَهُ” – dhe, kur të dojë, Ai e ringjall” – Kjo do të ndodhë në Ditën e Gjykimit dhe secili do të shpërblehet ose do të dënohet për veprat e tij. Askush nuk mund ta pengojë Allahun të ringjallë njerëzit. Kur të vijë urdhri i Allahut, ata do të ringjallen. Mirëpo, ky urdhër e vendim që është marrë shumë më herët (pesëdhjetë mijë vjet para se të krijohen qiejt e toka), nuk ka ardhur, ende nuk ka ardhur koha e ringjalljes, por gjithsesi ajo do të ndodhë.

“كَلَّا لَمَّا يَقْضِ مَا أَمَرَهُ” – Por jo, Ai ende nuk e ka zbatuar atë që ka urdhëruar” – Allahu ende nuk e ka zbatuar atë që ka urdhëruar sipas vullnetit/përcaktimit të Tij natyror (kozmetik), në kuptimin që nuk është plotësuar akoma afati i ringjalljes.

Pastaj Allahu përmend mirësitë e shumta që ia ka dhënë njeriut:

“فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ” - Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet” – Kur njeriu të hajë një ushqim duhet të mendojë se kush është Ai që ia ka sjell atë, a është dikush tjetër përveç

Allahut që e ka krijuar atë për të? Askush. Andaj duhet të tregohet mirënjohës për këtë mirësi kaq të madhe.

“أَنَا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا” - Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk – Edhe kjo është mirësi e Allahut për ne. Prej shiut varet jeta jonë në tokë.

“ثُمَّ شَفَقْنَا الْأَرْضَ شَفًّا” - pastaj e çajmë tokën në thellësi – Pas shiut mbinë farat, çahet toka dhe dalin në sipërfaqe e rriten.

“فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا” - dhe nxjerrim prej saj drithërat – çdo gjë që është në formë të kokrrës, si: gruri, elbi, misri etj.

“وَعِنَبًا وَقَضْبًا” - rrushin e perimet –

“وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا” - ullirin e palmat –

“وَحَدَائِقَ غُلْبًا” - kopshtet e dendura –

“وَفِكْهَةً وَأَبًّا” - pemët dhe gjithë barërat –

“مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ” - që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja – Ne kemi dobi nga këto mirësi, ne dhe bagëtitë tona (prej të cilave pastaj kemi dobi të tjera).

Pasi Allahu përmendi gjendjen e njeriut, qysh prej krijimit, pastaj të mirat që ia ka dhënë dhe vdekjen e tij, pastaj përmend se si do të jetë gjendja e tij në ahiret:

“فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاعَةُ” - Por, kur të vijë Ushtima – e cila shurdhon të dëgjuarit, ajo del kur t’i fryhet Suri. Por çfarë do të ndodhë atë Ditë?

“يَوْمَ يَفِرُّ الْمَرْءُ مِنْ أَخِيهِ” - atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai – qoftë vëlla vetëm prej nënës, apo vetëm prej babait, apo prej të dyve.

“وَأُمِّهِ وَأَبِيهِ - nga e ëma dhe nga i ati” – nga nëna, gjyshja, stërgjyshja, katragjyshja, dhe nga i ati, gjyshi, stërgjyshi, katragjyshi. Do të ikë prej tyre.

“وَصَحْبِيهِ وَبَيْتِهِ - nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet” – do të ikë nga gruaja e tij, i cili është njeriu më i dashur për të sot, dhe do të ikë nga fëmijët e tij.

Pse ikë prej tyre? Ikë që të mos ia kërkojnë ndonjë të drejtë të paplotësuar sa ka qenë në dunja (si: nëse nuk i ka edukuar mirë fëmijët, nëse nuk është sjell mirë me gruan apo me prindërit e me radhë). Ai nuk do të mundet të ikë, por do të mundohet të ikë në atë Ditë.

“لِكُلِّ أَمْرٍ مِنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ” - Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë” – çdo njeri do të jetë i angazhuar me veten e tij, dhe kjo do t’i mjaftojë, nuk do t’i interesojë për të tjerët.

Pastaj Allahu tregon se atë Ditë njerëzit do të ndahen në dy grupe:

“وَجُودٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفَرَةٌ” - Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore” – që bëjnë dritë, atë Ditë fytyrat e besimtarëve do të shfaqin gëzimin dhe lumturinë që kanë në zemrat e tyre.

“ضَاكَّةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ” - të qeshura e të gëzuara” – sepse e dinë se përfundimi i tyre është xheneti e jo xhehenemi. Ata përgëzohen vazhdimisht prej engjëjve për përfundim të mirë.

“وَوُجُودٌ يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا غَبَرَةٌ” - Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura” – nuk është pluhuri i kësaj bote, por një gjë

në formë të pluhurit (i ngjason), me të cilën i nënçmon dhe i poshtëron ata dhe tregon për shëmtinë e tyre.

“تَرْهَقُهَا قَتَرَةٌ” - **që do t'i mbulojë errësira**” – nuk do të ketë dritë në to, si në fytyrat e besimtarëve që përmendëm.

“أُولَٰئِكَ هُمُ الْكَفَرَةُ الْفَجَرَةُ” - **Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët**” – ata që kanë bërë bashkë mes mohimit dhe gjynaheve.

Surja et Tekwir – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ○ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ○ وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ○ وَإِذَا الْعِشَارُ
عُطِّلَتْ ○ وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ○ وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ○ وَإِذَا النُّفُوسُ
زُوجَتْ ○ وَإِذَا الْمَوْءِدَةُ سُئِلَتْ ○ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ○ وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ○ وَإِذَا
السَّمَاءُ كُشِطَتْ ○ وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ ○ وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ ○ عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا
أَحْضَرَتْ ○ فَلَا أَفْسِمُ بِالْخُنُوسِ ○ الْجَوَارِ الْكُنُوسِ ○ وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ ○ وَالصُّبْحِ
إِذَا تَنَفَّسَ ○ إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ○ ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ○ مُطَاعٌ ثَمَّ
أَمِينٍ ○ وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ ○ وَلَقَدْ رَءَاهُ بِالْأَفْقِ الْمُبِينِ ○ وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ
بِضَنِينٍ ○ وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ ○ فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ ○ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ○
○ لِمَن شَاءَ مِنكُم أَن يُسَنِّقِمَ ○ وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَن يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ○.

1. Kur Dielli të mbledhet e të humbë shkëlqimin;
2. kur yjet të rrëzohen
3. dhe malet të lëvizin tutje;
4. kur devetë barrse të braktisen
5. dhe egërsirat të tubohen;
6. kur detet të vlojnë
7. dhe shpirtrat të bashkohen,
8. kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet
9. për çfarë faji ishte vrarë;
10. kur fletët të shpërndahen
11. dhe qielli të zhvishet;
12. kur Xhehenemi të flakërojë
13. dhe Xheneti të afrohet:
14. atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë).
15. Beto hem për ata (planete) që tërhiqen,
16. që lindin e perëndojnë,

17. për natën kur ajo ia beh (vjen) me errësirë,
18. e për agimin kur nis të zbardhë,
19. se ky (Kuran) është Fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari fisnik,
20. që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Fronit
21. e që është i respektuar atje dhe besnik.
22. Shoku juaj nuk është i marrë.
23. Ai e ka parë atë në horizontin e qartë
24. dhe nuk mbulon asnjë të fshehtë prej së Padukshmes.
25. As ky (Kuran) nuk është fjalë e djallit të mallkuar.
26. Prandaj, nga po ia mbani?
27. Ai është veçse këshillë për botët:
28. për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë.
29. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve.

Komentimi

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ - **Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin**” – të paloset, në Ditën e Gjykimit, edhe pse është një planet shumë i madh ai do të paloset dhe do t’i humbasë shkëlqimi, pastaj Allahu e hedh në zjarr të xhehenemit, kjo për t’i mllëfosur ata që e kanë adhuruar diellin duke iu treguar me këtë se nuk ka qenë meritë për t’adhurohet në vend të Allahut. Ato gjëra që janë adhuruar në vend të Allahut dhe ata që kanë adhuruar të tjerë në vend të Allahut apo krahas Tij, do të jenë lëndë djegëse e

zjarrit të xhehenemit, përjashtim bëjnë miqtë e Allahut, si: Isai, Merjemja, njerëzit e devotshëm, të mirë etj.

“وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ” - **kur yjet të rrëzohen**” – të bien.

“وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ” - **dhe malet të lëvizin tutje**”- malet që janë aq të forta e të larta, do të lëvizin e do të zhvendosen nga vendi ku janë e do të bëhen hi e pluhur.

“وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ” - **kur devetë barrse të braktisen**” – Njerëzit i kushtojnë rëndësi të veçantë këtyre deveve barrse, mirëpo në Ditën e Gjykimit as nuk do t’iu shkojë ndërmend për to, por do t’i braktisin sepse do të jenë në një gjendje të rëndë dhe do të mendojnë vetëm për vetët e tyre.

“وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ” - **dhe egërsirat të tubohen**” – Qëllimi është çdo kafshë. Të gjitha kafshët do të tubohen para Allahut dhe njerëzit do t’i shohin. Në mes tyre (kafshëve) do të vendoset drejtësia: kafsha e therur do të hakmerret ndaj asaj që e ka therë. Drejtësia do të vendoset edhe ndërmjet kafshëve, e lëre më ndërmjet njerëzve. Askush nuk do të mbetet pa marrë të drejtën e vet.

“وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ” - **kur detet të vlojnë**” - të ndizen flakë. Zjarri do të përfshijë të gjithë tokën dhe ajo do të thahet (s’do të mbetet asgjë e njomë).

“وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ” - **dhe shpirtrat të bashkohen**” – do të bashkohen me llojin e vet (i miri me të mirët, besimtari me besimtarët, i keqi me të këqijtë, jobesimtari me jobesimtarët, çdo njeri do të bashkohet me umetin e vet).

“وَإِذَا الْمَوْءِدَةُ سُئِلَتْ” - **kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet**” – foshnja e gjinisë femërore e mbytur ose e varrosur

për së gjalli tek arabët e xhahiljetit (periudha para Islame). Ata kanë vepruar kështu sepse kanë pasur mendim negativ ndaj Allahut, nuk kanë mundur të përballojnë turpin para të tjerëve (atë të cilit i ka lindur vajzë e kanë nënçmuar dhe turpëruar). Kur ndonjëri ka marrë lajmin për lindjen e vajzës, fytyra i është nxirë dhe ka filluar të brengoset se çfarë të veprojë, **“Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit, apo ta varrosë në dhé.”** Nahl 59. Disa i kanë varrosur për së gjalli (pa kurrfarë mëshire në zemër).

“بَائٍ ذَنْبٍ فُتِنَتْ” - për çfarë faji ishte vrarë” – Do të pyeten se për çfarë faji ato janë vrarë, kjo në prezencën e atyre që i kanë varrosur për së gjalli në këtë dunja, si qortim dhe poshtërim për ta.

“وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ” - kur fletët të shpërndahen” – Fletët apo regjistri ku janë shkruar fjalët dhe veprat tona. Ato të gjitha shkruhen (nga engjëjt besnikë), nuk mbetet asgjë pa u shënuar në to, madje shënohen edhe ofshamat e njeriut gjatë sëmundjes apo agonisë së vdekjes. Kjo në mënyrë që njeriu të përballlet me veprat e tij kur të dalë para Allahut.

“وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ” - dhe qielli të zhvishet” – Qielli është sikur kulm, është i fortë. Në Ditën e Kiametit do të zhvishet (largohet prej hapësirës ku ndodhet tani) dhe do të paloset në të djathtën e Allahut, **“ndërsa qiejt do të palosen nën të djathtën e Tij”** Zumer 67.

“وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ” - kur Xhehenemi të flakërojnë” – Është quajtur xhehim që do të thotë: ka thellësi shumë të madhe dhe është i errët, kjo është cilësi e xhehenemit. Ai do të

ndizet dhe do të flakërojnë. Lëndë djegëse do të jenë vetë njerëzit dhe gurët (të mëdhenj që digjen shpejt dhe lirojnë nxehtësi shumë të madhe).

“وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ” - dhe Xheneti të afrohet – Xheneti është banesa e të devotshmëve. Në të Allahu ka përgatitur atë që syri s’e ka parë, veshi s’e ka dëgjuar dhe atë që zemra s’mund ta parafytyrojë (ai është më i përsosur). Ai do të afrohet afër besimtarëve të mirë dhe do të zbukurohet. Këtu na shfaqet dallimi i gjendjes së besimtarëve dhe jobesimtarëve (që u përmend më lartë).

Çfarë është ajo e cila do të ndodhë pas të gjitha këtyre gjërave që u përmendën? Përgjigja:

“عَلِمْتُ نَفْسٍ مَّا أَحْضَرْتُ” - atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë) – do ta ketë përpara atë që ka vepruar prej të mirave apo të këqijave, **“(Kini frikë) ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe.”** Ali Imran 30. Andaj, kur njeriu lexon këto ajete kaq madhështore, e ka obligim të meditojë rreth tyre dhe të marrë këshillë e të përfitojë prej tyre.

“فَلَا أُفْسِمُ بِالْخُنَّسِ” - Betohem për ata (planete) që tërhiqen – tërhiqen, lundrojnë, kthehen në vendin ku kanë qenë. Këto yje nganjëherë i shohim lartë në qiell, e nganjëherë më poshtë.

“الْجَوَارِ الْكُنَّسِ” - që lindin e perëndojnë – këto yje apo planete lindin dhe perëndojnë.

“وَاللَّيْلِ إِذَا عَسَسَ - për natën kur ajo ia beh (vjen) me errësirë”.

“وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ - e për agimin kur nis të zbardhë”.

Allahu është betuar në këto krijesa kaq madhore sepse ato janë shenja të mëdha të Tij në këtë univers. Ai që mediton rreth tyre, do të arrijë në përfundim se Allahu është Ai i Cili i drejton ato. Allahu është Ai që na sjellë natën e na sjellë agimin. Ai betohet në këto krijesa madhore për një gjë e cila gjithashtu është madhore:

“إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ - se ky (Kuran) është Fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari fisnik” – ai është e Kurani është Fjalë e Allahut. Allahu ka folur me Kuran (është Fjalë e Allahut), atë e ka dëgjuar Xhibrili prej Tij dhe Ai e ka autorizuar Xhibrilin ta kumtojë dhe shpallë te Muhamedi salAllahu alejhi us selem e pastaj ai salAllahu alejhi ue selem është urdhëruar t’ia transmetojë njerëzve. Nëse marrim në konsideratë se Xhibrili e ka marrë prej Allahut dhe e ka shpallur te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, atëherë themi se është fjalë e Xhibrilit. Pastaj, nëse marrim në konsideratë se Pejgamberi salAllahu alejhi ue na ka transmetuar neve prej Xhibrilit, atëherë themi se është fjalë e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

“ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ - që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Fronit (Arshit)” – e përshkruan Xhibrilin me forcë të madhe. Zoti dhe Pronari i Arshit është Allahu. Arshi është mbi çdo gjë në këtë univers, e mbi Arsh është Allahu, Zoti i botëve. Xhibrili është engjëlli me pozitën më të lartë tek Allahu, kjo sepse atë e ka veçuar Ai me mirësinë më të madhe me të cilën ka begatuar robërit e Tij, që është

Shpallja (kjo është begatia më e madhe për njerëzit). Andaj edhe engjëlli që e ka sjellë këtë Shpallje duhet të ketë pozitë shumë të lartë tek Allahu.

“مُطَاعٌ تَمَّ أَمِينٌ” - e që është i respektuar atje dhe besnik – i binden engjëjt e tjerë. Kur Allahu e zbret një urdhër të Tij, atëherë Xhibrili i urdhëron engjëjt t’i binden Allahut dhe kështu të gjithë engjëjt i binden atij. Ai është besnik për atë me të cilën e ka ngarkuar Allahu.

“وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ” - Shoku juaj nuk është i marrë – Muhamedi salallahu alejhi ue selem. Thotë shoku juaj sepse ata e kanë njohur atë para Shpalljes. Ai ka qëndruar në mesin e tyre 40 vite dhe ata e kanë njohur mirë, e kanë njohur sinqeritetin dhe besnikërinë e tij, madje e kanë quajtur “emin-besniku”. Ai nuk është i marrë, përkundrazi është më i mençuri, nuk ka pasur njeri më të ditur e nuk do të ketë; ai ka pasur intelektin më të kompletuar.

“وَلَقَدْ رَءَاهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ” - Ai e ka parë atë në horizontin e qartë – Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka parë Xhibrilin alejhi ue selem, lartë në horizont, e ka parë dy herë gjatë jetës së tij në formën në të cilën e ka krijuar Allahu, një herë duke qenë në shpellën Hira kur i ka ardhur Shpallja në fillim, dhe për këtë flet ky ajet, dhe herën tjetër në Miraxh kur është ngritur në qiellin e shtatë, ndërsa në forma të tjera e ka parë shumë herë.

“وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ بِضَنِينٍ” - dhe nuk mbulon asnjë të fshehtë prej së Padukshmes – Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nuk ka lënë diçka pa e transmetuar/komunikuar tek ne. Besnikëria dhe sinqeriteti i tij ka arritur kulmin në këtë

aspekt. Çdo gjë që i ka ardhur prej Allahut, e ka përcjell dhe nuk ka mundësi të akuzohet në këtë gjë.

وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ - As ky (Kuran) nuk është fjalë e djallit të mallkuar – nuk është fjalë e fallxhorëve të cilët e marrin frymëzimin prej shejtanëve. Shejtanët formojnë njëqind gënjeshtër e pastaj i transmetojnë te njerëzit përmes fallxhorëve. Ky Kuran nuk është i këtillë. Por, është fjalë e Allahut.

فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ - Prandaj, nga po ia mbani? – Pse nuk i bindeni Muhamedit salAllahu alejhi ue selem?

إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ - Ai është veçse këshillë për botët – Kurani është këshillë që kthjellë. Kush do të marrë këshillë e të përfitojë prej Kuranit, do të përfitojë prej tij. **“për botët”** qëllimi është ata tek të cilët është dërguar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

لِمَن شَاءَ مِنْكُمْ أَن يَسْتَقِيمَ - për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë – Kush do, le të ndjekë rrugën e drejtë. Ky Kuran nuk është tjetër veçse përkujtim dhe këshillë për ata të cilët dëshirojnë të drejtohen në rrugën e drejtë. Ai që dëshiron të udhëzohet në rrugën e drejtë, atëherë duhet të kërkojë këshilla e dobi nga Kurani, përndryshe nuk ka mundësi të drejtohet në këtë rrugë. Rruga e drejtë është feja e Allahut. E kundërta e saj janë dy gjëra (ekstreme): teprimi dhe shkujdesja. Ajo që kërkohet prej nesh është mesi, rruga e mesme (e Kuranit dhe sunetit), që është rruga e drejtë, mes teprimit dhe shkujdesjes. Drejtimi në rrugën e drejtë është në raport me Allahun (të mos ketë as teprim e as shkujdesje) dhe në raport me

njerëzit (të mos jesh arrogant e i ashpër dhe as i përlurur/i dobët.

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ - Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve” – Dëshira dhe vullneti i njeriut vjen pas Dëshirës dhe vullnetit të Allahut. Vepra e njeriut ndodh me dëshirën e tij e me zgjedhjen e tij (pa imponim), mirëpo kjo dëshirë vjen pas Dëshirës së Allahut. Ai, atë që e ka dëshiruar, nuk ka mundur ta dëshirojë veçse pas Dëshirës dhe Vullnetit të Allahut. **“Zotit të botëve”**- Allahu me zotërimin e Tij ka përfshirë të gjithë universin, Ai është Zoti i çdo gjëje.

Surja el Infitar - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ ○ وَإِذَا الْكَوَاكِبُ انْتَثَرَتْ ○ وَإِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ ○ وَإِذَا الْقُبُورُ
بُعْثِرَتْ ○ عَلِمْتَ نَفْسٍ مَا قَدَّمَتْ وَأَخَّرَتْ ○ يَٰأَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ
○ الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ ○ فِي أَيِّ صُورَةٍ مَا شَاءَ رَكَّبَكَ ○ كَلَّا بَلْ تُكَذِّبُونَ
بِالَّذِينَ ○ وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ ○ كِرَامًا كَتِيبِينَ ○ يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ ○ إِنَّ
الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ○ وَإِنَّ الْفَجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ ○ يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الدِّينِ ○ وَمَا هُمْ
عَنْهَا بِغَائِبِينَ ○ وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ○ ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ○ يَوْمَ لَا
تَمْلِكُ نَفْسٌ لِنَفْسٍ شَيْئًا ○ وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ ○.

1. Kur qielli të çahet
2. dhe yjet të derdhen;
3. kur detet të përzihen
4. dhe varret të rrotullohen,
5. atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë.
6. O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar,
7. i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi
8. dhe, që të ka mbujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!
9. Por jo! Ju e quani të gënjeshtërt Gjykimin (pas ringjalljes),
10. ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë),
11. shënues të nderuar,
12. që dinë gjithçka që bëni.
13. Vërtet, punëdrejtët do të jenë në Xhenet,
14. kurse fajtorët, me siguri, do të jenë në Zjarrin flakërues,

15. në të cilin do të digjen në Ditën e Gjykimit,
16. pa mundur t'i shmangen atij.
17. E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?
18. Edhe njëherë: Kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Dita e Gjykimit?
19. Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe, kur pushteti do të jetë vetëm i Allahut.
-

Komentimi

“إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ” - **Kur qielli të çahet**”- do të çahet në Ditën e Gjykimit.

“وَإِذَا الْكَوَاكِبُ انْتَثَرَتْ” - **dhe yjet të derdhen**”- në atë Ditë, yjet, qofshin të mëdha apo të vogla, të gjithë do të bien, shpërndahen, rrëzohen, derdhen, sepse universi do të shkatërrohet.

“وَإِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ” - **kur detet të përzihen**”- do të vërshojnë, deti që ka ujin e ëmbël do të përzihet me detin që ka ujin e njelmët, detet do të bëhen bashkë dhe do ta mbulojnë tokën.

“وَإِذَا الْقُبُورُ بُعِثَتْ” - **dhe varret të hapen**” dhe do të dalin jashtë të vdekurit, të ringjallen, për të dalë para Allahut.

Allahu na tregon se çfarë do të bëhet me njeriun kur të ndodhin këto katër gjëra.

“عَلِمْتُ نَفْسِي مَّا قَدَّمْتُ وَأَخَّرْتُ” - **atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë**”- çdo shpirt do ta dijë dhe shohë atë që ka vepruar dhe atë që ka lënë pa vepruar, do t'i dalë përpara regjistri i veprave të tij, **“Dhe**

Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: "Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë". Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar". Kehf 49. Ndërsa, në këtë dunja njeriu harron, është harrestar, veprat që bën apo nuk i bën i harron, qofshin të mira a të këqija, mirëpo ato do t'i ekspozohen në Ditën e gjykimit dhe do të japë llogari.

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدًّا فَمُلِقِيهِ - O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar"- Disa dijetarë thonë se Allahu i drejtohet me këto fjalë jobesimtarit, e disa të tjerë thonë se i drejtohet njeriut në përgjithësi, sepse njeriu është zullumqar i madh (i bën padrejtësi vetvetes), injorant i madh ndaj Allahut, apo është mohues i madh. Çfarë është ajo gjë që të mashtroi për Zotit tënd dhe e përgënjeshton Ditën e ringjalljes, apo nuk i bindesh Atij?! Ka prej njerëzve që e mohojnë Allahun. Ajo që e ka mashtruar njeriun dhe pastaj është dhënë pas mëkateve dhe përgënjeshtimit, është bujaria dhe butësia e Allahut.

الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ - i Cili të krijoi ty, të përsosi dhe të drejtoi"- Allahu të ka dhënë ekzistencë, të ka krijuar pasi ke qenë një hiç. Ai e ka përsosur krijimin e njeriut. E ka drejtuar atë duke e dalluar prej gjallesave të tjera (e ka bërë të qëndrojë drejtë, në dy këmbë).

فِي أَيِّ صُورَةٍ مَّا شَاءَ رَكَّبَكَ - dhe, që formësoi në formën që ka dëshiruar?!"- Ka prej njerëzve që janë të bukur, që nuk janë të bukur, që janë në mes të kësaj, ka që janë të zi, të bardhë, të kuq. Secilin e ka krijuar në bazë të vullnetit dhe të

dëshirës së Tij. Megjithëkëtë, Allahu e ka krijuar njeriun në formën më të mirë, ai është krijesa më e mirë e më e përsosur. Nuk ka të meta e mangësi në krijimin e Allahut.

“كَلَّا بَلْ تُكَذِّبُونَ بِالَّذِينَ” - **Por jo! Ju e quani e mohoni Gjykimin (pas ringjalljes)**”- Me gjithë këtë krijim që ka bërë Allahu dhe këtë formë të përsosur të krijimit (si njeri), ju e përgënjeshtrooni Ditën e Shpërblimit, në të cilën secili do të shpërblehet për veprat e bëra. Dinn ka dy kuptime: 1. Shpërblimi apo dënimi në Ditën e gjykit, kur do të dalin për të dhënë llogari, 2. Feja e Allahut, ligjet e dispozitat e Islamit.

“وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ” - **ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë)**”- Ka prej njerëzve që e mohojnë këtë gjë, andaj Allahu po na vërteton në këtë ajet se ne gjithsesi kemi rojtarë, engjëj, që shkruajnë veprat tona. Çdo njeri ka një engjëj që shkruan fjalët dhe veprat e tij. Andaj, duhet të ketë kujdes shumë se çfarë flet e çfarë vepron.

“كَرَامًا كَتَبِينَ” - **shënues të nderuar**”-janë të ndershëm tek Allahu e besnik, nuk janë të qortuar, nuk i bëjnë padrejtësi njeriut duke shkruar diçka që nuk ka vepruar ai dhe nuk ia humbasin një vepër (duke mos ia shkruar).

“يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ” - **që dinë gjithçka që bëni**” -i dinë duke shikuar veprat e fjalët tona dhe i shkruajnë ato, i dinë veprat tona të zemrës, i shkruajnë ato dhe nijetin në lidhje me atë vepër.

Pastaj sqarohet përfundimi dhe shpërblimi për çdo njeri.

“إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ” - **Vërtet, punëdrejtët do të jenë në kënaqësi**”- Ebrar janë ata që bëjnë shumë vepra të mira dhe

largohen shumë prej veprave të këqija. Ata do të jenë në kënaqësi të zemrës dhe të trupit, së pari në dunja (kënaqësinë e zemrës) e pastaj në ahiret (kënaqësinë e xhenetit). Nuk ka njerëz me zemra më të qeta dhe me mendje e shpirt më të qetë sesa ata që janë ebrar – punëdrejtë (mundohen shumë në veprimin e veprave të mira dhe në largimin prej veprave të këqija). Disa nga selefi kanë thënë: *“Sikur të dinin mbretëritë dhe bijtë e tyre për kënaqësinë që kemi në gjokset tona, do të përpiqeshin të na luftonin me shpatat e tyre për të na marrë atë.”*

“وَإِنَّ الْفَجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ” - kurse mëkatarët, me siguri, do të jenë në Zjarrin flakërues”- qëllimi është për jobesimtarët, të cilët janë të kundërt me ata që janë ebrar. Në zjarrin (xhehim) që djeg lëkurat dhe mishin e tyre.

“يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الدِّينِ” - në të cilin do të digjen në Ditën e Gjykimit” – në Ditën e shpërblimit dhe ndëshkimit, kur do të marrin këtë ndëshkim prej Allahut.

“وَمَا هُمْ عَنْهَا بِغَائِبِينَ” - pa mundur t’i shmangen atij”- Nuk mund të ikin prej aty, nuk mund të dalin, do të jenë gjithmonë aty, përherë.

“وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ” - E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Dita e Gjykimit?”

“ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ” - Edhe njëherë: Kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Dita e Gjykimit?”- Me këtë pyetje në këto dy ajete do të tregojë për peshën e madhe të kësaj Dite. Kuptimi i ajeteve: Ai që di për këtë Ditë jam vetëm Unë, vetëm Unë e di peshën e madhe të saj, kurse njeriu di pak për rëndësinë e saj, nga njerëzit janë vetëm pak ata të cilët i frikësohen kësaj dite.

“يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِنَفْسٍ شَيْئًا وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ” - Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe kur pushteti do të jetë vetëm i Allahut”- Në atë Ditë askush nuk mund t’i sjellë të mira tjetrit apo t’ia largojë një të keqe. Në këtë jetë dikush jep urdhra ndaj të tjerëve (që janë nën të), mirëpo në ahiret urdhri dhe çështja është vetëm në dorën e Allahut. Në atë Ditë njerëzit do t’i kaplojë frika, brenga dhe shqetësimi i madh, sepse askush nuk mund të ndihmojë përveçse me lejen e Allahut.

Surja el Mutaaffinë – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ ۝ الَّذِينَ إِذَا أَكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ ۝ وَإِذَا كَالُواهُمْ أَوْ
وَزَنُواهُمْ يُخْسِرُونَ ۝ أَلَا يَظُنُّ أُولَٰئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ ۝ لِيَوْمٍ عَظِيمٍ ۝ يَوْمَ يَقُومُ
النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ۝ كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفَجَارِ لَفِي سِجِّينٍ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينٌ ۝
كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ۝ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ۝ الَّذِينَ يَكْذِبُونَ بِيَوْمِ الدِّينِ ۝ وَمَا يَكْذِبُ بِهِ
إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ۝ إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ءَايَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ۝ كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَىٰ
قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ۝ كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُوبُونَ ۝ ثُمَّ إِنَّهُمْ
لَصَالُوا الْجَحِيمِ ۝ ثُمَّ يُقَالُ هَٰذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تَكْذِبُونَ ۝ كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي
عَلِّيَّينَ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا عَلِّيُونَ ۝ كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ۝ كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ۝ يَشْهَدُهُ
الْمُقَرَّبُونَ ۝ إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ۝ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ ۝ تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ
نَضْرَةَ النَّعِيمِ ۝ يُسْقُونَ مِنْ رَاحِقٍ مَّخْتُومٍ ۝ خَتَمُهُ مِسْكٌ ۝ وَفِي ذَلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ
الْمُتَنَفِّسُونَ ۝ وَمَزَاجُهُ مِنْ تَسْنِيمٍ ۝ عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا الْمُقَرَّبُونَ ۝ إِنَّ الَّذِينَ
أَجْرَمُوا كَانُوا مِنَ الَّذِينَ ءَامَنُوا يَضْحَكُونَ ۝ وَإِذَا مَرُّوا بِهِمْ يَتَغَامَزُونَ ۝ وَإِذَا
أَنْقَلَبُوا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ أَنْقَلَبُوا فَكِهِينَ ۝ وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَٰؤُلَاءِ لَضَالُونَ ۝ وَمَا
أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَفَظِينَ ۝ فَالْيَوْمَ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَضْحَكُونَ ۝ عَلَى الْأَرَائِكِ
يَنْظُرُونَ ۝ هَلْ تُؤِيبُ الْكُفَّارُ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ۝

1. Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje),
2. që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë,
3. ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë.
4. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen
5. në një Ditë të madhe,
6. Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!
7. Sigurisht (që do të ringjallen), dhe Libri i punëmbarshtëve do të jetë në Sixh-xhîn!
8. E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Sixh-xhîn?!
9. Është një libër i shkruar!
10. Mjerë mohuesit atë ditë,
11. të cilët mohuan Ditën e Gjykimit!

12. Askush nuk e mohon atë, përveç gjynahqarëve që shkelin çdo kufi
13. e të cilët, kur u lexohen shpalljet Tona, thonë: “Këto janë përralla të popujve të lashtë!”
14. Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat. 15. Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t’i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre,
16. pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehenemit
17. e do t’u thuhet: “Ja, kjo ajo që e quanit të gënjeshtërt!”
18. Ndërsa Libri i punëdrejtëve me siguri që do të jetë në Il-lijûn.
19. E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Il-lijûn?
20. Është një libër i shkruar!
21. Atë e dëshmojnë të afërmit (e Allahut).
22. Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet,
23. duke shikuar nga divanet.
24. Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë.
25. Atyre do t’u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë,
26. fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen. 27. Dhe ai (musht) do të përziehët me ujin e Tesnimit,
28. nga burimi i të cilit do të pinë më të afërmit (e Allahut).
29. Vërtet, keqbërësit qeshnin me ata që besonin,
30. duke ia shkelur syrin njëri-tjetrit, sa herë që ata kalonin pranë tyre.
31. Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata talleshin (me besimtarët)

32. dhe, kur i shihnin ata, thoshin: “Këta janë të humbur”,
33. ndonëse nuk qenë dërguar për kujdestarë të tyre.
34. Por sot, ata që kanë besuar, do t’i përqeshin
jobesimtarët,
35. e nga divanet e ngritura do t’i shikojnë.
36. A janë shpërblyer meritueshëm mohuesit për atë që
kanë bërë?
-

Komentimi

“وَيِّنَ لِلْمُطَفِّينَ - Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje)” – Përmes kësaj fjale “wejlun -mjerë”, Allahu i kërcënon ata që kundërshtojnë urdhrin e Tij, apo shkelin atë që është e ndaluar. Kush janë këta mutafifin – mashtrues? Këtë e tregon në vargjet në vijim:

“الَّذِينَ إِذَا أَكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ” - që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë” – kur ata blejnë diçka që peshohet, të drejtën e tyre e marrin të plotë, pa lënë mangët.

“وَإِذَا كَالُواهُمْ أَوْ وَزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ” - ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë” – kur u masin/shesin të tjerëve ndonjë gjë me kile apo me litër, nuk janë korrekt, lënë mangët. të drejtën e vet e kërkojnë një me një, kurse të drejtën e të tjerëve e cenojnë. Kështu ata kanë bërë bashke mes dy të këqijave: lakminë dhe koprracinë.

Çdokush që kërkon të marrë të drejtën e tij të plotë dhe mohon të drejtën që ka ndaj tjetrit (p.sh. në raportet bashkëshortore, apo në raportin fëmijë-prind etj.), përfshihet te ky ajet.

“أَلَا يَظُنُّ أُولَٰئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ” - **A nuk mendojnë ata se do të ringjallen**” – a nuk janë të bindur se do të ringjallen, se do të nxirren nga varret e tyre për të dalë para Allahut të Madhërishëm?!

“لِيَوْمٍ عَظِيمٍ” - **në një Ditë të madhe**” – Një Ditë e madhe për sa i takon gjatësisë, tmerrit dhe çdo gjëje që do të ndodhë atë Ditë. Është një ditë e madhe në çdo kuptim të mundshëm të këtij mbiemri. Kjo Ditë për disa është e vështirë (për jobesimtarët) dhe për disa e lehtë (për besimtarët).

“يَوْمَ يَقُومُ النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ” - **Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!”** – Do të ngrihen zbathur nga varret, duke mos pasur asgjë, pa asnjë rrobë, madje të pa bërë synet. Allahu e përsërit krijimin për të treguar përsosmërinë e Fuqisë së Tij. Ai do t’i rikthejë krijesat pikërisht ashtu siç i ka krijuar si në herën e parë. Në atë Ditë nuk ekziston asnjë lloj pasurie që mund të na shpëtojë nga ndëshkimi. Asnjë fëmijë nuk mund ta ndihmojë prindin e vet dhe asnjë prind nuk ka çfarë të bëjë për fëmijën e vet. As bashkëshortja apo farefisi. Atë Ditë nuk mund të bëjë gjë askush për askënd, pasi të gjithë do të jenë të preokupuar me veten.

“كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفُجَارِ لَفِي سِجِّينٍ” - **Sigurisht (që do të ringjallen), dhe Libri i punëmbropshtëve do të jetë në Sixh-xhîn!”** – Qëllimi është për mëkatarët që janë jobesimtarë. Allahu na tregon se Libri i jobesimtarëve është në Sixhin, në vendin më të ulët, është në zjarr të xhehenemit.

“وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينٍ” - **E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Sixh-xhîn?!”** Ka ardhur në formë të pyetjes për të treguar se

ajo për të cilën po na flet Allahu është shumë çështje e madhe.

“كِتَابٌ مَّرْفُومٌ - Është një libër i shkruar!” – Libri i këtyre punëmbropshtëve. Ajo që është shkruar në të, nuk mund të shtohet a pakësohet, nuk mund të ndryshohet nga ndokush.

“وَيَلِّ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ - Mjerë për mohuesit atë ditë”.

“الَّذِينَ يُكَذِّبُونَ بِيَوْمِ الدِّينِ - të cilët mohuan Ditën e Gjykimit!”- E shohin të gënjeshtërt, e përgënjeshtrojnë. Ai që nuk e beson Ditën e Gjykimit, por beson se vetëm kjo jetë ekziston, ai nuk shqetësohet se çfarë do të ndodhë pas saj dhe nuk vepron për jetën e ardhme (nuk përgatitet për të). Jeta e tij në këtë jetë është sikur jeta e kafshës (e pa vëmendshme ndaj jetës tjetër). Allahu gjithmonë besimin tek Ai e shoqëron me besimin në Ditën e Gjykimit (Fundit). Këtë e gjejmë të shprehur edhe në hadithet e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Njeriu duhet të besojë Ditën e Gjykimit dhe të përgatitet për të, sepse ahireti do të jetë vendqëndrimi përfundimtar i tij. Në këtë dunja askush nuk mund të jetojë përherë.

“وَمَا يُكَذِّبُ بِهِ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ - Askush nuk e mohon atë, përveç atyre që shkelin çdo kufi dhe janë mëkatarë”- që tejkalojnë kufijtë në veprat e tyre dhe janë mëkatarë.

“إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ءَايَاتُنَا قَالَ أَسْطِيرُ الْأَوَّلِينَ - e të cilët, kur u lexohen shpalljet Tona, thonë: “Këto janë përralla të popujve të lashtë!” – Atyre dikush tjetër ua lexon ajetet, e nuk i lexojnë vetë. Këtyre as nuk u shkon ndërmend të lexojnë ajetet e Kuranit, por dikush ua sjellë ato si argument për t’iu

treguar se si duhet të besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit, e ata thonë për to: “Këto janë përralla të popujve të lashtë!” Thonë kështu sepse kanë tejkaluar kufijtë dhe janë mëkatarë.

“كَذَّابٌ بَلَّ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ” - **Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat**” – Kurrsesi nuk janë përralla të popujve të lashtë, por gjynahet ua kanë mbuluar zemrat, u janë bërë pengesë mes tyre dhe udhëzimit dhe u janë bërë derë e hekurt ndërmjet. Zemra e atij që është njollosur me papastërtinë e mohimit dhe mëkateve, nuk ka mundësi t’i shohë ajetet kuranore për të vërteta, por i sheh sikur të ishin përralla të popujve të lashtë.

“كَذَّابٌ إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُوبُونَ” - **Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t’i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre**” – Një pengesë do të jetë ndërmjet, në Ditën e Gjykimit, nuk do të mund ta shohin Allahun. Ashtu siç ka pasur pengesë mes tyre dhe fesë së Allahut në këtë botë, ashtu do të ketë pengesë mes tyre dhe Allahut në ahiret. Sa kanë qenë në dunja ajetet i kanë konsideruar sikur të ishin përralla të popujve të lashtë. Ehli suneti me këtë ajet argumentojnë se besimtarët do ta shohin Allahun në Ditën e Gjykimit (ka edhe argumente të tjera nga Kurani e suneti). Ata, ndërmjet të cilëve dhe Allahut nuk ka pasur pengesë në këtë botë, nuk do të pengohen prej shikimit në Allahun në ahiret, duke qenë të kënaqur e duke shijuar kënaqësitë që Ai ka përgatitur në xhenet. Allahu i veçon këta njerëz në këtë ajet se do të pengohen nga shikimi i Allahut në ahiret, për të treguar se ka disa të tjerë që i kanë parë ajetet për të

vërteta dhe të cilët nuk do të pengohen, por do ta shohin Allahun në ahiret.

“ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُوا الْجَحِيمِ - pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehenemit”- Këta jobesimtarë mëkatarë do të hyjnë në zjarr, do të marrin ndëshkimin e Allahut. Pastaj tregon se çfarë do t’iu thuhet atyre (qortime të ashpra):

“ثُمَّ يُقَالُ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تَكْذِبُونَ - e do t’u thuhet: “Ja, kjo është ajo që e quanit të gënjeshtërt!”- Bëhet bashkë ndëshkimi i trupit (me zjarr) dhe ndëshkimi shpirtëror (me qortim dhe humbje të shpresës për të dalë ndonjëherë nga aty).

Pastaj fillon të përmendë gjendjen e atyre që kanë qenë punëmirë dhe shpërblimet e përgatitura për ta:

“كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي عِلِّيَّينَ - Ndërsa Libri i punëdrejtëve me siguri që do të jetë në Il-lijûn”- Në vendin më të lartë në xhenet, këta njerëz do të jenë në këtë vend, që është xheneti i Allahut.

“وَمَا أَدْرَاكَ مَا عِلِّيُّونَ - E kush do të ta shpjegojë ty se ç’është Il-lijûn?” – Ka ardhur në formë të pyetjes për të treguar se kjo gjë është çështje e madhe (nuk e di çdokush).

“كِتَابٌ مَرْقُومٌ - Është një libër i shkruar!” – Nuk ndryshohet e nuk ndërrohet diçka në të. Për ata për të cilët Allahu ka shkruar se do të jenë në xhenet, kjo është e shkruar dhe nuk ka mundësi të ndryshohet.

“يَشْهَدُهُ الْمُقَرَّبُونَ - Atë e dëshmojnë të afërmit (e Allahut)” – Ata që i janë afruar Allahut me adhurime, bindje. Sa më shumë që njeriu të shtojë adhurimet, aq më afër Tij do të jetë. Sa më shumë që tregohet modest për hir të Allahut, aq

më shumë Ai do ta ngritë dhe do ta lartësojë atë. Sa më shumë që tregon përrulje ndaj Allahut, aq më shumë do ta ngritë atë. Dhe disa njerëz Allahu i ka ngritur më lartë se disa të tjerë, **“Allahu do t’i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija.”** Muxhadile 11.

“إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ - Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet” – Berr është ai njeri në të cilin ka mirësi të shumta, ka bërë adhurime të shumta, është larguar prej të këqijave, ka ihsan në adhurime dhe bamirësi ndaj krijesave. Këta punëmirë (ebrar) do të jenë në një kënaqësi të madhe, të trupit dhe të zemrës.

“عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ - duke shikuar nga kolltukët” - kolltukë të bukur e të stolisur, të zbukuruar me stolisje të ndryshme, luksozë. Do të ulen në ta dhe do të shikojnë begatitë dhe shpërblimet që Allahu ka përgatitur për ta në xhenet, të cilat nuk mund t’i parafytyrojë zemra në këtë dunja.

“تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ - Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e kënaqësisë” - shkëlqimin për shkak të kënaqësisë, gëzimit dhe lumturisë që janë duke përjetuar (kjo u vërehet në fytyrat e tyre). Nuk ka lumturi e kënaqësi më të madhe sesa ajo të cilën e përjetojnë banorët e xhenetit.

Pastaj Allahu na sqaron një pjesë të kënaqësive që ka përgatitur për banorët e xhenetit:

“يُسْقَوْنَ مِنْ رَحِيقٍ مَخْمُومٍ - Atyre do t’u jepet të pinë pije të pastër të ruajtur mirë” – Për ta Allahu ka caktuar shërbëtorë, që janë djelmosha, të rinj, që nuk plaken kurrë. Pije e pastër, e kulluar, që nuk deh e as nuk shkakton

dhimbje koke, me shije të mirë, si shpërblim për besimtarët që e kanë ndaluar veten prej pijeve të ndaluara në këtë botë.

fund i së cilës është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen"- Në fundin e kësaj pije ka diçka, që është aroma e mirë, e kundërta me verën apo pijet alkoolike në këtë dunja që e kanë aromën e keqe. Për këto kënaqësi le të garojnë e le të punojnë ata që duan të punojnë, ata që duan të synojnë këto shpërblime, që synojnë të jenë ebrar, d.m.th. le të bëjnë gara derisa të lodhen, derisa nuk munden më, duke dhënë maksimumin, për të tejkaluar të tjerët. Këtë lloj garimi, Allahu na urdhëron ta bëjmë në punë të mira dhe në lënien e ndalesave derisa të lodhemi, për të arritur shpërblimet e Tij.

Dhe kjo pije do të përzihet me ujin e Tesnimit"- Tesnimi është burimi në të cilin pinë të afërtit e Allahut (që i janë afruar me adhurime dhe Ai i ka afruar afër Vetes), ai ka pozitë të lartë tek Ai, është burim i xhenetit.

nga burimi i të cilit do të pinë më të afërmit (e Allahut)"- do të pinë e do të freskohen dhe do të kënaqen.

Vërtet, keqbërësit qeshnin me ata që besonin"- Ata që kanë bërë mëkate dhe e kanë kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij, qeshnin me qëllim nënçmimin ndaj besimtarëve.

duke ia shkelur syrin njëri-tjetrit, sa herë që ata kalonin pranë tyre"- qoftë kur kalonin afër

besimtarëve apo besimtarët kalonin afër tyre, duke bërë shenja me sy e mimika me qëllim nënçmimi ndaj besimtarëve.

“وَإِذَا أَنْقَلَبُوا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ أَنْقَلَبُوا فَكِهِينَ” - Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata ktheheshin të kënaqur - Mendonin se me këtë përqeshje dhe përçmim ndaj besimtarëve kanë fituar dhe kanë arritur mposhtje ndaj tyre, kanë ndje një lloj kënaqësie për këtë përçmim.

“وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَٰؤُلَاءِ لَضَالُّونَ” - dhe, kur i shihnin ata, thoshin: “Këta janë të humbur” - Edhe sot ka njerëz të cilët thonë për besimtarët se janë të humbur, të prapambetur etj.

“وَمَا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَفِظِينَ” - ndonëse nuk qenë dërguar për kujdestarë të tyre.

“فَالْيَوْمَ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَضْحَكُونَ” - Por sot, ata që kanë besuar, do t'i përqeshin jobesimtarët - Sot besimtarët do t'i përqeshin ata, pra në Ditën e Gjykimit. Besimtarët do të jenë të cilët qeshin/buzëqeshin të fundit. Ndërsa, përqeshjen e jobesimtarëve ndaj besimtarëve në këtë dunja, do ta pasojë vajtimi, dëshpërimi e shkatërrimi (në xhehenem).

“عَلَىٰ الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ” - e nga kolltukët e ngritura do të shikojnë - Nga kolltukë luksozë, të stolisur me të gjitha të mirat, duke shikuar në begatitë e Allahut në xhenet. Disa dijetarë thonë se do t'i shikojnë (prej xhenetit) armiqtë e tyre në xhehenem të cilët janë përqeshur me ta në dunja.

“هَلْ تُؤْبَ الْكُفَّارُ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ” - A janë shpërblyer meritueshëm mohuesit për atë që kanë bërë? - A nuk janë ndëshkuar për atë që kanë bërë, si meritë për veprat që kanë bërë? Këtë pyetje e bën si pohim se gjithsesi do ta gjejnë ndëshkimin e

Tij, për shkak të veprave që kanë bërë në dunja. Dhe vendimi e gjykimi i Allahut është i drejtë. Ai i gjykon jobesimtarët me drejtësi absolute. Ai nuk i bën askujt padrejtësi. Allahu, çdokënd e gjykon ose me mirësinë e Tij (besimtarët) ose me drejtësinë e Tij (jobesimtarët).

Surja el Inshikak - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ○ وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحَقَّتْ ○ وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ○ وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا
وَتَخَلَّتْ ○ وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحَقَّتْ ○ يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدْحًا فَمُلْقِيهِ ○
فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ ○ فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا ○ وَيَنْقَلِبُ إِلَىٰ أَهْلِهِ
مَسْرُورًا ○ وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ ○ فَسَوْفَ يَدْعُوا ثُبُورًا ○ وَيَصْلَىٰ
سَعِيرًا ○ إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا ○ إِنَّهُ ظَنَّ أَن لَّنْ يَحُورَ ○ بَلَىٰ إِنَّ رَبَّهُ
كَانَ بِهِ بِصِيرًا ○ فَلَا أَفْسِمُ بِالْشَفَقِ ○ وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقِ ○ وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقِ ○
لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَن طَبَقٍ ○ فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ○ وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا
يَسْجُدُونَ ○ بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يَكْذِبُونَ ○ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ ○ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ
أَلِيمٍ ○ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ○.

1. Kur qielli të çahet,
2. duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë;
3. kur Toka të sheshohet (nga rrënimi i maleve)
4. dhe të flakë atë që ka brenda e të zbrazet,
5. duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e ka për detyrë,
6. atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt.
7. Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë,
8. do ta ketë të lehtë llogarinë
9. dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij.
10. Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës,
11. do të lutet për të vdekur
12. dhe në zjarr do të digjet,
13. sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij,
14. duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari).

15. Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij!
16. Betohem në kuqërrimin e muzgut,
17. në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj,
18. si dhe në hënën e plotë,
19. se ju, me siguri, do të kaloni nga e keqja te më e keqja!
20. Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!
21. E përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen në sexhde?!
22. Përkundrazi, ata që nuk besojnë e quajnë atë gënjeshtër.
23. Por Allahu e di mirë çfarë fshehin ata,
24. prandaj shpallu atyre dënimin e dhembshëm (që i pret të gjithë),
25. përveç atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të shpërblehen pandërprerë.

Komentimi

“إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ” - **Kur qielli të çahet**”- të çahet, të hapet, duke u formuar vrima e dyer në qiell. Çarja apo hapja e qiellit bëhet kur të ndodhë Kiameti.

“وَأَذِنتُ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ” - **duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e meriton**”- Qielli do të fillojë të çahet duke iu bindur Allahut të Lartësuar, i Cili do ta urdhërojë të çahet e të shkatërrohet. Allahu ka krijuar shtatë qiej të fortë, mirëpo kur të vijë Urdhri i Allahut për t’u shkatërruar, ato do të shkatërrohen. Allahu e ka krijuar qiellin dhe ai e dëgjon me bindje

urdhrin e Tij kur ta urdhërojë për shkatërrim. Edhe në fillimin e krijimit të qiellit, ai i është bindur urdhrit të Tij, **“Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullirë e i tha atij dhe Tokës: “Ejani të dy me hir a me pahir!” Ata u përgjigjën: “Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!”** Fussilet 11. Njeriu, një qenie e dobët krahasim me qiellin, duhet të meditojë në këto krijesa madhështore, siç është qielli dhe planetët e tjera, se ato i binden urdhrit të Allahut, kurse njeriu me gjithë dobësinë e vet e kundërshton urdhrin e Tij.

وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ - kur Toka të sheshohet (nga rrënimi i maleve)”- Toka ku jemi është e rrumbullakët, nuk është e shtrirë. Në Ditën e Gjykimit Allahu do ta bëjë të rrafshët, të shtrirë, pa kodra e male, kjo që njerëzit të shohin e të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të shohin/dëgjojnë thirrësin e Allahut njëjtë sikur ai që është afër sikur ai që është larg (duke qenë në një nivel).

وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ - dhe të flakë atë që ka brenda e të zbrazet” – Të nxjerrë trupat e njerëzve jashtë, të varrosurit në varre, duke dal për tek Allahu.

وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ - duke dëgjuar me bindje Zotin e vet, siç e meriton”- Kur të sheshohet dhe të nxjerrë atë që ka brenda e të zbrazet, këtë e bën duke dëgjuar me bindje urdhrin e Allahut siç e meriton.

“يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدًّا فَمُلْقِيهِ” - atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë për te Zoti yt, kështu që do ta takosh Atë”- Përfshin çdokënd që përpiqet. Dhe në këtë rrugëtim ai gjen vështirësi e mundime, por që patjetër kjo përpjekje e ka fundin tek Allahu, ngase do të vdesim dhe kur të vdesim do të kthehemi tek Ai. Ky ajet na bën të kuptojmë se çfarëdo vepre që bën njeriu, qoftë besimtar i cili bën vepra të mira, qoftë mëkatar i cili bën mëkate, është duke ecur drejt Allahut dhe fundin do ta ketë tek Ai (do ta takojë Atë); ai e kalon jetën me vështirësi, vuajtje e mundime dhe përfundimin e ka tek Allahu. Dhe kur kthehet tek Allahu e pret llogaridhënia. Ai që bën vepra të mira, këtë e bën që të arrijë kënaqësinë e Allahut, ndërsa ai që bën të këqija, me to e hidhëron Allahun.

“kështu që do ta takosh Atë” menjëherë si të vdesë njeriu, takimi i tij me Allahun është shumë afër.

Dhe njerëzit do të ndahen në dy grupe: 1. Ata që do ta marrin librin e tyre (të veprave) në dorën e djathtë. 2. Ata që do ta marrin librin e tyre pas shpine.

“فَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ” - Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë” – Këtu na jepet shenjë se ka prej njerëzve që do ta marrin librin e veprave të tyre në dorën e djathtë. Njerëzit gjithsesi kanë vepruar, mirëpo një grup do ta marrin librin në dorën e djathtë dhe të tjerët pas shpine. Ai që ka bërë punë të mira me të cilat Allahu ka qenë i

kënaqur, do ta marrë librin e tij në dorën e djathtë. Dhe shpërblimi për të do të jetë:

“فَسَوْفَ يُحَاسِبُ حِسَابًا يَسِيرًا” - do ta ketë të lehtë llogarinë”-

Llogaria e lehtë është vetëm përmendja/numërimi i veprave që ka bërë (ke bërë këtë mëkat, ke bërë atë mëkat). Ka ardhur në hadith se Allahu pastaj do t'i thotë: **“T'i kam mbuluar në dunja, do t'i fali sot.”** Në këtë na shfaqet mirësia dhe dhuntia që Allahu ia jep robët të Tij besimtar.

“وَيُنْقَلَبُ إِلَىٰ أَهْلِهِ مَسْرُورًا” - dhe do të kthehet i gëzuar tek të afërmit e tij” -Pas kësaj llogarie (të lehtë) kthehet te familja e tij, që është duke e pritur në xhenet. Gëzimi i zemrës do t'i shfaqet në fytyrën e tij.

“وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ” - Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës”- Tani tregon për grupin e dytë të njerëzve.

Të tillit do t'i jepet libri në dorën e majtë dhe pas kësaj ajo do t'i kthehet/përdredhet pas shpinës, kjo si ndëshkim prej Allahut ngase e ka lënë pas shpine Kuranin e nuk ka punuar me të.

“فَسَوْفَ يَدْعُوا ثُبُورًا” - do të lutet për të vdekur”- Do të lutet për

shkatërrimin e vet, për vdekjen e vet, do të thotë: “O i mjeri unë! Sikur të kisha vdekur! Sikur të isha shkatërruar!”, e të ngjashme. E kap dëshpërimi dhe sheh se nuk ka shpëtim dhe se për të përfundimi është zjarri i xhehenemit. Por, ky pendim e dëshpërim nuk do t'i bëjë dobi sepse Dita e Gjykimit është Dita e shpërblimit apo e dënimit për veprat, ndërsa dunjaja është vendi i veprimit (të veprave).

Komentimi i ajeteve në vijim mungon (për shkak të problemeve teknike gjatë incizimit):

“وَيَصْلَى سَعِيرًا” - **dhe në zjarr do të digjet**”- Këta janë fatkeqët, që meritojnë xhehenemin.

“إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا” - **sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij**”-

“إِنَّهُ ظَنَّ أَنْ لَنْ يَحُورَ” - **duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari)**”-

“بَلَىٰ إِنَّ رَبَّهُ كَانَ بِهِ بَصِيرًا” - **Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka vëzhguar të gjitha punët e tij!**”

Pastaj Allahu betohet:

“فَلَا أُفْسِمُ بِالشَّفَقِ” - **Betohem në kuqërrimin e muzgut**” – Shefek është kuqërrima e muzgut, pasi perëndon dielli.

“وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ” - **në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj**”- Nata mbledh egërsirat, insektet, zvarranikët, gjithashtu mbledh njerëzit të cilët tubohen me njëri-tjetrin (sipas një interpretimi të disa dijetarëve).

“وَالْفَقْرِ إِذَا تَسَقَى” - **si dhe në hënën e plotë**”- Kjo është në netët e bardha (nata 13, 14 dhe 15), kur netët janë të ndritshme. Allahu betohet në natën pastaj në hënën, sepse hëna është shenjë e natës. Pastaj sjellë atë për të cilën betohet:

“لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَنْ طَبَقٍ” - **se ju, me siguri, do të kaloni gjendje pas gjendje!**”- Ju gjithsesi do të kaloni gjendje pas gjendje. Të gjithë njerëzit, jo vetëm muslimanët. Çdo njeri kalon nëpër

gjendje të ndryshme. Është fjala: gjendje *kohe* (herë fiton, herë humbet, herë është i gëzueshëm, herë gjen ngushtim, herë ka siguri e herë frikë etj.), gjendje *vendi* (është në një vend, pastaj në një vend tjetër, pastaj prej dunjasë kalon në jetën e varrit, pastaj në jetën e ahiretit), gjendje *trupi* (dobësia, pastaj fuqia, pastaj dobësia dhe pleqëria) dhe gjendja *e zemrave* (herë zemra lidhet me dunjanë, herë me pasuri, herë me ndërtime, herë me mjete udhëtimesh, ndërsa zemra me nivelin më të lartë është ajo që lidhet me Allahun).

Komentimi i ajeteve në vijim mungon (për shkak të problemeve teknike gjatë incizimit):

“فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ - Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!”

“وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ - E përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen në sexhde?!”

“بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يَكْذِبُونَ - Përkundrazi, ata që nuk besojnë e quajnë atë gënjeshtër.”

“وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ - Por Allahu e di mirë çfarë fshehin ata”.

“فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ - prandaj shpallu atyre dënimin e dhembshëm (që i pret të gjithë)”.

“إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ - përveç atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të shpërblehen pandërprerë.”

Surja el Buruxh – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ ۝ وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ ۝ وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ ۝ قَتَلَ أَصْحَابُ
الْأُخْدُودِ ۝ النَّارِ ذَاتِ الْوُفُودِ ۝ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ۝ وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ
بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ۝ وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۝ الَّذِي لَهُ
مُلْكُ السَّمُوتِ وَالْأَرْضِ ۝ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ۝ إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ ۝ إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا
وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۚ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْكَبِيرُ ۝ إِنَّ بَطْشَ
رَبِّكَ لَشَدِيدٌ ۝ إِنَّهُ هُوَ يَبْدِئُ وَيَعِيدُ ۝ وَهُوَ الْعَفُورُ الْوَدُودُ ۝ ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ
۝ فَعَالٍ لِّمَا يُرِيدُ ۝ هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْجُنُودِ ۝ فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ۝ بَلِ الَّذِينَ
كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ ۝ وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ ۝ بَلْ هُوَ قُرْءَانٌ مَجِيدٌ ۝ فِي لَوْحٍ
مَّحْفُوظٍ ۝

1. Për qiellin me yjësi,
2. për Ditën e premtuar,
3. për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet!
4. Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut,
5. zjarrit (të ushqyer) me lëndë djegëse,
6. kur rrinin ulur rreth tij,
7. duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!
8. Ata i munduan besimtarët, vetëm pse këta i besuan Allahut, të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd,
9. të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe që është Dëshmitar i çdo gjëje.
10. Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtarët e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehenemit dhe dënimi me djegie.

11. Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore.
12. Vërtet, ndëshkimi i Zotit tënd është i ashpër!
13. Vërtet, Ai e zë fill krijimin dhe e përsërit atë.
14. Ai është Falësi i madh, i Dhembshuri,
15. Zotëruesi i Fronit të Lavdishëm,
16. Vepruesi i gjithçkaje që dëshiron.
17. A e ke dëgjuar ndodhinë e ushtrive
18. të Faraonit dhe të fisit Themud?
19. E megjithatë, ata që nuk besojnë, vazhdojnë ta quajnë atë (Kuranin) të rremë,
20. ndonëse Allahu është pas tyre e i ka nën kontroll.
21. Përkundrazi, ai është një Kuran i lavdishëm,
22. në Pllakën e Ruajtur mirë (Leuhi Mahfûdh).

Komentimi

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ - **Për qiellin me yjësi**”- Buruxh do të thotë yjësi, një grup i madh i yjeve të vendosur në një kënd të caktuar dhe që shihen prej tokës. Janë quajtur kështu sepse qëndrojnë lartë, janë të ngritur, shihen qartë prej tokës. Allahu këtu betohet në qiellin plotë yjësi. Atij i lejohet të betohet në çfarëdo që dëshiron, ndërsa neve nuk na lejohet kjo, por duhet të betohemi vetëm në Allahun.

وَالْيَوْمَ الْمَوْعُودِ - për Ditën e premtuar"- Ajo është Dita e Kiametit. Allahu ka premtuar se ajo do të ndodhë gjithsesi. Këtë e ka sqaruar në Kuran duke mos lërë dyshime për të. Allahu thotë: “Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë.” Enbija 104.

وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ - për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet!"- Dëshmitarët që do të dëshmojnë në Ditën e Gjykimit janë të shumtë, prej tyre: Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem (do të dëshmojë se e ka zbatuar mesazhin me të cilin e ka ngarkuar Allahu), umeti musliman (do të dëshmojë se Pejgamberët e kanë dërguar në vend mesazhin e Allahut), gjymtyrët tona (do të dëshmojnë kundër nesh apo pro nesh), engjëjt. Çdokush që dëshmon me të vërtetën hyn në këtë fjalë të Allahut “për dëshmitarin**”. Kurse, “**për atë që dëshmohet**” ajo është Dita e Gjykimit dhe tmerret e frikërat e shumta që do të ndodhin atë Ditë. Allahu thotë: “Ajo është Dita në të cilën do të tubohen të gjithë njerëzit; ajo është Ditë e dëshmuar” Hud 103.**

فَتِلْ أَصْحَابُ الْأُخْدُودِ - Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut"- Pasi Allahu sjellë ato betime, flet për gjënë për të cilën betohet. Fjala “kutile” ka dy kuptime në arabisht: 1. U shkatërrofshin, apo mallkuar qofshin, 2. U vrafshin. Mallkimi është largimi i dikujt prej mëshirës së Allahut. Allahu na tregon këtu se njerëzit e Hendekut i ka larguar/përzërë prej mëshirës së Tij. Ata së pari kanë

provuar t'i detyrojnë besimtarët të braktisin besimin, mirëpo pasi nuk e kanë arritur këtë, atëherë kanë hapur hendeqe të zgjatura dhe kanë vendosur drunj të shumtë e pastaj i kanë hedhur ata besimtarë duke i djegur për së gjalli.

Njerëzit e Hendekut kanë qenë disa jobesimtarë të cilët kanë djegur me zjarr besimtarët. Janë transmetuar ngjarje të shumta se për kë është fjala. Një ngjarje thotë se kjo ka ndodhur në Sham, një tjetër thotë se kjo ka ndodhur në Jemen (mbreti jehudi i ka djegur ndjekësit e Isait alejhi ue selem).

النَّارِ ذَاتِ الْوُقُودِ - zjarrit (të ushqyer) me lëndë djegëse"- me drunj dhe gjëra të tjera.

إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ - kur rrinin ulur rreth tij"- Tregon se njerëzit e Hendeqeve kanë qenë shumë arrogantë, të ashpër, zemërngurtë. Ata kanë parë me sy zjarrin duke i djegur trupat e besimtarëve, e megjithatë kanë qëndruar ulur rreth tij, pa iu lëvizur zemra. Kjo tregon se sa njerëz të këqij e të pamëshirë kanë qenë ata!

وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ - duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!"- Ata kanë qenë dëshmues dhe kanë prezantuar në atë që ua kanë bërë besimtarëve (djegien me zjarr). Madje kanë besuar se ata e meritonin këtë ndëshkim.

وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ - Ata i munduan besimtarët, vetëm pse këta i besuan Allahut, të

Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd"- Ata janë hakmarrë kundër besimtarëve duke i dënuar dhembshëm ngase kanë besuar Allahun, të Plotfuqishmin, të Denjin për çdo lavd. Këta besimtarë kanë besuar Allahun, Atë i Cili meriton adhurimin, i Cili i ka krijuar njerëzit për ta adhuruar Atë. Ai që e adhuron Allahun e ka njohur urtësinë e krijimit të tij dhe të ardhjes së tij në këtë jetë. Allahu na tregon këtu se besimi nuk është një gjë për të cilën tjetri duhet të refuzohet apo të ndëshkohet, mirëpo ai që e refuzon besimin, ati meriton refuzimin dhe ndëshkimin. Të nënçmohen besimtarët e të dënohen duke i djegur me zjarr, kjo tregon për një armiqësi të madhe ndaj besimtarëve dhe ndaj Allahut.

“الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ” - të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe që është Dëshmitar i çdo gjëje"- Ai i Cili veçohet me këtë është Allahu. Ky sundim përfshin çdo gjë që është në qiell e tokë, Allahu i sundon dhe i drejton, madje edhe tiparet e atributet e tyre. Askush nuk mund të jetë ortak apo shok me Allahun në këtë sundim (nuk ka hise askush).

Allahu na sheh neve, prej lartë mbi shtatë qiej, Ai sheh çdo gjë dhe është Dëshmitar për çdo gjë që veprojnë njerëzit. Prej asaj që e dëshmon është dhe ajo që e bëjnë jobesimtarët ndaj besimtarëve, siç është djegia me zjarr e përmendur në këtë sure, dhe në të ardhmen do t'i ndëshkojë ata (jobesimtarët) për këtë. Megjithatë...

إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ - **Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtare e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehenemit dhe dënimi me djegie**" - Disa nga selefi kanë thënë: *"Shiko në butësinë dhe në mëshirën e Allahut! Këta jobesimtarët po i djegin miqtë dhe të dashurit e Allahut me zjarr dhe Allahu po ua paraqet pendimin (të pendohen për këtë)."* Nëse vdesin pa u penduar, i pret ky ndëshkim, e nëse pendohen atëherë Allahu ua fal. Kjo tregon se sa mëshirë të madhe ka Allahu. Disa dijetarë për fjalën **"fetenu - përndjekin/sprovojnë"** kanë thënë: *"I djegin"*. Disa të tjerë kanë thënë: *"I pengojnë prej fesë së tyre."* Ajeti përfshin të dy kuptimet. Këta jobesimtarë i kanë djegur me zjarr miqtë e Allahut, edhe Allahu do t'i ndëshkojë në të njëjtën mënyrë (me zjarr). Mirëpo, ka dallim të madh mes zjarrit të dunjasë dhe zjarrit të ahiretit (i cili është shumë më i ashpër).

Dobi të nxjerra nga ajeti: Allahu nganjëherë lejon që armiq të Tij të triumfojnë ndaj miqve të Tij. Mos u çudit nga kjo, ngase në këtë ka urtësi të cilat i di Allahu, Ai e di pse e lejon këtë. Besimtarët e sprovuar do të kenë shpërblim të madh për këtë sprovë.⁴

⁴ Sprovat me të cilat sot cenohen miuslimanët na shtyjnë të qajmë me lot dhe me zemër, mirëpo themi "Allahu është i patëmeta, këtë që e ka lejuar të ndodhë për jobesimtarët ndaj besimtarëve, është për një urtësi të cilin e di Ai." Kështu u ka ndodhur edhe muslimanëve më herët. Edhe muslimanët sot janë sprovuar me fatkeqësi e vështirësi (prej armiqve), por do të ngritën në shkallë të larta tek Allahu dhe do t'iu falen mëkatet, gjithashtu do që t'i bëjë mësim për pjesën tjetër të muslimanëve se kjo gjendje është pasojë e veprave të tyre dhe se Allahu i lejon të triumfojnë mbi besimtarët që pastaj kur t'i ndëshkojë (jobesimtarët), t'i ndëshkojë me ndëshkimin e të Plotfuqishmit.

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّتٌ تَجْرَى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۚ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ ۖ
الْكَبِيرُ - Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore” – që besojnë Allahun, engjëjt, Librat e zbritur, të Dërguarit e dërguar, Ditën e Fundit dhe kaderin (të mirin e të keqin). “bëjnë vepra të mira” d.m.th. të sakta, ato të cilat janë ndërtuar në singeritet (të bëra për hir të Allahut) dhe në ndjekjen e sunetit profetik. Së bashku me besimin është kusht bërja e veprave të mira. “do të ketë kopshte...” kjo do të ndodhë pas ringjalljes, ata që kanë besuar Allahun dhe kanë vepruar vepra të mira do të hyjnë në këto kopshte (xhenete) nëpër të cilët rrjedhin lumenj. “nëpër të cilët rrjedhin lumenj” ata rrjedhin mbi tokën e xhenetit pa pasur nevojë të kenë shtrat, nuk vërshojnë (djathtas apo majtas), nuk kanë nevojë për kanal për të rrjedhë; lumenjtë e xhenetit rrjedhin ngado që dëshiron njeriu, ai i drejton sipas dëshirës së tij. “fitorja madhështore”- këto xhenete dhe kënaqësitë në to janë fitorja madhështore. Fitorja- shpëtimi prej gjërave të cilave u frikësohesh (dënimi i Allahut) dhe arritja e gjërave të cilat i synon.

إِنَّ بَطْشَ رَبِّكَ لَشَدِيدٌ - Vërtet, ndëshkimi i Zotit tënd është i ashpër” – ndëshkimi apo hakmarrja që Allahu ka përgatitur për jobesimtarët. Ai e ndëshkon vetëm atë që e

meriton dënimin e Tij. Ndërsa, me atë që nuk e meriton ndëshkimin e Tij, i cili është besimtar dhe që vepron vepra të mira, Allahu vepron me mëshirë e butësi. Mëshira e Allahut është shumë më e gjerë dhe më gjithëpërfshirëse sesa ndëshkimi i Tij. Ai na fal shumë prej gabimeve e gjynaheve tona, na mbulon shumë prej të metave e gjynaheve, na largon shumë ndëshkime për mëkatet tona dhe na jep shumë prej mirësive të Tij.

“إِنَّهُ هُوَ يُدِّئُ وَيُعِيدُ” – Vërtet, Ai e zë fill krijimin dhe e përsërit atë – Të gjitha çështjet kanë filluar prej Allahut dhe përfundimi i tyre është tek Ai, si: krijimi, dispozitat etj. Allahu ka filluar çdo gjë dhe e rikthen tek Ai. E gjithë çështja pra është në Dorën e Tij.

“وَهُوَ الْعَفْوَ الْوَدُودُ” - Ai është Falësi i madh, i Dashuri – Magfireti është mbulimi i gjynaheve dhe falja e tyre, e nuk është qëllimi vetëm mbulimi i tyre. Allahu është Shumëfalës. Ai i mbulon gjynahet e robërve të Tij (nuk ua zbulon para njerëzve për t'i demaskuar dhe turpëruar) dhe pastaj nuk i dënon për to, por i fal. Obligim mbi njeriun është të pendohet dhe të kërkojë falje, që Allahu t'ia fshijë edhe gjurmët e mëkateve. El Wedud – Ai që duhet prej të tjerëve dhe gjithashtu Ai Cili i do të tjerët. Atë e duan të dashurit e Tij. Allahu i do disa prej robërve të Tij, veprave dhe vendeve.

ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ - Zotëruesi i Fronit i Cili është Madhështor"- pastaj Allahu tregon për madhështinë e madhërinë e Tij. Allahu është Ai që e zotëron dhe e sundon Arshin. Arshi është Froni mbi të cilën është lartësuar Allahu. Arshi është krijesa më e madhe dhe më e gjerë të cilën e ka krijuar Allahu.

فَعَالٌ لِّمَا يُرِيدُ - Vepruesi i gjithçkaje që dëshiron"- Vepron shumë dhe sipas dëshirës së Tij. Askush nuk mund ta pengojë të veprojë atë që dëshiron në sundimin e Tij. Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Në këtë ajet pohohet dëshira e Allahut, e plotë, e përsosur. Askush nuk mund të dëshirojë të veprojë diçka veçse pas dëshirës së Allahut. Dëshira jonë është e kushtëzuar me dëshirën e Allahut. Dëshira e Allahut përfshin veprat e Tij dhe veprat e njerëzve.

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْجُنُودِ - A e ke dëgjuar ndodhinë e ushtrive"- Këto fjalë ia drejton Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe çdokujt. Vjen në formë të pyetjes për të tërhequr vëmendjen e atij që e dëgjon këtë ajet, që t'i kushtojë kujdes se çfarë vjen/pason pas pyetjes.

فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ - të Faraonit dhe të fisit Themud?"- A ke dëgjuar për ndodhinë e ushtrive të tyre? Përgjigja është: Po. Allahu na ka treguar se çfarë ka ndodhur me ta, na ka sjellë lajmin për ta (në shumë ajete e sure), në të cilin ka mësim. Faraoni i cili ka jetuar në kohën e Musait alejhi ue selem ka

qenë diktator, tiran, mendjemadh, saqë ka thënë për veten e tij se është zoti, se vetëm ai duhet të adhurohet, ai është përqeshur me Musain kur i ka sjellë argumente dhe e ka sfiduar, duke i thënë se të kanë bërë magji, madje ai lavdërohej shumë te populli i tij dhe te Musai dhe mbahej për i madh. Mirëpo, Faraonin pastaj e mohuan njerëzit më të afërt-magjistarët e tij, duke kaluar në besimin e saktë, thanë: **“Ne besojmë në Zotin e botëve- Zotin e Musait dhe të Harunit”**. Allahu, si përfundim, e ka fundosur Faraonin dhe ushtrinë e tij. Ndërsa, popullit Themud Allahu u ka dhënë forcë të madhe saqë kanë gdhendur kodra duke bërë shtëpi në to. Kur ata e kanë përgënjeshtuar Profetin e tyre Salihun alejhi ue selem, Allahu i ka shkatërruar përmes një britme të vetme.

Përmes këtyre tregimeve të këtyre popujve, Allahu ka dashur ta ngushëllojë dhe forcojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe t'i tregojë se Ai që i ka ndihmuar Profetët e mëhershëm të triumfojnë kundër armiqve të tyre (përgenjështues), Ai gjithsesi do ta ndihmojë edhe atë të triumfojë kundër armiqve të tij. Dhe gjithashtu, përmes këtyre tregimeve Allahu kërcënon ashpër idhujtarët e Mekës të cilët përgënjeshtrojnë Pejgmaberin salAllahu alejhi ue selem; ka dashur t'iu thotë se ju nuk jeni më të fortë se ata popuj, përderisa i ka shkatërruar ata, edhe juve do t'iu shkatërrojë.

“بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ” - E megjithatë, ata që nuk besojnë, vazhdojnë me përgënjeshttrim” – Ka dashur të tregojë se janë të zhytur në të, përgënjeshtrimi e mohimi i ka përfshirë nga të gjitha anët. Në ajet përfshihet çdokush që mohon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, qoftë: idhujtar, pagan, hebre, i krishterë e të tjerë.

“وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ” - ndonëse Allahu është pas tyre e i ka nën kontroll”- Askush nuk mund t'i ikë Allahut, dijes, fuqisë, pushtetit, dënimit e ndëshkimit të Tij. Por, nganjëherë Allahu i jep afat mohuesit dhe zullumqarit, e pastaj kur e kap me ndëshkim nuk ka mundësi të shpëtojë..

“بَلْ هُوَ قُرْءَانٌ مَجِيدٌ” - Përkundrazi, ai është një Kuran i lavdishëm”- Ai me të cilën ka ardhur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është Kuran i lavdishëm, madhështor. Ky përshkrim është për Kuranin dhe për çdokënd që e bartë atë, e lexon siç e meriton, kapet pas tij dhe e zbaton atë. I tilli do të arrijë lavdinë në këtë dunja.

“فِي لَوْحٍ مَحْفُوظٍ” - në Pllakën e Ruajtur mirë (Leuhi Mahfûdh)”- Ajo është tek Allahu, është Libri Amëz. Në të nuk ndryshohet asgjë. Aty janë shkruar kaderet e krijesave të Tij, çdo gjë që do të ndodhë deri në Ditën e Kiametit. Prej gjërave që janë shkruar në të është zbritja e Kuranit te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Quhet Mahfudh sepse askush nuk ka mundësi ta prekë atë (ta ndryshojë) dhe se Allahu e ka ruajtur prej ndryshimeve e zëvendësimeve.

Allahu në fillimin e sures betohet në qiellin dhe në yjet e vendosura lartë në qiell: “**Për qiellin me yjësi**”, ndërsa në fundin e saj thotë: “**Përkundrazi, ai është një Kuran i lavdishëm**”. Kjo na jep të kuptojmë se kush do që të jetë i lartë dhe të arrijë lavdinë në këtë dunja, atëherë duhet t’i përmbahet këtij Kurani. Umeti nuk mund të ngritët e nuk mund t’i kthehet lavdia përveçse kur t’i kushtojë rëndësi Kuranit e të kapet pas tij (ta lexojnë, ta mësojnë dhe ta zbatojnë) dhe pas sunetit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem (e jo të shkojë pas sistemeve e ligjeve të prishura të njerëzve jobesimtarë të bazuara mbi padrejtësi).

Surja et Taarik – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ○ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ○ النَّجْمُ الثَّاقِبُ ○ إِنْ كُلُّ نَفْسٍ لَمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ ○ فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ ○ خُلِقَ مِنْ مَّاءٍ دَافِقٍ ○ يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ ○ إِنَّهُ عَلَى رَجْعِهِ لَقَادِرٌ ○ يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ ○ فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ ○ وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ ○ وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ ○ إِنَّهُ لَقَوْلُ فَصْلٍ ○ وَمَا هُوَ بِأَنْهَزِلَ ○ إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ○ وَآكِيدُ كَيْدًا ○ فَمَهْلِكُ الْكَافِرِينَ أَهْلَهُمْ ○ رُؤُودًا ○.

1. Për qiellin dhe për vizitorin e natës!
 2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës?
 3. Ai është ylli që shpon terrin.
 4. Për çdo njeri ka mbikëqyrës.
 5. Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar:
 6. është krijuar prej një lëngu që hidhet
 7. e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve.
 8. Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm për ta kthyer (në jetë) atë
 9. ditën, kur do të zbulohen të fshehtat,
 10. kur njeriu nuk do të ketë as fuqi, as ndihmës.
 11. Për qiellin që kthehet pareshtur
 12. dhe për Tokën që plasaritet,
 13. që kjo është një Fjalë ndarëse,
 14. dhe nuk është aspak shaka!
 15. Në të vërtetë, ata ngrenë kurthe,
 16. por dhe Unë ua pres me kurth.
 17. Prandaj, jepu pak afat jobesimtarëve, lëri të qetë edhe për pak.
-

Komentimi

- وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ - **Për qiellin dhe për yllin shpues!**" - Fillon me betime. Allahu betohet në çfarëdo prej krijesave të Tij (e njeriut nuk i lejohet). Me këtë Ai shfaq madhështinë e Tij. Fjala "**sema**" – në arabisht quhet çdo gjë që është lart njeriut, dhe qëllimi këtu është: çdo gjë që është ndërmjet njeriut dhe qiejve. Me këtë betim përfshin shtatë palë qiej dhe çdo gjë që është mes tokës dhe qiejve. Ndërsa, "**طَارِق - taarik**" është ylli shpues, quhet kështu sepse me dritën e tij shpon errësirën.

- وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ - **E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës?"**

- النَّجْمِ الثَّاقِبِ - **Ai është ylli që shpon terrin."** – Me "**en nexhm**" ose është për qëllim një yll shpues apo të gjitha yjet (ngase të gjithë ata ndriçojnë, shpojnë errësirën). Sidoqoftë, këto yje të vendosura në qiell tregojnë për përsosmërinë e fuqisë së Allahut.

- إِنَّ كُلَّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ - **Nuk ka asnjë shpirt (njeri) veçse ai ka një mbikëqyrës."** - Ka një engjell që shkruan çdo gjë që bën prej veprave, qofshin të mira apo të këqija, dhe i ruan ato. Shkruan çdo gjë, qoftë vepër, fjalë apo veprim, apo fjalë dhe vepër e zemrës (çdo gjë që e mendon/thotë me zemër dhe e bën me zemër). Pastaj njeriu këtë do ta gjejë të shkruar në libër i cili do të hapet para tij (në Ditën e Gjykimit).

- فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ - **Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar"** - të mendojë thellësisht, se a është krijuar prej hekuri, apo çeliku, apo ndonjë gjëje të fortë etj.

“خُلِقَ مِنْ مَّاءٍ دَافِقٍ” - është krijuar prej një lëngu që hidhet - qëllimi është për spermën (lëngu i mashkullit). Edhe pse njeriu është krijuar prej këtij lëngu (të dobët, të paktë), është e çuditshme se si pastaj tregohet mendjemadh dhe e kundërshton Allahun.

“يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ” - e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve – Vendi prej nga del është i thellë.

“إِنَّهُ عَلَى رَجْعِهِ لَقَادِرٌ” - Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm për ta kthyer (në jetë) atë - Ai i Cili është i fuqishëm të krijojë njeriun prej këtij lëngu që hidhet, gjithashtu është i fuqishëm ta kthejë, ta ringjallë atë. Përderisa Allahu na ka krijuar prej hiçit, atëherë për Atë është shumë më e lehtë të na kthejë e ringjallë.

“يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ” - ditën, kur do të zbulohen të fshehtat – Të shfaqen gjërat që kanë qenë në zemër, sepse llogaria në Ditën e Gjykimit do të bëhet në bazë të asaj që ka qenë në zemra (me çfarë qëllimi janë bërë veprat), ndërsa në këtë dunja llogaria është në bazë të veprave të jashtme. Andaj, njeriu e ka për obligim t’iu kushtojë (edhe) më shumë kujdes veprave të zemrës sesa veprave të jashtme (të gjymtyrëve), sepse veprat e gjymtyrëve janë shenjë e jashtme, kurse veprat e zemrës janë boshti rreth të cilave vërtiten veprat e jashtme (janë baza). Kur besimi vendoset thellë në zemrën e njeriut, atëherë do ta nxisë të veprojë vepra të mira. Prandaj, duhet të kujdesemi për veprat e zemrës, për besimin që kemi në zemër, kah po e drejtojmë zemrën, a po e pastrojmë atë prej njollave të shirkut, bidatit e mëkateve, urrejtjes, zilisë e armiqësisë ndaj muslimanëve dhe të tjerave.

- فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ - kur njeriu nuk do të ketë as fuqi, as ndihmës.” – Nuk do të ketë fuqi të veten e as të jashtme (të vijë ta ndihmojë dikush), nuk do të ketë forcë të largojë dënimin e Allahut, as ndihmues ta ndihmojë dhe ta mbrojë nga kjo.

- وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ - Për qiellin që kthehet pareshtur” – Allahu prapë betohet në qiell, sikur në fillim të sures. Pse Allahu betohet dy herë për qiellin në këtë sure, një herë në fillim dhe herën tjetër në mesin e sures? Lidhja mes kësaj: në fillim betohet në qiellin dhe në yllin (apo në yjet) shpues me të cilin godet shejtanët (të cilët duan të dëgjojnë vjedhurazi nga ajo se çfarë u shpallet engjëjve, e pastaj atë informatë ua bartin fallxhorëve të cilët e përziejnë me njëqind gënjeshtër, dhe në këtë mënyrë pastaj njerëzit mendojnë se ata dinë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen), duke na dhënë shenjë se Allahu e ka ruajtur Kuranin, Shpalljen e Tij, gjatë zbritjes (duke mos pasur mundësi të ndërhyjnë shejtanët në të). Pastaj në mes të sures betohet në qiellin se ky Kuran është Fjalë ndarëse.

“الرَّجْعِ – që kthehet” d.m.th. qielli sjellë shiun, shiu bie në tokë, avullohet (dhe të tjera gjatë procesit) dhe ngjallet toka e vdekur. Allahu na tregon se ashtu siç shiu është jetë për tokën, edhe ky Kuran është jetë për zemrën e njeriut.

- وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ - dhe për Tokën që plasaritet” – çahet e plasaritet nga mbirja e dalja e bimëve, prej shiut që bie dalin bimët e ndryshme.

إِنَّهُ لَقَوْلٌ فَصْلٌ - që kjo është një Fjalë ndarëse"- Kurani është Fjalë e Allahut. E ndan të vërtetën prej të pavërtetës, ndan të devotshmit prej mëkatarëve etj. Allahu ka folur me Kuran, pastaj ia ka shpallur këtë Fjalë të Tij Xhibrilit, pastaj Xhibrili ka zbritur me të te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i cili ka dëgjuar fjalët e tij.

وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ - dhe nuk është aspak shaka!"- Por është Fjalë ndarëse, ngase është prej Allahut, është i vërtetë, të gjitha lajmet, dispozitat, ligjet e tij janë të vërteta e të drejta. Ai që e lexon Kuranin fiton shpërblime. Edhe nëse e lexon vazhdimisht kurrë nuk do të lodhet nga kjo. Nëse e lexon me meditim, Allahu ia hap atij të kuptuarit. Ndërsa, librat e tjerë nuk janë të tillë. Sa herë që i lexon ato, do të lodhet dhe fillon të mos i pëlqejë. Me Librin e Allahut nuk ndodh kështu, ngase ai nuk është "hezl – shaka, tallje". Sa më shumë që njeriu lexon Kuran dhe mediton rreth kuptimeve të tij thellësisht, çdo herë do të gjejë kuptime të reja.

إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا - Në të vërtetë, ata ngrenë kurthe" – Ata janë jobesimtarët, përgenjështuesit e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, ata ngrehin kurthe të mëdha kundër tij dhe kundër besimtarëve.

وَأَكِيدُ كَيْدًا - por dhe Unë ua pres me kurth".

فَمَهْلِ الْكَافِرِينَ أَمْهَلُهُمْ رُؤُودًا - Prandaj, jepu pak afat jobesimtarëve, lëri të qetë edhe për pak" – Ky ka qenë kërcënim i madh prej Allahut ndaj kurejshëve, dhe njëkohësisht ka qenë ngushëllim ndaj Pejgamberit

salAllahu alejhi ue selem. Allahu i ka premtuar atij triumf e fitore. Kështu dhe ka ndodhur. Ai salAllahu alejhi ue selem ka dal prej Mekës për në Medine dhe pastaj (diku pas 8 viteve) është kthyer në Meke si triumfues, fitues dhe çlirues.

Surja Ale – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ○ الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى ○ وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَى ○ وَالَّذِي أَخْرَجَ
الْمَرْعَى ○ فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَى ○ سَنُقْرِئُكَ فَلَا تَنسَى ○ إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ ○ إِنَّهُ يَعْلَمُ
الْغُحْنَ وَالْخُفَى ○ وَنُنَبِّئُكَ لِلْإِنْسَانِ ○ فَذَكَرْ إِنْ نَفَعْتَ الذِّكْرَى ○ سَيَذَكِّرُ مَنْ
يَخْشَى ○ وَيَتَجَنَّبُهَا الْأَشْقَى ○ الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى ○ ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا
يَحْيَى ○ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ○ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ○ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا
○ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ ○ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ○ صُحُفٍ إِبْرَاهِيمَ
○ وَمُوسَى ○

1. Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit,
2. që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt;
3. që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën;
4. që bën të rriten kullotat
5. dhe pastaj të shndërrohen, të thahen e të vyshken.
6. Ne do të të bëjmë ty (Muhamed) të lexosh (Shpalljet Tona), kështu që nuk ke për të harruar,
7. përveç asaj që do Allahu. Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë.
8. Do të ta lehtësojmë ty rrugën e drejtë,
9. prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme!
10. Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut),
11. e do t'i shmanget vetëm më i keqi,
12. i cili do të digjet në zjarrin e madh,
13. ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë.
14. I shpëtuar është ai që pastrohet,
15. që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!
16. Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote,
17. ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.

18. Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta,
19. në Fletët e Ibrahimit dhe Musait.
-

Komentimi

- سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى - **Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit**” – Me këtë Allahu i drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, por kjo përfshin edhe umetin. Sebbih – të pastrosh Allahun prej çdo gjëje që nuk i takon madhështisë e madhërisë së Tij, prej çdo të keqeje, të mete e mangësie, të besosh se Ai është i përsosur në të gjitha aspektet. Prej emrave të Allahut është El Kuddus – I Pastri nga çdo e metë dhe mangësi.

Për pjesën **“Lavdëro emrin e Zotit tënd”**, shejh Uthejmini thotë: *“Bëj tesbih Zotin tënd duke e përmendur emrin e Tij.”* Kjo ngase njeriu mund të bëjë tesbih vetëm me zemër, pa e përmendur emrin e Tij, apo vetëm me gjuhë, kurse Allahu në këtë ajet na mëson se duhet të bëjmë tesbih me zemër dhe me gjuhë (kjo është forma më e plotë).

- **“Më të Lartit”** - Allahu është më i Larti me Cilësitë e Tij dhe me Qenien e Tij. Allahu ka Cilësitë më të Përsosura. Ai është i lartësuar mbi Arshin e Tij.

- الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى - **që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt**” - Allahu ka krijuar çdo gjë prej mos ekzistencës. Të gjitha krijesat e krijuara prej Tij kanë qenë një hiç dhe Ai ua ka dhënë ekzistencën. Njeriu nuk mundet t’i japë diçkaje ekzistencë prej mos ekzistencës. Kjo i takon

vetëm Allahut. Ai krijon me një fjalë të vetme “**Bëhu**” dhe ajo bëhet. Çdo gjë e ka krijuar në formën më të mirë, më të përsosur, më të përshtatshme (shembull: nuk ka krijesë më të bukur sesa njeriu, ai kokën e ka lartë, zemrën në mesin e trupit, në gjoks). Në këtë ajet së pari hyn njeriu, pastaj të gjitha krijesat e tjera.

- وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَىٰ - që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën” – E ka bërë në masë të caktuar, sa i përket gjendjeve, përfundimit, cilësive, afatit të jetës etj. Pastaj e ka udhëzuar atë, me udhëzimin sheriatik dhe me udhëzimin e krijimit. Allahu çdo gjë (me udhëzimin e krijimit) e udhëzon drejt asaj për të cilën është krijuar. Ndërsa, udhëzimi fetar-sheriatik është më i rëndësishëm (për njerëzit) sesa tjetri. Allahu ua ka sqaruar të vërtetën njerëzve, edhe jobesimtarëve, por ata e refuzuan. Ky lloj i udhëzimit është qëllimi për të cilin sot jeton njerëzimi, për të cilin njerëzit janë krijuar, **“Xhindet dhe njerëzit nuk i kam krijuar për asgjë tjetër vetëmse që të Më adhurojnë”** Dharijat 56.

- وَالَّذِي أَخْرَجَ الْمَرْعَىٰ - që bën të rriten kullotat” - Në atë që ai e ka caktuar për krijesat e tij hyn edhe furnizimi, ky furnizim vjen prej bimëve, prej të cilave ushqehen kafshët dhe njerëzit. Allahu i ka udhëzuar njerëzit se si t’i punojnë bimët, t’i korrin, t’i shfrytëzojnë, t’i gatuajnë etj.

- فَجَعَلَهُ غَنَاءً أَحْوَى - dhe pastaj të shndërrohen, të thahen e të vyshken"- Allahu veçon kullosat sepse në të kullosin kafshët, dhe ato pastaj i bën të vyshken (i bën të padobishme). Përderisa Allahu i veçon kullosat dhe menjëherë përmend se ato vyshken, duke sjellë këto dy ajete menjëherë pas ajetit ku përmendet krijimi e udhëzimi, atëherë qëllimi është që të sqarojë përfundimin e krijesave. Ky ajet jep shembullin e dunjasë (çfarë do të ndodhë me njerëzit). Në fillim do të jenë sikurse kullosat, që lulëzojnë, do të jenë në jetë të kënaqshme, në lumturi e bukuri, por shumë shpejt do të kalojnë në dëshpërim, ose në këtë dunja ose në ahiret. Përfundimi i disa njerëzve është sikur i këtyre kullosave: nuk do të kenë dobi prej jetës në të cilën jetojnë. Këtu na jepet shembulli i atij që është dhënë pas kësaj jete.

- سَنُقَرِّكَ فَلَا تَنْسَى - Ne do të të bëjmë ty (Muhamed) të lexosh (Shpalljet Tona), kështu që nuk ke për të harruar"- ky është një premtim prej Allahut për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem, i cili në fillimin e Shpalljes prej Allahut, ka shpejtuar (e ka përsëritur menjëherë ajetin) dhe Allahu e këshillon në ajetet e sures Kijame **“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kuranit me gjuhën tënde! Ne e kemi për detyrë t’i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë.”** Andaj, pas këtyre ajeteve ai ka heshtur kur i është zbritur Shpallja derisa Xhibrili ka përfunduar, pastaj e ka përsëritur atë që ka dëgjuar prej tij.

- إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَى - përveç asaj që do Allahu.

Vërtet, Ai e di të dukshmen dhe çka është e fshehtë"-

Nëse Allahu dëshiron që Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem të harrojë diçka prej Kuranit, atëherë do të harrojë. Pastaj vijon: Allahu e di atë që njeriu e shfaq dhe e flet haptazi, por e di edhe atë që e flet fshehtas në veten e tij, që nuk e zbulon tek të tjerët.

- وَيُسِّرْكَ لِلْيُسْرَى - Do të ta lehtësojmë ty rrugën e drejtë"- I

jep një premtim tjetër. Çdo gjë do t'ia lehtësojë, sidomos kur është fjala për adhurimet ndaj Allahut. Ai salallahu alejhi ue selem sa herë që është ndodhur në një vështirësi, i ka ardhur lehtësimi prej Allahut.

- فَذَكِّرْ إِنْ نَفَعَتِ الذِّكْرَى - prandaj këshillo, nëse këshilla do të

jetë e dobishme!"- Përkujtoji të tjerët me fjalët e Allahut,

argumentet e Tij, apo me ligjet e vendosura në univers, me ndëshkimet, me shpërblimet etj. Disa dijetarë kanë thënë se fjalia është e kushtëzuar: këshillo nëse këshilla bën dobi. Nëse sheh se nuk bën dobi, atëherë mos i këshillo të tjerët, ngase nuk ka dobi t'i këshillosh ata që nuk e duan dhe nuk e pranojnë këshillën. Kurse disa dijetarë thonë: Këshilloji të tjerët në çdo gjendje, çdoherë, pa përjashtim, përderisa këshilla bën dobi, gjithmonë do të jetë dikush tek i cili këshilla do të bëjë dobi. Madje, edhe nëse askush nuk e pranon këshillën atëherë do të ketë dobi vetë ai që këshillon. Ndërsa disa dijetarë të tjerë kanë thënë: Nëse je i bindur se këshilla bën dobi atëherë është obligim, por nëse jo, atëherë je i lirë nëse do këshillon ose jo. Sidoqoftë, themi se patjetër duhet të këshillosh të tjerët aq sa ke dije, edhe

nëse je i bindur se këshilla nuk do t'iu bëjë dobi, mos e ndal asnjëherë atë (madje mjafton si sukses që njerëzit të mësojnë nga këshilla se filan gjë qenka e ndaluar apo e lejuar, edhe nëse nuk e pranojnë këshillën tënde).

سَيَذْكُرُ مَنْ يَخْشَى - Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut)"- Pastaj, njerëzit në pranimin e këshillës janë dy lloje: 1. Ata që këshillohen, 2. Ata që ia kthejnë shpinën. Këshillën e pranon vetëm ai që ka frikë Allahun, dhe kuptimi i kësaj frike (hashje) është: ka frikë Allahun ngase ka dije për madhësitinë e Allahut.

وَيَجْنِبُهَا الْأَشْقَى - e do t'i shmanget vetëm më i keqi"- Eshka është ai me fatin e keq (jobesimtari). Është ai për të cilin është shkruar të jetë prej banorëve të xhehenemit. Ai shmanget dhe nuk i bën dobi këshilla. Jobesimtari është ai të cilit nuk i bën dobi këshilla dhe përkujtimi.

الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى - i cili do të digjet në zjarrin e madh"- Kubraa është zjarri shumë i madh i xhehenemit.

ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى - ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë"- Nuk do të vdesë e të rehatohet/shpëtojë prej ndëshkimit. Nuk do të jetojë me jetë të lumtur edhe pse është i gjallë, por i gjallë duke u ndëshkuar ashpër. Është në vështirësi aq të madhe saqë do të shpresojë të vdesë dhe do ta lusë Allahun t'ia marrë shpirtin.

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى - I shpëtuar është ai që pastrohet"- Ka fituar atë që dëshiron dhe synon, ka shpëtuar prej asaj që ka

frikë e që nuk e pëlqen, ka arritur çdo të mirë dhe është larguar prej çdo të keqeje.

“ai që pastrohet”-kjo edhe nga ana e jashtme edhe nga ana e brendshme. Së pari, njeriu duhet të pastrohet *në raport me Allahun*: prej shirkut (të madh e të vogël), prej syfaqësisë (t’ia kushtojë adhurimet Allahut me sinqeritet, jo të ketë qëllim të lavdërohet, të kërkojë pozitë etj.), prej hipokrizisë, prej dyshimeve etj. Të pastrohet *në raport me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem*: të pasojë sunetin e tij plotësisht, të mos bëjë bidate (të mëdha apo të vogla). Të pastrohet *në raport me muslimanët*, me njerëzit: të dojë për ta atë që do për veten e tij, të ketë zemër të pastër prej zilisë, mllëfit, urrejtjes, xhelozisë, të ruajë gjuhën ndaj muslimanëve (përgojimi, bartja e fjalëve, gënjeshtër etj.), të ruajë gjymtyrët (të mos i godasë ata), të largohet prej shkaqeve që çojnë në përçarje, të ndjekë rrugët që çojnë në dashurinë ndërmjet muslimanëve (selami etj.).

“وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى” - që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”- E kujton Allahun duke përmendur emrin e Tij (thotë: SubhanAllah, elhamdulilah etj.), kjo përfshin kujtimin me zemër dhe me gjuhë. Përveç që e kujton me zemër, e përmend edhe me gjuhë. Këtu hyn dhe kujtimi përmes adhurimeve që bën. Kur e përmend emrin e Allahut me gjuhë, e ndjen këtë me zemër dhe këshillohet.

“që fal namaz”- nuk ka shpëtim veçse duke e kryer këtë obligim.

“بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا” - Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj dunjaje”- Kjo është në natyrën e

njeriut. Kjo dunja është kalimtare, e mangët, dikur do të përfundojë, sado që njeriu të jetojë gjatë në të do të vdesë, sado që të arrijë prej të mirave nuk do të jetë i kënaqur e i lumtur, ngase ajo është dunja, e ka cilësi mangësinë, njeriu nuk ka mundësi të arrijë në të plotësimin dhe lumturinë absolute që synon.

- وَالْآخِرَةُ خَيْرٌ وَأَبْقَى - ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar” – Ahireti është më i mirë se dunjaja. Të mirat e kënaqësitë në të cilat ka përgatitur Allahu në ahiret, janë të përhershme, lumturia aty nuk zbehet kurrë, njeriu është vazhdimisht në lumturi të plotë në të.

- إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى - Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta”-

- صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى - në Fletët e Ibrahimit dhe Musait” - Ky parapëlqim dhe favorizim i dunjas, para jetës së ahiretit, ka qenë i shkruar edhe në Fletat e mëhershme, të zbritura.

Surja Gashiye - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْعَشِيَةِ ۝ وَجُودِ يَوْمِنِ خَشَعَةٍ ۝ عَامِلَةٍ نَّاصِبَةٍ ۝ تَصَلَّى نَارًا
حَامِيَةً ۝ تُسْقَى مِنْ عَيْنِ عَانِيَةٍ ۝ لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ ضَرِيْعٍ ۝ لَا يُسْمَنُ وَلَا
يُغْنَى مِنْ جُوعٍ ۝ وَجُودِ يَوْمِنِ نَاعِمَةٍ ۝ لِسَعِيْهَا رَاضِيَةٌ ۝ فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ۝ لَا
تَسْمَعُ فِيْهَا لَغِيَةً ۝ فِيْهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ ۝ فِيْهَا سُرُرٌ مَّرْفُوعَةٌ ۝ وَأَكْوَابُ
مَّوْضُوعَةٌ ۝ وَنَمَارِقُ مَصْفُوفَةٌ ۝ وَزُرَابِيُّ مَبْثُوثَةٌ ۝ أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبْلِ كَيْفَ
خُلِقَتْ ۝ وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ۝ وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ۝ وَإِلَى الْأَرْضِ
كَيْفَ سُطِحَتْ ۝ فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ ۝ لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُصَيِّرٍ ۝ إِلَّا مَنْ تَوَلَّى
وَكَفَرَ ۝ فَيُعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ ۝ إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابَهُمْ ۝ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ ۝

1. A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kiametin)?
2. Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish,
3. që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë).
4. Ata do të digjen në zjarr të nxehtë
5. e do të pinë nga burime të valuara.
6. Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese,
7. të cilat as nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajnë urinë.
8. Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara,
9. të kënaqura për punët e bëra.
10. Ata do të jenë në kopshtin e lartë,
11. në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe.
12. Atje ka një burim rrjedhës uji
13. dhe divane të ngritura,
14. ka kupa të vëna (për t'u mbajtur në dorë)

15. dhe jastëkë të renditur,
 16. si dhe shumë qilima të shtruar.
 17. Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!
 18. Po qiellin, se si është ngritur?!
 19. Po malet, se si janë vënë të patundur?!
 20. Po Tokën, se si është shtrirë?!
 21. Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues
 22. dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!
 23. Sa për ata që shmangen dhe nuk besojnë,
 24. Allahu do t'i ndëshkojë me dënimin më të madh.
 25. Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne
 26. dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!
-

Komentimi

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ - A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kiametin)?"- I drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem e pastaj umeti e pasojnë atë, ose i drejtohet çdo kujt që kupton (ka logjikë). Allahu këtë pyetje e ka bërë me qëllim që t'i nxisë njerëzit për vepra të mira, të përgatiten për ditën kur do të vijë el gashije. Ndërsa, kuptimi tjetër pse Allahu e ka sjellë këtë pyetje, është që të tregojë se ajo është një ditë shumë e madhe. El gashije është ngjarja e madhe që përfshin çdo gjë, njerëzit, krijesat, universin, e ajo është Dita e Kiametit (pra prej emrave të saj është dhe el gashije). Allahu thotë: **“O njerëz, frikësojuni**

Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe! Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër." Haxh 1-2.

Pastaj na tregon se atë Ditë njerëzit do të ndahen në dy grupe:

وَجُودٌ يَوْمَئِذٍ خَشِيعَةٌ - **Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish**" - do të ketë fytyra të përulura, prej poshtërimit që do t'i kaplojë ata.

عَامِلَةٌ نَّاصِبَةٌ - **që kanë punuar e janë rraskapitur**" - Mendimi më i saktë është se jobesimtarët në Ditën e Gjykimit do të tërheqin zvarrë prangat e zinxhirët me të cilët do të lidhen dhe do të jenë të rëndë e të gjatë, e pastaj ashtu do të hyjnë në zjarrin e xhehenemit. Pra, kjo është një punë e lodhshme, rraskapitëse.

تَصْلَى نَارًا حَامِيَةً - **Ata do të digjen në zjarr të nxehtë**" - Këta do të hyjnë në zjarr, i cili ka arritur skajshmërinë e nxehtësisë.

Do të kenë për të pirë e për të ngrënë dhe na tregon se si do të jetë kjo në këto dy ajete:

تُسْقَى مِنْ عَيْنٍ عَاطِيَةٍ - **e do të pinë nga burime të valuara**" - ujë të vluar, kur i kaplon etja e madhe kërkojnë të pinë ujë dhe

u jepet prej këtij uji. Kur u afrohet fytyrave të tyre për ta pirë, u bije menjëherë lëkura e mishi, u mbeten vetëm kockat, e kur e pinë ua copëton zorrët. E megjithatë ata do ta pinë këtë ujë. Ky është një lloj ndëshkimi për ta.

لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ ضَرِيعٍ - **Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese**"- Darii është një pemë e thatë, e cila ka ferra, gjemba.

لَا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِي مِنْ جُوعٍ - **të cilat as nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajnë urinë**"- Ky ushqim nuk është i mirë, nuk u bën dobi në aspektin e jashtëm, e as nuk ua shuan urinë. Përbirja e tij është e vështirë. Ky ushqim është i hidhur, me aromë të keqe, të ndyrë.

Pas kësaj na tregon për grupin e dytë të njerëzve, e këta janë besimtarët:

وَجُودٌ يَوْمَئِذٍ نَاعِمَةٍ - **Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara**"- për shpërblimin e madh që Allahu ua ka dhënë. Janë të gëzuara ngase ata qysh duke qenë në varr e kanë ditur se çfarë e mire i pret në ahiret. Në varr besimtari përmes një derë (a dritare) sheh vendin e tij në xhenet dhe prej xhenetit i vijnë aromat dhe kënaqësitë e tij. Qysh në varr ndjen kënaqësi dhe e di përfundimin e tij. Andaj, kur të ndodhë Dita e Gjykimit ai do të jetë i gëzuar.

لِسَعْيِهَا رَاضِيَةٌ - **të kënaqura për punët e bëra**"- që kanë bërë në dunja, ngase e dinë se ato janë bërë shkak që të arrijnë këtë kënaqësi e gëzim.

“فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ - Ata do të jenë në kopshtin e lartë”- Xheneti është një vendstrehim të cilin Allahu e ka përgatitur për besimtarët, për miqtë e Tij. Allahu thotë në hadith kudsij: **“Për robërit e Mi të devotshëm kam përgatitur atë që syri nuk e ka parë kurrë, veshi nuk ka dëgjuar për të e as zemra nuk mund ta parafytyrojë se si është shpërblimi aty.”** Allahu thotë: **“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** Sexhde 17. Xheneti është në një vend të lartë. Ai është përmbi shtatë qiej. E më i larti i këtij xheneti është Firdeusi dhe është në mes të tij. Përmbi Firdeus është Froni i Allahut. Ata që vendosen në Firdeus kanë arritur një shkallë të lartë.

“لَا تَسْمَعُ فِيهَا لُغِيَةً” - në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe”- fjalë të kota, pa kuptim. Aty do të dëgjojnë vetëm fjalë të mira, si: selami, dhikri.

“فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ” - Atje ka një burim rrjedhës uji”- Allahu na ka treguar se si janë lumenjtë e Xhenetit: **“...një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar.”** Muhamed 15. Këta lumenj rrjedhin vazhdimisht. Qëllimi është: banorët e xhenetit nuk kanë nevojë të gropojnë për të dalë uji, por uji është i rrjedhshëm dhe do të rrjedhë përmbi tokë, dhe ata ngado që dëshirojnë mund ta drejtojnë atë (këta lumenj nuk kanë shtrat, kanal, por ecin lirshëm).

فِيهَا سُرُرٌ مَّرْفُوعَةٌ - **dhe divane të ngritura**"- shtretër të lartësuar. Ata që ulen aty do të kënaqen.

وَكَوَابٍ مُّوضُوعَةٍ - **ka kupa të vëna (për t'u mbajtur në dorë)**"- gota, që do t'i kenë shumë afër, do t'i marrin me lehtësi dhe do të pinë me to prej atyre lumenjve.

وَنَمَارِقٍ مَّصْفُوفَةٍ - **dhe jastëkë të renditur**"- në të cilët do të mbështeten, janë të renditur në mënyrën më të mirë, saqë kur i shikon të kënaqin e pastaj kur mbështetesh në to arrin kulminacionin e kënaqësisë.

وَرَزَابِيٍّ مَّبْنُوتَةٍ - **si dhe shumë qilima të shtruar**"-shtroja, të shpërndara me rregullsi, në çdo vend në xhenet.

Këta gjëra që u përmenden nuk janë të ngjashme sikur me ato të dunjasë, realiteti i tyre është tjetër, janë të ngjashme vetëm në emra.

أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ - **Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!**"- Allahu e sjell këtë pyetje në formë qortimi, për ata që kanë mohuar atë të cilën Allahu na ka treguar se do të ndodhë në Ditën e Gjykimit, ata kanë mohuar shpërblimin dhe ndëshkimin për njerëzit. I qorton ata që ia kanë kthyer shpinën provave të cilat Allahu i ka vendosur para tyre (t'i shohin me sy). Fillon me përmendjen e deveve sepse në kohën e zbritjes së Kuranit ato janë përdorur më së shumti prej kafshëve (për t'i mjelë, për t'i ngrënë, për të udhëtuar, për t'ua marrë leshin për rroba etj.). Ato kanë trupa të mëdhenj me të cilët bartin

barrë të rënda. Ato ecin me distancë të largët edhe pse kanë barra të ngarkuara. Deveja dhe quhet “Anija e shkretëtirës”. Ajo depoziton brenda trupit të saj ujë dhe ecë në largësi pa pasur nevojë të ndalet të pijë në burime. Allahu e ka nënshtruar devenë për njeriun, ajo mundet/ka forcë të ngritët në këmbë prej ulur me gjithë barrën e saj të ngarkuar. Allahu e ka bërë shumë të dobishme për njeriun.

“وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ” - **Po qiellin, se si është ngritur?!**” - në të ka vendosur yje, planetë, galaktika, diellin e hënën, dhe të tjera (të pazbuluara), me të cilat arrihet në përfundim se ky kozmos e ka një Krijues i Cili është i Gjithëdijsëm. Provat e vendosura në të janë të shumta. Allahu e ka ngritur shumë lartë dhe nuk e ka bërë të mbështetur (nuk mbahet) në shtylla.

“وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ” - **Po malet, se si janë vënë të patundur?!**” – Malet përbëjnë në vetët e tyre gurë të mëdhenj, të ndryshëm, minerale të ndryshme, metale etj. Lartësia e maleve mbi sipërfaqe është e njëjtë me thellësinë e tyre në tokë. Kjo që toka të mos tundet. Allahu i ka bërë malet si shtylla, që banorët e saj të ecin lirshëm mbi të. Prej dobive të tjera të maleve është se i mbrojnë njerëzit prej stuhive të ndryshme që vijnë nga detet, bëhen pengesë për mos shkatërrimin e ndërtesave apo të mbjellave dhe të mos i përfshijnë njerëzit. Ata janë aq të fortë saqë nuk mund t'i lëvizë stuhia.

“وَإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ” - **Po Tokën, se si është shtrirë?!"** - E ka bërë të shtrirë, të gjerë, që njerëzit të mundën të jetojnë lehtësisht në të, të mbjellin, të korrin, të ndërtojnë etj. Nëse do të ishte pjerrtas apo tatëpjetë, njerëzit nuk do të mundnin të qëndronin e të ndërtonin në të. Disa dijetarë këtë ajet e kanë marrë për argument se toka është e rrafshët, jo sferike, mirëpo ky është gabim dhe nuk ka argument për këtë gjë në këtë ajet. Përkundrazi, në ajete të tjera në Kuran përmendet se toka është sferike (e rrumbullakët). Allahu thotë: **"Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën në natë..."** Zumer 5. Kuptimi në arabisht: e rrotullon, e mbështjellë natën në ditë dhe ditën në natë, e mbështjellë në mënyrë rrethore. Dhe: **"kur Toka të sheshohet (nga rrënimi i maleve)"** Inshikak 3. Kjo në Ditën e Gjykimit. Kjo tregon se toka nuk është e rrafshët, por është e rrumbullakët. Ka ardhur në një hadith se toka në atë Ditë do të shtrihet/sheshohet siç shtrihet lëkura e kafshës kur të regjet. Dihet se zbulimet bashkëkohore tregojnë se toka ka formë sferike. Dhe Allahu ka caktuar ligje të caktuara në kozmos që lumenjtë e detet të mos derdhen edhe pse toka ka formë sferike.

“فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ” - **Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues"** - Kjo tregon se këshilla është e përgjithshme. Allahu i thotë në këtë ajet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem të këshillojë çdokënd dhe në çdo vend. Këtë urdhër e ka çuar në vend (si është më së miri).

Po ashtu dhe shokët e tij. Prej këshillës përfitojnë vetëm besimtarët, jo të gjithë njerëzit. Mirëpo, nëse sheh se zemra jote nuk e merr këshillën (edhe pse je besimtar), nuk ndikohet e nuk ka dobi, atëherë fillo të akuzosh veten tënde, se besimi yt është i mangët. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është ai i cili na ka kumtuar atë me të cilën na ka urdhëruar Allahu, na ka përcjell, na ka kujtuar Allahun dhe ndëshkimin e Tij, ai ka paralajmëruar e ka këshilluar deri në momentet e vdekjes, mirëpo udhëzimi është në Dorën e Allahut. Askush nuk mund ta udhëzojë atë që dëshiron, sado që e do atë apo e ka të afërm. Por, mund ta lusë Allahun që ta udhëzojë atë.

“لَسْتُ عَلَيْهِمْ بِمُصَيِّرٍ - dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!”- Qëllimi është: Nuk mund t'i detyrosh të tjerët me forcë të pranojnë udhëzimin, pushteti i takon vetëm Allahut, obligimi yt është vetëm përcjellja e kumtimi.

“إِلَّا مَنْ تَوَلَّى وَكَفَرَ” - Mirëpo, ata që shmangen dhe nuk besojnë”.

“فَيُعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ” - Allahu do t'i ndëshkojë me dënimin më të madh”-

Pra, ajo që na takon neve është t'i thërrasim të tjerët e t'i këshillojmë në të vërtetën, nuk kemi forcën t'i detyrojmë ta pranojnë atë dhe nuk na lejohet kjo, mirëpo gjithashtu duhet t'ua sqarojmë se nëse nuk e pranojnë atëherë Allahu do t'i ndëshkojë me dënimin më të madh. Ata që janë

shmangur prej të vërtetës pasi u ka ardhur ajo, pasi Pejgamberi salAllahu alejhi dhe të tjerët pas tij e kanë kumtuar dhe e kanë përcjell atë, pasi u ka arritur shpallja që i ka zbritur atij salAllahu alejhi ue selem ia kthejnë shpinën, shmangen (nuk e pranojnë, nuk duan ta dëgjojnë me zemër) dhe e mohojnë (tregohen mendjemëdhenj, kryelartë), atëherë Allahu do t'i ndëshkojë me ndëshkimin më të madh, më i madh se çdo ndëshkim tjetër.

“إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابَهُمْ” - Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne”- pra sado që njeriu mundohet t'i ikë kësaj dhe sado që të jetojë gjatë. Gjithsesi do të takohet me Allahun, andaj duhet të përgatitet për këtë takim. Duhet të pendohet e të kërkojë falje për mëkatet dhe të shtojë veprat e mira derisa ta takojë Allahun.

“ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ” - dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!”- Mënyra e kësaj llogarie që njerëzit do ta japin tek Allahu, është se besimtari do të vetmohet me Allahun dhe do ta detyrojë të pranojë mëkatet (ke bërë këtë e këtë) dhe Allahu do t'ia falë, ndërsa jobesimtari nuk do të japë llogari në këtë mënyrë sepse nuk ka vepra të mira përmes të cilave do t'iu fshihen mëkatet, mirëpo e llogarit për çdo vepër të keqe, për kufrin, shirkun dhe të tjerat, e pastaj mëkatet ia zbulon publikisht, para të gjitha krijesave, ia numëron një nga një dhe pas kësaj e hedh në zjarr të xhehenemit.

Surja Fexhr – komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْفَجْرِ ۝ وَلَيَالٍ عَشْرٍ ۝ وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ ۝ وَاللَّيْلِ إِذَا يَسْرِ ۝ هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ لِّذِي
حَبْرِ ۝ أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ۝ إِرْمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ۝ الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي
الْبِلَادِ ۝ وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ ۝ أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ۝ إِرْمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ۝
الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي الْبِلَادِ ۝ وَثَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخِرَ بِالْوَادِ ۝ وَفِرْعَوْنَ ذِي
الْأَوْتَادِ ۝ الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبِلَادِ ۝ فَأَكْثَرُوا فِيهَا الْفُسَادَ ۝ فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ
عَذَابٍ ۝ إِنَّ رَبَّكَ لِبَالِمٍ صَادٍ ۝ فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ
فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ۝ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهْنَنِ ۝ كَلَّا
بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ ۝ وَلَا تَحْضُونَ عَلَى طَعَامِ الْمَسْكِينِ ۝ وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا
لَمًّا ۝ وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ۝ كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا ۝ وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ
صَفًّا صَفًّا ۝ وَجَاءَ يَوْمُنَا بِجَهَنَّمَ ۝ يَوْمُنَا يَنْدَكُرُ الْإِنْسَانُ ۝ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَى ۝ يَقُولُ
يَلَيْتَنِي قَدِمْتُ لِحَيَاتِي ۝ فَيَوْمُنَا لَا يُعَذِّبُ عَذَابُهُ أَحَدًا ۝ وَلَا يُوثِقُ وَثَاقُهُ أَحَدًا ۝
يَأْتِيهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ ۝ أَرْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكَ رَاضِيَةً مَّرْضِيَةً ۝ فَأَدْخُلِي فِي
عِبْدِي ۝ وَأَدْخُلِي جَنَّتِي ۝.

1. Beto hem për muzgun e agimit
2. dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul Hixhxe)!
3. Beto hem për çiftin dhe tekun
4. dhe për natën kur largohet!
5. A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?!
6. Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad,
7. banorë të Iremi me pallate shumëshytyllëshe,
8. të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!
9. Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)?

10. Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)?

11. Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre,

12. duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin,

13. prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit.

14. Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!

15. Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.”

16. Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”.

17. Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët

18. dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t’i ushqyer të varfrit.

19. Trashëgiminë (e të dobtëve) e zhvatni me lakmi të pangopur,

20. dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme.

21. Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime,

22. kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe,

23. Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet por ç’i duhet se u kujtua!

24. Ai do të thotë: “Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!”

25. Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai,

26. e askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai!

27. O ti shpirt i qetësuar!

28. Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!

29. Bashkohu me robërit e Mi

30. dhe hyr në Xhenetin Tim!

Komentimi

Janë pesë gjëra në të cilat Allahu betohet në fillimin e kësaj sureje:

وَالْفَجْرِ - Betohem për muzgun e agimit – drita e cila ndriçon në horizont në drejtim të lindës para se të lindë dielli, kur fillon të dallohet nata prej ditës apo dita prej natës, pra kur hyn koha e sabahut. Allahu betohet në të sepse njeriu nuk ka mundësi të sjellë agimin (të bëjë të agojë dita). Kjo është vetëm nën mundësinë e Allahut. Kjo është një shenjë e madhe që tregon për Fuqinë e Allahut.

وَالْيَالِ عَشْرِ - dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul Hixhhe)! – Disa prej dijetarëve thonë se është fjala për dhjetët ditët e para të muajit Dhul Hixhe, disa thonë se është fjala për dhjetë netët e fundit të Ramazanit.

وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ - Betohem për çiftin dhe tekun – Disa dijetarë kanë thënë se me këtë betim Allahu ka përfshirë të gjitha krijesat (çdo gjë që e ka krijuar), ngase ka prej tyre që janë çift e ka që janë tek, këtu hyjnë edhe adhurimet thonë ata (çdo gjë që e ka ligjësuar). Ndërsa, disa dijetarë kanë thënë se qëllimi me çiftin janë krijesat, kurse qëllimi me tekun është vetë Allahu. Me të dy mendimet lejohet të interpretohet ky ajet.

وَاللَّيْلِ إِذَا يَسْرِ - dhe për natën kur largohet/udhëton! – Nata fillon me perëndimin e diellit dhe përfundon me agimin. Vazhdimisht ajo ecën, udhëton. Allahu betohet në natën sepse gjatë saj kryhen shumë adhurime, si: namazi i

akshamit, i jacisë, i natës, i vitrit, gjithashtu në pjesën e fundit të natës Allahu zbret në qiellin e dunjasë.

“هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ لِذِي حِجْرٍ” - A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?” – A ju mjaftojnë këto betime që tregojnë për madhësinë e Allahut?

“أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ” - Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad” – Adi është fis i njohur arab, tek ta Allahu ka dërguar Hudin për Pejgamber i cili e ka shpallur mesazhin e Allahut, por ata nuk e kanë pranuar dhe kanë refuzuar, **“...thoshin: “Kush është më i fortë se ne?” Vallë, a nuk e dinin ata se Allahu që i kishte krijuar, është më i fuqishëm se ata?!”** Fusilet 15. Allahu si ndëshkim për ta ka dërguar një erë për 7 netë dhe 8 ditë, **“Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme të pandërprerë, e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkultura hurmash.”** Kamer 19-20. Allahu me këtë pyetje do të na tërheqë vëmendjen, se si ka vepruar me ta, që të marrim mësim prej kësaj gjëje. Kush e përgënjeshton dhe e kundërshton të Dërguarin e Allahut Muhamedin salAllahu alejhi ue selem, le të shikojë se çfarë ka vepruar me këtë popull i cili ka kundërshtuar të Dërguarin e tyre.

“إِرمَ ذَاتِ الْعِمَادِ” - banorë të Iremit me pallate shumëshytyllëshe” – me këto dy ajete i drejtohet të gjithë njerëzimit e madje edhe xhindëve. Disa dijetarë kanë thënë se Iram është emër i një fisi që ka jetuar aty, disa të tjerë kanë thënë se Iram është vendi ku ka jetuar fisi Ad, dhe mendime të tjera. Sidoqoftë, Allahu na tregon se i ka ndëshkuar ashpër edhe pse kanë qenë shumë të fuqishëm

fizikisht. Ndërsa, imad janë për qëllim shtyllat e mëdha e të forta që i kanë ndërtuar ata.

“الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي الْبَلَدِ” - **të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!**” – nuk ka (ndërtesa) si të atilla siç ka ndërtuar populli Ad, aq të forta e të mëdha, të perfeksionuar. Kjo ka qenë shkak përse ata janë mashtruar me forcën e tyre dhe kanë thënë: “**Kush është më i fortë se ne?**”

وَتَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخْرَ بِالْوَادِ” - **Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)?**” – Ata kanë qenë populli i Pejgamberit Salih alejhi ue selam. Ata kanë banuar në Hixhr (luginë, vend i njohur edhe sot). Atyre Allahu u ka dhënë forcë të madhe sa që kanë gdhendur shkëmbinjtë dhe malet pa mjete (por me duar) duke ndërtuar shtëpi në të cilat kanë banuar. Vendbanimet e tyre ende ekzistojnë sot. Allahu i ka ndëshkuar ata duke ua dërguar një britmë të madhe dhe dridhje “**i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm, sikur nuk kishin jetuar kurrë në to**” Hud 67-68, dhe: “**ata i goditi një tërmet i rëndë në mëngjes dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre.**” Araf 78). Ne duhet të marrim mësim prej gjendjeve të popujve të cilët i ka ndëshkuar Allahu, të cilët kanë përgënjeshtuar fenë dhe të Dërguarit e Tij. Përfundimi i tyre ka qenë shkatërrimi dhe zhdukja.

وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ” - **Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)?**” – Faraoni tek i cili është dërguar Musai si Pejgamber. Ai i ka nënshtruar dhe pushtuar bëni Israilët që jetonin në Egjipt. Ai ua ka mbytur meshkujt dhe

fëmijët (djem) dhe ua ka lënë gjallë femrat. Dhe Allahu me fuqinë e Tij e ka bërë kader që pikërisht nga ta të lindë një djalë përmes të cilit do të shkatërrohet mbretëria e Faraonit, e ai ka qenë Musai alejhi ue selem. Allahu e ka frymëzuar nënën e Musait ta hedhë atë (si foshnje) në lumë dhe i ka treguar se do ta ruajë Ai, pastaj e ka gjetur gruaja e Faraonit. Allahu mbolli dashuri në zemrën e saj për të, por edhe në zemrat e të gjithë njerëzve, kushdo që e ka parë e ka dashur atë. Ajo e ka rritur dhe edukuar në pallatin mbretëror. Faraoni i ka thënë popullit të tij: “Unë jam Zoti juaj më i Lartë!” dhe: “Unë nuk di ndonjë të adhuruar tjetër për juve përveç meje!”

“njeriun e hunjve” – E quan kështu ushtrinë e tij, ata e kanë mbajtur mbretërinë e tij fort. Faraoni ka pasur fuqi të madhe dhe ushtri të madhe, mirëpo Allahu është mbi çdokënd.

“الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبُلْدِ” - Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre” – Tejkalan kufijtë e Allahut dhe bënë padrejtësi në tokë.

“فَاكْتَرُوا فِيهَا الْفُسَادَ” - duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin” –shtuan shumë mëkatet, mohimin, padrejtësinë etj.

“فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ عَذَابٍ” - prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit” - Allahu lëshoi dënim shkatërrues (për këta popuj).

“إِنَّ رَبَّكَ لَبَلَمُرْصَادٍ” - Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!” – Me këto fjalë i drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe çdokujt tjetër. **“në pritë”** të çdokujt i cili tejkalon

kufijtë, bën padrejtësi, tregohet mendjemadh, tiran, kryelartë. Ai gjithsesi do ta ndëshkojë atë.

- فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ - Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar” -

- وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهْنَنِ - Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”.

Në këto dy ajete Allahu tregon se sprovat e Tij janë me të mira dhe me të këqija. Allahu e sprovon njeriun me të mira të shohë se a është mirënjohës e falënderues dhe e sprovon me të këqija të shohë se a është durimtar. Gjendja e njerëzve deri në vdekje është mes të mirave dhe të këqijave, ata janë në sprovë me to. Çdo gjë e keqe që i ndodh, duhet të dijë se është sprovë prej Allahut, e pastaj prej asaj Ai do të nxjerrë të mira, andaj, nuk duhet të dobësohemi e demoralizohemi përballë sprovave. Njeriu në natyrën e tij është injorant dhe i padrejtë, dhe nëse atë e sprovon me të mira do të thotë: “Më ka nderuar”, do të mendojë se ky nderim i ka ardhur sepse ai e meriton dhe nuk e njeh si mirësi prej Allahut, nuk është mirënjohës. E nëse e sprovon me të këqija do të thotë: “Më ka poshtëruar”, nuk do të durojë. Kjo është gjendja e shumicës së njerëzve. Kurse, besimtari e falënderon Allahun kur i jep mirësi, e pranon me zemër se ato janë mirësi prej Tij (e jo sepse ai i meriton). Gjithashtu bën durim kur e sprovon (me diçka) dhe shpreson në shpërblimin e Tij dhe thotë se kjo është për shkak të mëkateve të tij (e jo se Allahu e ka poshtëruar apo i ka bërë padrejtësi).

- كَلَّا بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ - Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët" - Pra, nuk t'i ka dhënë ato të mira për të të nderuar pse ti je merituar, por që të dish se janë mirësi prej Allahut, gjithashtu nuk të ka sprovuar për të të poshtëruar, porse sprovimin këtë e kërkon urtësia dhe drejtësia e Allahut. (Si njerëz, në natyrën që jenë krijuar) Nuk tregoni dhembshuri ndaj jetimëve kur keni mirësi, nuk kujdeseni për ta, qoftë nëse janë jetimë të pasur apo të varfër. Jetimi e ka zemrën e thyer me vdekjen e babait, nuk ka kush të kujdeset për të (edhe nëse ka pasuri).

- وَلَا تَحْضُونْ عَلَى طَعَامِ الْمَسْكِينِ - dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit" - kjo tregon se ata as nuk u japin të varfërve prej pasurisë që ua ka dhënë Allahu. Nëse Allahu na ka nderuar me pasuri duhet t'i nderojmë jetimët dhe të nxisim njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit ngase ata janë nevojtarë.

- وَتَأْكُلُونَ الثَّرَاثَ أَكْلًا لَمًّا - Trashëgiminë (e të dobëtëve) e zhvatni me lakmi të pangopur" - Disa dijetarë kanë thënë se është fjala për trashëgiminë e mbetur nga i vdekuri (tek i cili ka hise).

"e zhvatni" qëllimi është siç kanë vepruar njerëzit e periudhës paraislame të cilët nuk ia kanë dhënë femrave hisen e pasurisë. Disa dijetarë kanë thënë se me trashëgimi është çdo pasuri të cilën e trashëgon prej Allahut, qoftë prej dikujt që ka vdekur, apo prej shitblerjes, apo prej furnizimit që fiton duke punuar etj.

"me lakmi të pangopur" – njeriu që nuk ka besim në zemër çdo pasuri që i vjen e merr, nuk shikon a është e lejuar apo e ndaluar, nuk shikon se a është e tij apo e tjetër kujt.

- وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا - dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme” - Kjo është në natyrën njerëzore, por besimi në zemrën e besimtarit lë gjurmët e tij, dhe për shkak të tij, ai ka mundësi të mos i kushtojë fare rëndësi pasurisë. Nëse ka pasuri, ai është falënderues dhe kryen obligimet me të cilat është ngarkuar, e nëse nuk ka kjo nuk ka rëndësi (tek ai).

- كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا - Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime” - derisa të mos shohësh më as lugina, as brigje, as ndërtesa, as pemë. Toka do të shtrihet, siç shtrihet lëkura. Njerëzit do të jenë në një vend ku mund ta dëgjojnë atë që u bën thirrje dhe t’i shohin të gjithë të tubuarit pa pasur asnjë pengesë.

- وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا - kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe” – Allahu do të vijë në Ditën e Gjyimit, por se si do të vijë ne nuk e dimë. Kjo është një çështje për të cilën nuk kemi dijeni. Do të vijnë të gjithë engjëjt, do të zbresin dhe do t’i përfshijnë krijesat. Do të zbresin engjëjt e qiellit të kësaj bote, pastaj ata të qiellit të dytë e me radhë. Engjëjt do t’i rrethojnë krijesat për të shfaqur madhështinë. Sigurisht që krijesat nuk mund të ikin as majtas as djathtas, mirëpo kjo bëhet për të bërë të dukshme madhështinë e Allahut dhe trishtimin e asaj Dite të madhe.

- وَجَاءَ يَوْمِنَا بِهِنَّ بِجَهَنَّمَ يَوْمِنَا يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَى - Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç’i duhet se u kujtua!” – Nuk përmendet se kush do ta sjellë Xhehenemin, mirëpo në një hadith thuhet se do të sillet duke u tërhequr nga 70.000 kapistra, ku çdo kapistër tërhiqet nga 70.000 engjëj. Dhe njeriu do të kujtohet se i

ishite premtuar kjo Ditë dhe se ishte njoftuar për të përmes Profetëve të cilët paralajmëruan dhe frikësuan për këtë Ditë. Por, çfarë kuptimi ka se u kujtua në këto çaste kur sheh me sy ato për të cilat kishin njoftuar Profetët? Tani nuk ka më kohë për të marrë mësim. Besimi përmes shikimit nuk bën dobi, sepse çdo njeri e beson atë që sheh. Besimi i dobishëm është besimi në të fshehtën.

- يَقُولُ يَلَيَّتَنِي قَدَمْتُ لِحَيَاتِي - Ai do të thotë: “Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!” – Do të dëshironte të kishte bërë diçka për jetën e tij, por kjo nuk mund të ndodhë. Por cila është jeta e tij? Mos është jeta e kësaj bote? Jo. Jeta e dunjasë ka mbaruar, megjithëse në realitet nuk është jetë në kuptimin e plotë të fjalës.

- فَيَوْمَئِذٍ لَا يُعَذِّبُ عَذَابَهُ أَحَدٌ - Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai” – dënimi i Tij është më i rëndi. Atë Ditë askush nuk do të dënohet siç dënohet ky njeri.

- وَلَا يُوثِقُ وَثَاقَهُ أَحَدٌ - e askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai!” Ky njeri do të prangoset.

Pastaj Allahu e përfundon këtë sure me diçka që i gëzon zemrat dhe i zgjeron kraharorët:

- يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ - O ti shpirt i qetësuar!” – O shpirt i besimtarit, i qetë, pasi nuk mund të ketë shpirt më të qetë sesa ai i besimtarit.

- أَرْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكَ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً - Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!” I thuhet “Kthehu te Zoti yt” në çastet kur ndahet nga kjo botë. Pra, o shpirti i qetësuar, dil për te mëshira dhe kënaqësia e Allahut. Ky është një lajm i mirë që e gëzon shpirtin dhe ia lehtëson

daljen nga trupi, sepse është përgëzuar me diçka që është më e mirë se çdo gjë që ndodhet në këtë botë.

“i kënaqur me Atë” – me mirësitë që t’i ka dhuruar Allahu.

“فَأَدْخُلِي فِي عَبْدِي” - Bashkohu me robërit e Mi” - Robërit e mirë janë ata që janë begatuar nga Allahu, kategoria më e mirë e njerëzve: Profetët, të sinqertit, dëshmorët dhe të devotshmit.

“وَأَدْخُلِي جَنَّتِي” - dhe hyr në Xhenetin Tim!” – Në Xhenetin që Allahu ka përgatitur për miqtë e Tij. E ka adresuar te Vetja (“Xhenetin Tim”) në shenjë nderi dhe madhështie dhe për t’ua bërë të qartë krijesave kujdesin që ka treguar për to.

Surja el Beled – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لَا أُقْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ ۝ وَأَنْتَ حِلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ ۝ وَوَالِدُ وَمَا وَلَدَ ۝ لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي
كَبَدٍ ۝ أَيْحَسِبُ أَنْ لَنْ يَفْذَرَ عَلَيْهِ أَحَدٌ ۝ يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُبَدًا ۝ أَيْحَسِبُ أَنْ لَمْ
يَرَهُ أَحَدٌ ۝ أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ ۝ وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ ۝ وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ ۝
وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ ۝ فَلَا اقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ ۝ فَكُّ رَقَبَةٍ ۝ أَوْ
إِطْعَمَ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ ۝ يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ ۝ أَوْ مَسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ ۝ ثُمَّ كَانَ مِنَ
الَّذِينَ ءَامَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ ۝ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ۝
وَالَّذِينَ كَفَرُوا بَاءَيْنَا هُمْ أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ ۝ عَلَيْهِمْ نَارٌ مُؤَصَّدَةٌ ۝

1. Beto hem për këtë vend,
2. në të cilin ti je i lirë (o Muhamed),
3. dhe për atë që lind e për atë që është i lindur,
4. se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!
5. A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi atë?
6. Ai thotë: “Kam shpenzuar pasuri të pamasë!”
7. Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush?
8. A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy,
9. edhe gjuhë, edhe dy buzë,
10. dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?
11. Atëherë, le të ndjekë rrugën e vështirë!
12. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është rruga e vështirë?
13. Ajo është të lirosh një skllav
14. ose të ushqesh në një ditë zie
15. jetimin e afërm ose të varfrin e mjerë.

17. Veç kësaj, (njeriu duhet) të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe e këshillojnë për mëshirë.

18. Këta janë njerëzit e krahut të djathtë.

19. Ndërsa ata që i mohojnë shpalljet Tona, ata janë njerëzit e krahut të majtë.

20. Mbi ata do të jetë zjarri i mbyllur.

Komentimi

“لَا أُفْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ” - **Betohem për këtë vend**” – Vini re, se Unë gjithsesi betohem për këtë vend. Qëllimi këtu me vendin është Meka. Allahu betohet në Meken sepse është vend i cili ka pozitë të lartë tek Ai. Nuk ka vend me shenjtërinë më të madhe tek Ai sesa Meka. Nuk ka vend më të dashur tek Ai sesa qyteti i Mekës. Allahu betohet në çfarëdo që dëshiron Ai. Ndërsa, neve nuk na lejohet të betohemi në Mekën e as në Qaben, sepse ato janë krijesa dhe uk na lejohet të betohemi në krijesat e Allahut.

“وَأَنْتَ حَلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ” - **në të cilin ti je i lirë (o Muhamed)**” – Disa dijetarë kanë thënë: I vendosur në të, si i Dërguari i fundit i Allahut. Allahu na tregon se vetë ndodhja e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në Meke ia shton asaj nderin, fisnikërinë e pozitën. Disa dijetarë kanë thënë se qëllimi është: Të është bërë i lejuar ky vend. Allahu betohet në Meke duke e kushtëzuar me kohën kur ajo ka qenë e lejuar për të salAllahu alejhi ue selem (në Ditën e Çlirimit).

“وَالِدٌ وَمَا وَلَدٌ - dhe për atë që lind e për atë që është i lindur” – Disa dijetarë kanë thënë se qëllimi është me Ademin (prej të cilit ka rrjedhë njerëzimi dhe ai është babai i të gjithëve) dhe me pasardhësit e tij (njerëzimin). Kurse disa dijetarë kanë thënë se qëllimi është për çdo gjë që lind dhe çdo gjë që është e lindur (të gjitha krijesat). Mendimi i dytë është më i saktë.

“لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي كَبَدٍ - se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!” – Janë dy mendime: Allahu e ka krijuar njeriun për të ecur drejtë, në formën më të mirë, mbi dy këmbët e tij, me kokën lartë, ndërsa kafshët ecin në të kundërtën. Kjo tregon se Allahu e ka nderuar njeriun, duke e bërë krijesë të përsosur. Dhe, Allahu e ka krijuar njeriun të atillë që vazhdimisht i arrin gjërat me vështirësi, duke luftuar me vështirësinë. Ai në jetën e dunjasë gjithmonë do të ballafaqohet me vështirësi, si: në kërkimin e rrizkut, në luftimin e shpirtit për bindje ndaj Allahut dhe largim prej mëkateve, sidomos kur jeton në një ambient të devijuar e në humbje dhe llogaritet i huaj aty etj. Ajeti përfshin të dy interpretimet.

“أَيَحْسَبُ أَنْ لَنْ يَفْذَرَهُ عَلَيْهِ أَحَدٌ” - A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi atë?” – Kur njeriu, pra jobesimtari, është në fuqinë e rinisë e tij mendon se askush nuk mund ta mposhtë atë dhe të ketë pushtet mbi të, saqë këtë e mendon edhe ndaj Allahut. Ndërsa, besimtari është i bindur se Allahu është mbi të, se Ai është më i Fuqishmi, andaj i frikësohet Atij.

“يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُبَدًا” - Ai thotë: “Kam shpenzuar pasuri të pamasë!” – Këtë e thotë kur është në gjendje të mirë, në

shëndet, në pasuri, në mirëqenie. Thotë: “Kam shpenzuar pasuri të pamasë në plotësimin e epsheve dhe dëshirave të mia!” Ai llogarit për vetveten se askush nuk ka pushtet mbi të, se ai bën çfarë të dojë me pasurinë e tij.

“أَيَحْسَبُ أَنْ لَمْ يَرَهُ أَحَدٌ” - Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush? – A mendon ai se nuk e ka parë Allahu se si e shpërdoron pasurinë e tij aty ku nuk i bën dobi? Këto ajete janë kërcënime e frikësime që njeriu të mos ndjehet mendjemadh e kryelartë ngaqë ka fuqi fizike apo pasuri. Allahu është më i Fuqishëm dhe Ai e sheh se çfarë vepron.

“أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ” - A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy’.

“وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ” - edhe gjuhë, edhe dy buzë’.

“وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ” - dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?’

Këto janë tri mirësi që Allahu ia ka dhënë njeriut. Ia ka dhënë atij dy sy përmes të cilëve sheh. Pastaj ajo që sheh me dy sy i pasqyrohet dhe i vendoset në zemër. I ka dhënë një gjuhë përmes të cilës flet dhe dy buzë përmes të cilave flet (artikulon) në mënyrën më të mirë fjalët e tij. Disa dijetarë kanë thënë për “rrugët” se janë dy: rruga e mirë dhe rruga e keqe, Allahu ia ka sqaruar, ia ka treguar se cilat janë ato. Kurse disa dijetarë kanë thënë se janë dy gjinjtë e nënës, kur foshnja lind Allahu e udhëzon të marrë qumështin prej nënës së tij.

“فَلَا أَقْتَمَ الْعَقَبَةَ” - Atëherë, le të ndjekë (tejkalojë) rrugën e vështirë!’ –Allahu e fton këtë njeri (siç u përshkrua më lartë) t’ia mësyjë kësaj rruge të vështirë për ta tejkaluar (akabeh është rrugë në mes një mali, e pashkelur, e vështirë të kalohet), e cila është shumë e vështirë për shpirtin. Atë

nuk ka mundësi ta kalojë përveçse ai që ka nijet e vendosmëri të sigurtë në zemër.

“وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ – E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është rruga e vështirë?” – Sikur do të thotë: E kush përveç Allahut mund të ta shpjegojë atë?

“أَوْ إِطْعَمَ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ – Ajo është të lirosh një skllav” – Kjo ka dy kuptime: 1. të lirosh një skllav (prej veprave të cilat nxit Allahu është lirimi i skllavëve), skllavin tënd apo të dikujt tjetër duke e blerë e pastaj e liron, 2. të lirosh skllavin e luftës, pra nëse një musliman ka rënë skllav në luftë në duart e armikut, atëherë prej veprave më të vlefshme tek Allahu është të japësh prej pasurisë tënde aq sa kërkon armiku për ta liruar atë.

“يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ – ose të ushqesh në një ditë zie” – Kur është uri të madhe për shkak të goditjeve me fatkeqësi të ndryshme (thatësi, shira të pakta, apo kur bimët nuk japin prodhim etj.), apo uria për shkak të sëmundjes të disa njerëz (hanë e kurrë nuk ngopen).

“أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ – jetimin e afërm ose të varfrin e mjerë” – Allahu na tregon këtu se kush janë më parësorët për t’i ushqyer në një ditë zie. Jetim është ai të cilit i vdes babai e që ende nuk ka hyr në moshën madhore, qoftë djalë apo vajzë. Nëse jetimi është i afërm, atëherë e drejta e tij shtohet edhe më shumë (ndaj pasurisë tonë) sepse është obligim mbajtja e lidhjes farefisnore. Miskin është i varfëri që nuk ka ushqim të mjaftueshëm për veten e familjen e tij.

Ai që bën këto vepra kaq të mëdha, me shpërblim të madh, apo ndonjërin prej tyre, llogaritet prej atyre që e ka kaluar rrugën e vështirë (që u përmend më lartë), ai ia ka tejkaluar

shpirtit (nepsit i cili e nxit në të këqija). Mirëpo, Allahu nuk po mjafton me kaq.

“ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ” – Veç kësaj, (njeriu duhet) të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe e këshillojnë për mëshirë” – Që këto vepra të pranohen tek Allahu dhe e të ketë shpërblim për të, njeriu duhet të jetë edhe besimtar.

Durimi është tri llojesh: Durimi në kryerjen e urdhrave të Allahut, durimi në largimin prej ndalesave dhe durimi në fatkeqësi. Ne duhet të nxisim njëri-tjetrin në këto tre lloje të durimit. Durimi është rruga që kanë ndjekë të Dërguarit e Allahut dhe pasuesit e tyre.

Mëshira e njeriut duhet të jetë ndaj njerëzve (prindit, fëmijëve, familjes, fisit dhe të gjithë njerëzimit) dhe ndaj kafshëve.

“أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ” – Këta janë njerëzit e krahut të djathtë” – Qëllimi është se atyre do t’iu jepet libri i veprave të tyre nga ana e djathtë në Ditën e Gjykimit (do të jenë nga banorët e xhenetit), e Allahu ka treguar: **“Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar tek të afërmit e tij.”** Inshikak 7-9.

“وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا هُمْ أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ” – Ndërsa ata që i mohojnë shpalljet Tona, ata janë njerëzit e krahut të majtë” – I kanë mohuar pasi e kanë kuptuar vërtetësinë e tyre. Atyre do t’iu takojë fatkeqësia sepse:

“عَلَيْهِمْ نَارٌ مُّؤَصَّدَةٌ” – Mbi ata do të jetë zjarri i mbyllur” – Kurrë nuk kanë mundësi të dalin prej tij, nuk do të gjejnë rrugë, do të jetë i mbyllur nga çdo anë.

Surja esh Shems – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالشَّمْسِ وَضُحَاهَا ۝ وَالْقَمَرِ إِذَا تَلَّهَا ۝ وَالنَّهَارِ إِذَا جَلَّهَا ۝ وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَاهَا ۝ وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا ۝ وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَاهَا ۝ وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ۝ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ۝ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ۝ وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ۝ كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا ۝ إِذِ انْبَعَثَ أَشْقَاهَا ۝ فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا ۝ فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا فَدَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذُنُوبِهِمْ فَسَوَّاهَا ۝ وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا ۝

1. Për Diellin dhe shkëlqimin e tij
 2. dhe për Hënën që e përcjell atë!
 3. Për ditën që ia zbulon shkëlqimin atij (diellit)
 4. dhe për natën kur e mbulon atë!
 5. Për qiellin dhe për Atë që e ka ndërtuar!
 6. Për Tokën dhe për Atë që e ka shtruar!
 7. Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur,
 8. duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën!
 9. Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë,
 10. ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.
 11. Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet - përgënjeshtroi;
 12. kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë).
 13. I dërguari i Allahut (Salihu), u tha atyre: “Kjo është deveja e Allahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!”
 14. Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit,
 15. pa pasur frikë prej pasojave të kësaj.
-

Komentimi

"وَالشَّمْسُ وَضُحَاهَا" - Për Diellin dhe shkëlqimin e tij"- Betohet në diell ngase ai është prej shenjave dhe provave madhore që tregojnë për përsosmërinë e forcës, dijes dhe mëshirës së Allahut. Allahu ka bërë që prej diellit të kenë dobi të shumta njerëzit (prej nxehtësisë së tij piqen frutat, rriten bimët, prej energjisë së tij ka përfitime etj.). Dielli është prej shenjave që tregojnë për fuqinë e Allahut dhe është prej mirësive të Tij që i ka nënshtruar për njeriun.

"وَالْقَمَرِ إِذَا تَلَّهَا" - dhe për Hënën që e përcjell atë!"- Disa dijetarë kanë thënë se hëna e ndjek diellin në lëvizje, disa kanë thënë se e ndjek në shkëlqim, ndriçim (kur ik drita e diellit vjen drita e hënës). Me të dy kuptimet interpretohet ajeti. Shkëlqimi i hënës nuk mund të vijë pa perënduar dielli. Dielli është shenjë e ditës, ndërsa hëna është shenjë e natës.

"وَالنَّهَارِ إِذَا جَلَّهَا" - Për ditën që ia zbulon shkëlqimin atij (diellit)"- Dita shfaq tokën.

"وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَاهَا" - dhe për natën kur e mbulon atë!"- Nata mbulon tokën.

"وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا" - Për qiellin dhe për Atë që e ka ndërtuar!"- Qielli është krijesë e madhe e Allahut dhe është shumë i gjerë e i fortë. Ai e ka ngritur lartë atë. Krijimi i qiellit është i përsosur, **"Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështirimin: a sheh ndonjë plasaritje?"** Mulk 3. Njeriu sado që arrin mjete

e zhvillim të shohë në qiell, prapë nuk ka mundësi të shohë deri në fund atë që është në të.

"وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَّهَا" - Për Tokën dhe për Atë që e ka shtruar!" -

Ajo nuk është as shumë e butë e as shumë e fortë, por mesatare, në mënyrë që njeriu të ketë dobi të shumta prej saj, si: të ecë mbi të, ta punojë etj. Atë e ka bërë të përshtatshme për njeriun për të jetuar në të.

"وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا" - Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur"-

të gjithë shpirtrat e krijuar, në përgjithësi. Allahu e ka përsosur krijimin e shpirtit dhe natyrshmërinë e tij, siç e ka përsosur çdo gjë duke e krijuar në atë mënyrë që i përshtatet gjendjes së vet, **"Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar"** Ta he 50. Çdo krijesë që lind di të kërkojë dobitë e veta në këtë botë. Allahu e ka përsosur krijimin e shpirtit duke i dhënë natyrshmërinë, sidomos njeriun, Ai ka bërë që çdo njeri të lindë në natyrshmëri (fitra), pra të besojë Allahun si Krijues, se Ai është i Vetmi që meriton adhurimin e nënshtrimin. Këtë e ka vendosur në shpirtin e njeriut. Allahu e ka lënë të lirë njeriun të zgjedhë se a do t'i bindet Atij apo jo, por e ka ndihmuar atë duke vendosur në shpirtin e tij natyrshmërinë. Njeriu lind me besimin tek Allahu, **"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit."** Rum 30. Mirëpo, pastaj njeriu duke u rritur ndikohet nga prindërit, apo ambienti, apo nga ideologjitë e ndryshme, dhe devijon prej kësaj natyrshmërie.

"فَاللَّهُمَّ فَجُورَهَا وَتَقْوَاهَا" - duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën!" Allahu i ka inspiruar shpirtrat për të keqen e të mirën. Në ajet fillohet me të keqen që t'i përshtatet rima ajeteve. E keqe është çdo gjë që është në kundërshtim me të mirën. E mira është bindja ndaj Allahut, ndërsa e keqja është mosbindja (mëkati). Allahu ua mundëson shpitrave të besimtarëve të kenë devotshmëri e cila vjen në përputhje të plotë me natyrshmërinë (fitren). Kur njeriu kryen obligimet, urdhrat e adhurimet dhe largohet nga ndalesat, kjo është në përputhje të plotë me natyrshmërinë në të cilën e ka krijuar Allahu.

Disa shpitrave Allahu ua inspiron te keqen (fuxhurin) si ndëshkim, për shkak se kanë devijuar i devijon ende, **"Kur ata u larguan (nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre (nga rruga e drejtë); Allahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin jobesimtar."** Saf 5. Allahu nuk i bën padrejtësi askujt, mirëpo atij që nuk e dëshiron të vërtetën edhe pse i është bërë e qartë ajo, Ai ia devijon zemrën.

"قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا" - Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë"- Do të synojë atë që dëshiron dhe do të largohet prej asaj që ia ka frikën. Këtë e arrin ai që e pastron shpirtin e tij, e dëlirë atë, prej shirkut me llojet e tij, prej mëkateve etj. Ky pastrim rezulton në shpëtim.

"وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا" - ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë"- Kur devijon dhe hidhet në shkatërrim. Njeriu vazhdimisht ka nevojë ta lusë Allahun që ta forcojë në fe e në adhurim ndaj Tij, t'i japë dije të dobishme dhe t'ia mundësojë të bëjë vepra të mira. Kjo

është gjëja për të cilën më së shumti kemi nevojë ta lusim Allahun.

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا - Fisi i Themudit, nga shfrenimi (kryeneçësia) i vet - përgënjeshtroi" – Fisi që ka jetuar në kohën e Profetit Salih alejhi ue selem, i cili ka qenë i Dërguar tek ta. Ai e ka thirrur popullin e tij për të adhuruar Allahun të Vetëm dhe të mos i shoqërojnë të tjerë në adhurim. Allahu ia ka dhënë një mrekulli për të vërtetuar pejgamberinë e tij te njerëzit, që ishte: deveja. Ajo e ka pasur ditën e caktuar se kur të pijë ujë te pusi (dhe menjëherë të nesërmen ka prodhuar qumësht), dhe devetë e tjera (të popullit) kanë pasur ditën e tyre të caktuar.

إِذْ أَنْبَعَثَ أَشْقَاهَا - kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë)"- mrekullinë që Allahu ia ka dhënë Salihut.

فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا - I dërguari i Allahut (Salihu), u tha atyre: "Kjo është deveja e Allahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!" – Ia ka atribuuar Allahut ngase ajo ka qenë shenjë/provë prej Tij.

فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا فَذَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذُنُوبِهِمْ فَسَوَّاهَا - Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit" – E tillë ka qenë gjendja me të gjithë popujt tek të cilët janë dërguar Pejgamberët e Allahut. Ata e kanë përqeshur dhe u kanë dhënë epitete të ndryshme Pejgamberit të dërguar tek ta (si: magjistar, i çmendur, gënjeshtar i madh, poet, fallxhor etj.).

“dhe e therën atë”- ia prerë njërën këmbë, pastaj është rrëzuar dhe e kanë therë.

“i shkatërroi”- dënimi i ka përfshirë të gjithë. Allahu nuk i bën padrejtësi askujt, por njerëzit i bëjnë padrejtësi vetes së tyre. Gjynahet janë shkaku kryesor për shkatërrime e çrregullime në tokë.

“وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا” - pa pasur frikë prej pasojave të kësaj – Allahu është i Përsosuri. Udhëheqësit e mbretërit kur triumfojnë ndaj një vendi, janë vazhdimisht në frikë se mos herën tjetër ata do të triumfojnë kundër tyre, apo do t’ua kthejnë dyfishë. Mirëpo, Allahu në dorën e të Cilit është i gjithë sundimi nuk i frikësohet pasojave të ndëshkimit të Tij.

Surja el Lejl - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَى ○ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّى ○ وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَى ○ إِنَّ سَعْيَكُمْ
لَشَتَّى ○ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى ○ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى ○ فَسَنِيَرُهُ لِلْيُسْرَى ○
وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى ○ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى ○ فَسَنِيَرُهُ لِلْعُسْرَى ○ وَمَا يُغْنِي
عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّى ○ إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَى ○ فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّى ○ فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا
تَلَظَّى ○ لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى ○ الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى ○ وَسَيُجَنَّبُهَا الْأَتْقَى ○ الَّذِي
يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى ○ وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَى ○ إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ
الْأَعْلَى ○ وَلَسَوْفَ يَرْضَى ○

1. Për natën që mbulon (me terr),
2. për ditën që agon
3. dhe për Atë që ka krijuar mashkullin dhe femrën!
4. Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme.
5. Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai)
6. dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit),
7. Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit.
8. Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm,
9. dhe e quan gënjeshtër më të bukurën (besimin),
10. Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit,
11. e, kur të hidhet (në zjarr), pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi.
12. Neve na përket që t'ua tregojmë rrugën e drejtë,
13. dhe, me të vërtetë, e Jona është ajo botë dhe kjo botë!
14. Prandaj Unë ju kam tërhequr vërejtjen me një zjarr që flakëron,

15. ku do të hidhet vetëm më i keqi,
 16. që ka mohuar dhe është larguar nga besimi.
 17. E do të mbahet larg tij (zjarrit) më i devotshmi (që ruhet nga gjynahet),
 18. që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten
 19. dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë,
 20. por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit.
 21. Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!
-

Komentimi

"وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَى" - **Për natën që mbulon (me terr)**"- Allahu betohet në natën që mbulon. Ajo mbulon tokën me errësirën e saj, është si një mbulesë.

"وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّى" - **për ditën që agon**"- drita e agimit është shenja e parë e ditës. Dielli është shenjë e ditës, hëna është shenjë e natës.

"وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَى" - **dhe për Atë që ka krijuar mashkullin dhe femrën!**" - Betohet në krijimin e tyre.

"إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّى" - **Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme**" - Dallojnë shumë. Në fillim të sures Allahu u betua me gjëra të kundërta me njëra-tjetrën (nata dhe dita, mashkulli dhe femra) për gjëra që janë të kundërta (veprat e njerëzve, që janë të ndryshme e të dallueshme nga njëra-tjetra). Prej

veprave të njerëzve ka që janë vepra të mira, ka që janë vepra të këqija dhe ka që janë vepra të përziera.

"فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى" - Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai)" – E jep atë që Allahu ka urdhëruar të jepet, prej pasurisë, pozitës, dijes. Çdo gjë e cila është urdhëruar të jepet përfshihet në këtë ajet.

"ka frikë (është ruajtur)" prej gjërave prej të cilave Allahu ka urdhëruar të ruhet, pra prej të këqijave, të ndaluarave etj.

"وَصَدَقَ بِالْحُسْنَى" - dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit)" - Fjalët e Allahut dhe të Dërguarit, sepse ato janë më të mirat, më të drejtat, më të vërtetat e më të bukurat. Kush jep, ruhet prej të këqijave dhe dëshmon për vërtetësinë e këtyre fjalëve që janë më të mirat dhe janë udhëzimi më i mirë, atëherë:

"فَسَيُسِّرُهُ لِيُسْرَى" - Ne do t'ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit" - gjithsesi do t'ia lehtësojmë çështjet e tij, ato që kanë të bëjnë me dynjanë dhe fenë e tij, do t'ia lehtësojmë rrugën për te më e lehta. Njerëzit me çështjet më të lehtësuara janë ata që kanë frikë Allahun më së shumti. Ata që plotësojnë këto cilësi të përmendura, kanë më së shumti lehtësime të çështjeve të tyre. Allahu thotë: **"Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia lehtësojë çështjen."** Talak 4. Sa më larg Allahut, aq më të vështira do t'i kenë çështjet e jetës dhe të ahiretit.

"وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى" - Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm" - Nuk jep atë që Allahu ka urdhëruar të japë, prej pasurisë etj. Ndihet i vetëmjaftueshëm, se nuk është nevojtar për Allahun e për mëshirën e Tij, andaj nuk e ka frikë Atë.

"وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى" - dhe e quan gënjeshtër më të bukurën (besimin)" - Fjalët e Allahut dhe të Dërguarit të Tij siç thamë më lartë, i llogarit për të tilla. Si është gjendja e tij? Vijon:

"فَسَيُسِيرُهُ لِلْعُسْرَى" - Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit" - rrugën që dërgon te çështjet më të vështira, ato do t'i vijnë të vështira, në dunja e ahiret. Dikush mund të thotë: "Jobesimtarët i kanë punët më mirë." Themi se vërtetë mund t'i kenë më mirë e më të lehta, por problemi është te zemra e tyre, ato janë në ngushti e vështirësi, **"Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell."** Enam 125. Ato kënaqësi që përjetojnë janë vetëm fizike, ndërsa shpirtrat e tyre nuk gjejnë prehje e kënaqësi, siç gjen shpirti i besimtarit. Ato kënaqësi do të jenë ndëshkim për ta.

"وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّى" - e, kur të hidhet (në zjarr), pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi" - si ka mundësi t'i bëjë dobi pasuria e tij përderisa është koprrac e nuk jep dhe është duke shkuar drejt shkatërrimit?!

"إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَى" - Neve na përket që t'ua tregojmë rrugën e drejtë" - përmes së cilës udhëzohen. Qëllimi këtu është

udhëzimi i sqarimit dhe orientimit. Allahu na tregon se Ai e ka marr përsipër- ia ka bërë obligim Vetes- t'ua sqarojë njerëzve këtë rrugë, në mënyrë që të mos kenë argument kundër Tij në Ditën e Gjykimit. Mendja e njeriut nuk ka mundësi që në mënyrë të pavarur të njohë udhëzimin, rrugën e drejtë. Udhëzimi është dy lloje: 1. udhëzimi i suksesit, inspирimit (ky lloj është vetëm prej Allahut, askush nuk mund ta udhëzojë dikë nëse Allahu nuk e dëshiron këtë), 2. udhëzimi i orientimit, i sqarimit (është prej Allahut dhe prej krijesave- Pejgamberëve, të Dërguarve, dijetarëve). Allahu na ka sqaruar çdo gjë, si: besimin, adhurimet, moralet, raportet ndërnjerëzore, obligimet, të ndaluarat etj., i ka sqaruar në Kuran dhe sunet. Allahu thotë: **"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj"**. Maide 3.

"وَإِنَّ لَنَا لِلْآخِرَةِ وَالْأُولَىٰ" - dhe, me të vërtetë, e Jona është ajo botë dhe kjo botë!" Këtu bota e ahiretit përmendet para jetës së dunjasë, dhe shejh Uthejmini rahimehullah thotë se nga kjo përfitohen dy dobi: 1. Nga aspekti kuptimor: Bota e ahiretit është përmendur e para ngaqë Allahu do të na tregojë se ahireti është shumë më i rëndësishëm sesa jeta e kësaj bote, edhe pse është e fundit, ajo në mendjen e njeriut duhet të jetë e para. Në ahiret do të shfaqet sundimi i Allahut në mënyrë të plotë, i gjithi është vetëm për Atë, 2. Nga aspekti tekstual: Bota e ahiretit është përmendur e para për shkak të përmbajtjes së rimës në fund të ajeteve.

"فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّى" - Prandaj Unë ju kam tërhequr vërejtjen me një zjarr që flakëron - Na frikëson me këtë që të kemi kujdes. Allahu ka përmendur cilësi të shumta të këtij zjarri.

"لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى" - ku do të hidhet vetëm më i keqi - ai që ndjek devijimin, rrugën e humbur, është ai për të cilin Allahu nuk ka shkruar të jetë i lumtur as në këtë botë e as tjetrën. Allahu thotë: "Ata që do të jenë të mjerë, do të hyjnë në zjarr, ku do t'i presin veç ofshamat e vajtimet." Hud 106. Ndërsa më poshtë thotë: "Prandaj, mos u bëj dyshues për atë që këta adhurojnë. Ata adhurojnë vetëm atë që kanë adhuruar dikur të parët e tyre. Dhe Ne do t'ua japim atë që kanë merituar, duke mos ua pakësuar aspak." Hud 108.

"الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى" - që ka mohuar dhe është larguar nga besimi - Këtu sqarohet se cili është ai më i keqi, që do të futet në atë zjarr. Përgënjeshtrimi ose mohimi vjen karshi lajmit, kurse largimi vjen karshi urdhrave dhe ndalesave. I tilli i ka mohuar dhe nuk u ka besuar lajmeve të ardhura në Kuran e sunet, si: ringjalljen, xhenetin e xhehenemin, ndodhitë në ahiret etj. Ndërsa, kur ka ardhur puna të bindja ndaj urdhrave, ua ka kthyer shpinën. Ky është fatkeqi.

"وَسَيُجَنَّبُهَا الْأَتَقَى" - E do të mbahet larg tij (zjarrit) më i devotshmi (që ruhet nga gjynahet) - Ai që më shumti ka frikë Allahun, i druhet e ruhet prej zemërimit të Tij, "Kijeni

frikë Allahun ashtu si i takon Atij" Ali Imran 102. Cilësitë e këtij personi janë:

"الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى" - **që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten**" -u jep atyre që e meritojnë, që të pastrojë shpirtin e tij prej koprracisë dhe veseve të ulëta, "**Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira!**" Teube 103. Dhënia e pasurisë pastron shpirtin e njeriut. Këtu kuptojmë edhe atë se personi i tillë as nuk është dorëshpuar e as dorështrenguar, por jep derisa të arrijë pastrimin e shpirtit të tij. Kriteri i kësaj është "**dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrenguar, por i përmbahen të mesmes**". Furkan 67. Disa njerëzve Allahu u ka dhënë pasuri të shumtë mirëpo janë koprracë, madje edhe obligimet për familjarët nuk i kryejnë, këta janë neglিশentë. E në anën tjetër ka njerëz që nuk kanë shumë pasuri, por marrin borxh për të rregulluar gjërat e jetës siç i ka rregulluar filani e filani, e këta janë ata që e tepron. Të dyja këto rrugë janë të gabuara. Obligim për njeriun është shpenzimi në varësi të gjendjes që ka, në varësi të furnizimit që ka, as të mos jetë neglizhent e as ta teprojë.

"وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَى" - **dhe jo për të shpërblyer dikë që i ka bërë mirë më parë**" - nuk jep sepse tjetri e ka ndihmuar më parë duke u barazuar me të.

"إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ الْأَعْلَى" - por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit" - këtë e ka qëllim: të shohë Allahun në xhenet.

"وَلَسَوْفَ يَرْضَى" - Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!" - Nëse e bën me këtë nijet ai, gjithsesi do të kënaqet, kur i jep Allahu prej shpërblimit të Tij në xhenet, "Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm." Bekare 261.

Surja ed Duha - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالضُّحَىٰ ۝ وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَىٰ ۝ مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَىٰ ۝ وَلَلْآخِرَةُ خَيْرٌ لَّكَ مِنَ الْأُولَىٰ ۝ وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَىٰ ۝ أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَىٰ ۝ وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَىٰ ۝ وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَىٰ ۝ فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ ۝ وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ ۝ وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ ۝

1. Beto hem në shkëlqimin e paradites
2. dhe në natën kur terret e qetësohet,
3. se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)!
4. Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë,
5. e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.
6. A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?
7. A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi?
8. A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?
9. Prandaj, mos e shtyp jetimin,
10. lypësin mos e shty me ashpërsi
11. dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!

Komentimi

"وَالضُّحَىٰ - Beto hem në paraditen që shkëlqen". Duha është fillimi i ditës, pasi lind dielli, kur nis shkëlqimi e ndriçimi dhe e mbush tokën.

"وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَى - dhe në natën kur terret e qetësohet (mbulon tokën)". Sexhe është mbulimi i tokës nga nata, e vendos si mbulesë mbi tokë errësirën e saj. Këtu Allahu betohet në dy gjëra të kundërta (paraditja dhe nata). Ajo për të cilën betohet është:

"مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَى - se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)!" Përkundrazi, Muhamedi salAllahu alejhi ue selem është krijesa më e dashur tek Allahu, e ka dashur dhe e do. Atë e ka përzgjedhur për bartjen e mesazhit të fundit, më madhështor- të jetë i dërguar tek umeti më i vlefshëm, umeti islam. Atë e ka bërë vulë të të gjithë Pejgamberëve, andaj nuk ka të Dërguar pas tij. Allahu, prej të gjithë njerëzve, ka veçuar dy njerëz të cilëve ua ka dhuruar el khule (që është lloji më i lartë i dashurisë): Ibrahimin dhe Muhamedin, ata i ka marrë për halil. Allahu thotë: **"...me të vërtetë, ti je nën Sytë Tanë!"** Tur.48. D.m.th.: Syri i Allahut vazhdimisht e ka mbikëqyrë Muhamedin salAllahu alejhi ue selem, e ka shikuar, është kujdesur për të dhe e ka marrë në mbrojtje. Allahu nuk e ka braktisur Muhamedin salAllahu alejhi ue selem, përkundrazi e ka përfshirë atë me ndihmën, mëshirën e kujdesin e Tij. Ai është i ngritur dhe ka pozitë të lartë në këtë dunja dhe ahiret.

"وَلِلْآخِرَةِ خَيْرٌ لَّكَ مِنَ الْأُولَى - Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë". Kjo gjithsesi. Ahireti është më i mirë për ty sesa jeta e dunjasë. Kjo sepse në ahiret, siç ka ardhur në një hadith kudsij, ka çfarë syri kurrë nuk ka parë, asnjë vesh kurrë nuk ka dëgjuar dhe asnjë zemër nuk mund të imagjinojë, nga të mirat dhe shpërblimet që Allahu ka përgatitur për besimtarët në xhenet.

"وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَى" - e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur". Kjo gjithsesi. Pas një kohe, Allahu do të të japë ty e ti do të jesh i kënaqur. Allahu në Ditën e Gjykimit do t'ia japë Mekamu Mahmud, që është *pozita e lartë e lavdëruar*.

Të mirat që përmenden në fillim të sures janë të mira të cilat do t'ia japë Allahu Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në Ditën e Gjykimit. Pastaj përmend të mirat që ia ka dhënë, në mënyrë që ta falënderojë për to.

"أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَى" - A nuk ishe jetim e Ai dha strehë?" Ka ardhur në formë të pyetjes, për të pohuar dhe miratuar se Muhamedin salAllahu alejhi ue selem ishte jetim dhe i ka dhënë strehë. Ai ka qenë jetim prej babës e prej nënës. Baba i ka vdekur ende pa lindur ai, ndërsa nëna i ka vdekur ende pa u plotësuar koha e gjdhënies. Dhe Allahu është kujdesur për të, ia ka lehtësuar rrugën, e ka mbrojtur vazhdimisht derisa e ka arritur qëllimin për të cilin e ka krijuar (të qenit rob adhures i Allahut dhe i Dërguar i Tij).

Dobi: **"dha strehë"** dhe nuk tha "të dha strehë" kuptimi: përveç që i ka dhënë strehë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, përmes tij i ka dhënë strehë edhe besimtarëve, pasuesve të tij, i ka mbrojtur Allahu dhe i ka përkrahur.

"وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَى" - "A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) dhe udhëzoi?" Ishe pa dije rreth shpalljes, Librit, Pejgamberisë, e Allahu të udhëzoi, të mësoi se çfarë është imani, Kurani etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nuk kishte lexuar asnjë libër dhe as nuk kishte shkruar. Mirëpo, ka arritur pozitë të madhe përmes shpalljes që ia ka zbritur

Allahu. Allahu e ka mësuar dhe pastaj ai ka ditur dhe ka arritur dije të madhe.

Dobi: "**dhe udhëzoi**" e nuk tha "dhe të udhëzoi" kuptimi: Allahu përmes Pejgamerit salAllahu alejhi ue selem i ka udhëzuar njerëzit, ai salAllahu alejhi ue selem ka qenë i udhëzuar dhe udhëzues njëkohësisht, përmes shpalljes që ia ka zbritur Allahu i ka udhëzuar njerëzit, pra të udhëzoi ty dhe të tjerët përmes teje.

"**وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَى**" - **A nuk ishe i varfër dhe pasuroi?**" - Nuk ka poseduar e zotëruar asgjë nga pasuria dhe Allahu e bëri të vetëmjaftueshëm (të panevojshëm) për njerëzit, atë dhe pasuesit e tij salAllahu alejhi ue selem,. Këtë e kanë arritur përmes plaçkës së luftës gjatë betejave. Allahu me këtë u ka dhënë pasuri të madhe.

"**فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَفْهَرْ**" - **Prandaj, mos e shtyp jetimin**". Nuk lejohet kurrsesi shtypja e jetimit. Ky ajet vjen karshi ajetit të lartpërmendur "**A nuk të gjeti jetim e dha strehë?**" Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ishte jetim dhe Allahu i dha strehë, prandaj e porosit të mos e shtyp jetimin. Dijetarët thonë përveç nëse në këtë gjë ka dobi për jetimin, atëherë lejohet në raste të caktuara, dhe kjo nuk llogaritet shtypje edhe pse në pamje mund të shihet si padrejtësi. Përndryshe ndaj jetimit duhet butësi, nderim e bamirësi. Kujdesi ndaj jetimit dhe nderimit ndaj tij është prej urdhrave të fesë islame dhe është prej vlerave të mëdha të kësaj feje. Zemra e jetimit është e thyer. Ai ka nevojë për plotësimin e kësaj zbrazëtire.

"**وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ**" - **Iypësin mos e qorto me ashpërsi**", kur vjen të të kërkojë. Kjo vjen karshi ajetit "**A nuk të gjeti të**

paditur (për Islamin) dhe udhëzoi (mësoi)", andaj gjëja e parë që futet te lypja është kur personi kërkon t'ia mësoh një gjë prej fesë, para kuptimit tjetër (lypjes prej pasurisë). Atë që di prej fesë mësoja, sqaroja, kjo është obligim. Kush kërkon prej teje t'ia mësoh diçka prej fesë, beson se je në pozitë më të lartë sesa ai. Nëse e qorton e i flet fjalë të ashpra, atëherë ai ikën prej teje. Mos e qorto, mos i flit fjalë të rënda, mos e kthe me ashpërsi, as atë që vjen të kërkojë diçka nga pasuria. Përgjithësimi këtu nganjëherë ka veçim se kur lejohet qortimi, p.sh.: kur sheh se tjetri po pyet diçka për fe me qëllim arrogancën e kryeneçësinë (të marrë mendimin e filanit e filanit duke kundërshtuar një mendim me tjetrin mendim), përçarjen e fitnen mes muslimanëve, e jo se ka qëllim të dijë të vërtetën, apo kur dikush që nuk ka nevojë vjen të kërkon diçka nga pasuria (nuk i merr ato para ai vetë por dikush tjetër, me organizim), ky qortim është edukim ndaj të tillëve.

"وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ" - dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!" Këto tri gjëra që u përmenden në ajete (strehimi, dija për fenë dhe panevojshmëria për të tjerët) plotësojnë mirësitë e Allahut. Andaj shpalli ato, fol me to. Qëllimi është: të shpallë se ato mirësi kanë ardhur prej Allahut, kjo si mirënjohje e falënderim ndaj Tij, e jo lavdërim para të tjerëve për to apo të mendosh se je meritator. Kur Allahu jep prej të mirave të Tij, atëherë muslimani e ka për obligim t'i shpallë ato dhe të falënderojë Dhuruesin - Allahun.

Surja Inshirah - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ ۖ وَوَضَعْنَا عَنكَ وِزْرَكَ ۚ
أَلَمْ نُقْضِ ظَهْرَكَ ۖ وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ ۚ
فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ۖ إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ۚ
فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ۖ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ ۚ

1. Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharonin (për të pranuar vendimet e Allahut)
2. dhe ta hoqëm barrën
3. e cila ta rëndonte tepër kurrizin,
4. dhe ta ngritëm lart emrin?!
5. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!
6. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!
7. Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim)
8. dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!

Komentimi

"أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ" - Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharonin (për të pranuar vendimet e Allahut)" - Kjo pyetje tregon për një gjë që është e pohuar, e kryer. Ty veçse ta kemi hapur gjoksin.

"نَشْرَحْ" - neshrah" ta kemi zgjeruar/hapur gjoksin. Ky është zgjerim abstrakt, jo konkret. Qëllimi: ia ka hapur e zgjeruar atë dhe ia ka bërë të gatshëm të pranojë urdhrat e Allahut, vendimet e gjykimet e Tij, ato sheriatike (fetare) dhe të kaderit (fatkeqësitë, sprovat). Feja kundërshton nefsën, i cili

ka dëshira, epshe e teke. Shpesh shpirti i njeriut gjen vështirësi në zbatimin e urdhrave të Allahut dhe në largimin prej ndalesave. Shpirti ka rëndesë dhe nuk mund të zgjerohet e të pranojë lehtësisht fenë, sidomos në largimin prej ndalesave. Ka prej njerëzve të cilëve Allahu ua ka zgjeruar gjokset dhe me lehtësi largohen prej tyre. Qëllimi me pranimin e gjykimeve dhe vendimeve fetare është pranimi me lehtësi i tyre, të qenët i kënaqur me to dhe zbatimi i tyre i menjëhershëm. Ndërsa, sa i përket zgjerimit të gjoksit për të pranuar vendimet e kaderit, qëllimi është të qenët i kënaqur me kaderin e Allahut, gjetja e prehjes në shpirt, si i tillë do të ketë lumturi dhe nuk do të ketë brengosje e shqetësime. Ka mundësi të ketë dhimbje por pa kaluar në nivelin e brengosjes dhe shqetësimit.

Dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka pasur hisen më të madhe në këtë zgjerim të gjoksit. Andaj, gjejmë se ai ka qenë njeriu më i devotshëm, më adhuruesi ndaj Allahut dhe më i durueshmi ndaj kadereve.

وَوَضَعْنَا عَنْكَ وِزْرَكَ - dhe ta hoqëm barrën" - t'i kam falur mëkatet.

الَّذِي أَنْفَضَ ظَهْرَكَ - e cila ta rëndonte tepër kurrizin" - e rëndonte dhe i shkaktonte dhimbje. Kurrizi/shpina është vendi me të cilin bartë diçka, andaj nëse njeriu mban një barrë sipër së pari i lodhet shpina e më tej. Po ashtu shpina është pjesa më e fuqishme për bartje. Allahu ia largoi barrën që i shkaktonte dhimbje dhe e rëndonte (d.m.th. mëkatet). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është magfur - atij që i janë falur mëkatet. I janë falur të gjitha, të kaluarat e të

ardhmet, megjithatë ka bërë adhurim të madh (kjo falje ka qenë e veçantë për të, ndërsa njerëzit e tjerë kanë nevojë për pendim të mëkateve).

Por, a ka bërë mëkate Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem? Po, ka qenë e mundshme që të bie në mëkat. Nuk është çështja se a bën mëkat njeriu apo jo, por çështja më me rëndësi është se ai falet ai mëkat apo jo. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **"Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë/mëkatarë, e më të mirët e gabimtarëve janë ata që pendohen tek Allahu."** Njeriu do të bie në mëkate. Mirëpo, Pejgamberët nuk kanë rënë në mëkate të mëdha apo në gjëra që nuk iu takojnë atyre (gënjeshtër, tradhtia, imoraliteti etj.).

"وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ" - dhe ta ngritëm lart emrin?!" - përmendjen tënde, përmendjen e emrit tënd. Nuk ka dyshim në këtë. Emri i Muhamedit salallahu alejhi ue selem ngrihet lart para çdo namazi, pra në ezan, pastaj në çdo namaz në teshehud dhe sa herë që kryejmë adhurime me këtë lartësojmë emrin e tij, e kjo ngase çdo adhurim patjetër duhet të plotësojë dy kushte për t'u pranuar: sinqeritetin për Allahun dhe pasimin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Kështu, kur njeriu bën një vepër duke pasuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem, ai me mendje e zemër e kujton se është duke e bërë sipas sunetit të tij.

"فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا" - Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi!" Ky është përgëzim prej Allahut për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe umetin e tij. Ai

salAllahu alejhi ue selem ka pasur vështirësi të mëdha e të shumta sa ka qenë në Meke (persekutime, ofendime, lëndime, tortura), kur ka shkuar në Taif dhe kur ka bërë hixhret në Medine (prej hebrenjve e munafikëve). Allahu i tregon se pasi ta kemi hapur gjoksin, ta kemi larguar peshën e mëkateve (të kemi falur), ta kemi ngritur emrin tënd lartë (mirësi këto të cilat janë madhështore), atëherë i tregon se pas vështirësive me të cilat je goditur gjithsesi do të vijë lehtësimi. Lehtësimi këtu përfshin edhe çështjet fetare edhe ato të kaderit.

"فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ" - Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim)" - Allahu na mëson këtu se njeriu duhet të jetë vazhdimisht në vepra, kur të lirohet nga një punë atëherë duhet të angazhohet me një tjetër, kur të lirohet nga një adhurim të fillojë me një tjetër, kur të lirohet nga një çështje e dunjas të fillojë me një tjetër, kur të lirohet nga punët e dunjasë të angazhohet me vepra të ahiretit, (ngase koha ecën), kur të lirohet nga veprat e ahiretit atëherë të angazhohet me punët e dunjasë (edhe nëse është duke pushuar për të qenë më i fuqishëm kjo llogaritet angazhim).

"وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ" - dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!" - Allahu të jetë qëllimi e synimi yt. Pra, kur të përfundosh punët dhe fillon me tjetër, këtë bëje për hir të Allahut, po ashtu synimi yt le të jetë tek Allahu që të të vijë ndihma prej Tij. Duhet të jesh me Allahun, para veprës (duke kërkuar ndihmën e Tij) dhe pas veprës (duke shpresuar në shpërblimin e Tij).

Surja et Tin - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالَّتَيْنِ وَالزَّيْتُونَ ○ وَطُورِ سِينِينَ ○ وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ ○ لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ○ ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ ○ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ○ فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالذِّينِ ○ أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمَ الْحَكَمِينَ ○

1. Për fikun dhe ullirin,
2. për malin e Sinait
3. dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën)
4. Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer,
5. pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët,
6. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.
7. Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri), që ta mohosh Ditën e Kiametit?
8. A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?!

Komentimi

"وَالَّتَيْنِ وَالزَّيْتُونَ - Për fikun dhe ullirin",

"وَطُورِ سِينِينَ - për malin e Sinait", është mali ku i ka zbritur Shpallja Musës alejhi selam. Sinin –që ka bereqet të madh.

"وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ - dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën)", gjithmonë Meka ka qenë vend i sigurt dhe ai është vendi më i dashur tek Allahu, me pozitën më të lartë. Meka është

vendi në të cilin i ka zbritur Shpallja Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Allahu betohet në këto katër gjëra. Pas kësaj Allahu tregon se pse sjellë këto betime:

"لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ" - Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer". Qëllimi: në trajtën e formën më të mirë si krijesë, por gjithashtu në natyrshmërinë e tij. Nuk ka krijesë më të mrekullueshme e më të bukur sesa biri i Ademit - njeriu. E krijesat e tjera janë nën këtë.

"ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ" - pastaj e çuam atë në gjendjen më të ulët", kemi dy kuptime:

-kur kthehet në pleqëri të shtyrë; sa më shumë që shton vite aq më shumë ndryshon e përkeqësohet, sa i përket forcës, formës, bukurisë etj.

- kur devijon e lë rrugën e Allahut, pasi ka qenë në pozitë të lartë të besimit, dijes e adhurimit.

"إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ" - përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera" - kemi përjashtim nga ajeti paraprak. D.m.th.: përveç këtyre: të cilët nuk kthehen në gjendjen më të ulët ngase janë të kapur për besim dhe vepra të mira, e kështu vazhdojnë deri në vdekje.

"pandërprera" vazhdimisht u vjen shpërblimi në ahiret.

"فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالذِّينِ" - Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri), që ta mohosh Ditën e Kiametit?" - I drejtohet njeriut. Din- atë që na ka urdhëruar prej fesë, pra të adhurohet Allahu, të

kryhen urdhrat e Tij, gjëra të cilat nuk lejohet të quhen gënjeshtër. Nëse njeriu i kthehet vetes së tij dhe sheh se Allahu e krijoi në formën më të mirë, me natyrshmërinë më të mirë (e ka në natyrshmëri besimin tek Allahut), atëherë do t'i shtohet besimi në Allahun, në Librin e Tij dhe Lajmet që ka sjellë në të e të cilat i pati sjellë edhe më herët përmes të Dërguarve të Tij.

"أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمَ الْحُكَمِينَ" - A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?!" Ka ardhur në formë të pyetjes për të treguar vërtetim, se gjithsesi Ai është Gjykatësi më i drejtë.

-Ahkem - emër superlativ që tregon se Allahu është më i miri e më i përsosuri në drejtësi. D.m.th: Allahu e ka gjykimin më të madh, askush nuk mund ta kundërshtojë në vendimin e gjykimin e Tij, apo Allahu është më i Urti, me urtësinë më të lartë, më të përsosur, në ligjet e dispozitat e ligjësuara të cilat janë plotë dije, urtësi e drejtësi.

Surja el Alek - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَفْرَأُ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ ۝ خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ ۝ أَفْرَأُ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ ۝ الَّذِي
عَلَّمَ بِالْقَلَمِ ۝ عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ ۝ كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُفٍ ۝ إِنَّ رَعَاهُ
أَسْتَغْنَىٰ ۝ إِنَّ إِلَهَ رَبِّكَ لَرْجَعَىٰ ۝ أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَىٰ ۝ عَبْدًا إِذَا صَلَّىٰ ۝ أَرَأَيْتَ
إِنْ كَانَ عَلَى الْهُدَىٰ ۝ أَوْ أَمَرَ بِالتَّقْوَىٰ ۝ أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ ۝ أَلَمْ يَعْلَمْ
بِأَنَّ اللَّهَ يَرَىٰ ۝ كَلَّا لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ ۝ نَاصِيَةٍ كَذِبَةٍ خَاطِئَةٍ ۝ فَلْيَدْعُ
نَادِيَهُ ۝ سَدَّعَ الزَّبَانِيَةَ ۝ كَلَّا لَا تَطِعُهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ ۝

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka),
2. e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!
3. Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh,
4. i Cili, me anë të penës ia mësoi,
5. ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.
6. Por vërtet që njeriu shkel çdo cak,
7. kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.
8. Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!
9. A e ke parë ti (Muhamed) atë që pengon
10. robin (Tonë) kur falet?
11. A nuk është ai (robi Ynë) në rrugë të drejtë
12. dhe që urdhëron për devotshmëri?!
13. Mendo, nëse ai (penguesi) mohon dhe kthen kurrizin,
14. a nuk e di ai se Allahu i sheh të gjitha?!
15. Jo, jo! Nëse ai nuk tërhiqet nga kjo, Ne do ta kapim
- për ballukesh (për ta hedhur në zjarrin e Xhehenemit),
16. për ballukesh të gënjeshtarit dhe fajtorit.
17. Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet,
18. Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e Xhehenemit)!

19. Kurrresi mos iu nënshtro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!

Komentimi

Pesë ajetet e para të kësaj sure janë fillimi i shpalljes apo ajetet e para që i janë zbritur Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. I kanë zbritur sa ka qenë duke e adhuruar Allahun në shpellën Hira. Shpallja i ka filluar së pari me ëndrra (ka parë disa ëndrra të mira në gjumë, të qarta). Këto ëndrra së pari i janë shfaqur në muajin Rabbijul ewel. Pastaj ka mbetur për gjashtë muaj duke e adhuruar Allahun dhe duke parë këto ëndrra. Ndërsa, në Ramazan i ka ardhur shpallja duke qenë zgjuar. Koha e shpalljes ka zgjatur 23 vite.

Pas atyre ëndrrave që i kanë filluar i është bërë e dashur vetmia (është vetmuar duke u larguar prej shoqërisë së xhahiljetit në të cilën ka jetuar) dhe ka shkuar te shpella Hira (në maje të malit). Aty e ka adhuruar Allahun në vetmi, me adhurime që ia ka mësuar Ai- e ka inspiruar, e jo se i kanë ardhur me shpallje. Këtë e ka bërë për disa netë të caktuara, pastaj është kthyer te shtëpia, ka marr ushqim të mjaftueshëm për disa ditë dhe ka shkuar prapë në shpellë, derisa i ka ardhur Xhibrili me shpallje.

Pastaj i ka ardhur Xhibrili e i ka thënë: "**Ikra - Lexo**". Ndërsa, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka thënë: "*Unë nuk di të lexoj*", nuk di shkrim e lexim. Nuk është për qëllim me këto fjalë refuzimi, por ka dashur t'i tregojë Xhibrilit (edhe pse ai e ka ditur këtë) se nuk di të lexojë.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nuk ka ditur shkrim e lexim, dhe kjo është një urtësi e madhe, ngase kështu nuk mbetet në zemra dyshim për vërtetësinë e tij. Ai nuk ka lexuar Libra të mëhershëm, **"Para këtij, ti (Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin."** Ankebut 48. Xhibrili prapë i ka thënë: **"Lexo!"** dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka thënë: *"Unë nuk di të lexoj."* Pastaj e ka mbuluar/shtrënguar dy apo tri herë dhe ia ka zbritur pesë ajetet e para të kësaj sure. Pas kësaj është kthyer në shtëpinë e tij te Hadixhja radijAllahu anha, i frikësuar shumë nga kjo ngjarje.

"أَقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ" - Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)"- Disa dijetarë kanë thënë: "Lexo duke qenë vazhdimisht në shoqërimin e emrit të Zotit tënd", disa kanë thënë: "Lexo duke kërkuar ndihmë me emrin e Zotit tënd" ngase emrat e Allahut të gjithë janë të bukur, janë të mirë, e ndihmojnë njeriun në çështjet e kësaj jete dhe në adhurime, andaj është mirë që gjithnjë të kërkosësh ndihmë me emrat e Allahut. Gjithmonë punët e mira duhet t'i fillosh me bismilah (me emrin e Allahut, duke kërkuar ndihmën e Tij, apo duke kërkuar ndihmë me emrin e Allahut).

"Zotit tënd", Allahu është Zoti yt i Cili udhëheq universin, drejton të gjitha çështjet dhe Ai i Cili e filloi shpalljen tek i Dërguari. Allahu është Zoti i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, Ai e ka bërë atë terbiye (është kujdesur veçantë për të).

"i Cili krijoi", pra krijoi gjithçka, **"Sunduesi i qiejve dhe i Tokës, i Cili nuk ka bir e nuk ka ortak në pushtet; i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet!"** Furkan 2, **"Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje"** Zumer 62. Çdo gjë që ndodhet në qiej e tokë është krijesë e Allahut, sado e fshehtë që është, apo e dukshme, apo e madhe, apo e vogël, madje edhe grimcat më të vogla.

"خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ - e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!" E veçon njeriun në mesin e të gjitha krijesave dhe e përmend atë. Me këtë ajet Allahu tregon se e ka nderuar atë si krijesë të Tij në mesin e krijesave të tjera, **"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar."** Isra 70.

"عَلَقٍ - alek" droçkë gjaku, gjak i ngjizur, prej saj krijohet dhe fillon jeta e njeriut. Qëllimi i kësaj është se njeriu nuk mund të jetojë pa gjak. Origjina ku fillon krijimi i tij është gjaku. E pastaj zhvillohet formësimi i tij më tej. Në ajete të tjera përmendet krijimi i njeriut prej dheut, diku prej baltës, apo prej baltës së pjekur, apo prej ujit që del fuqishëm, diku prej ujit që është i dobët. E megjithatë nuk kemi kundërthënie mes ajetesh. Kjo sepse, nganjëherë Allahu përmend fillimin e krijimit nga një aspekt e nganjëherë nga një aspekt tjetër. Fillimisht njeriun e ka krijuar prej dheut, pastaj mbi të ka hedhur ujë dhe është bërë balta, pastaj ka kaluar një kohë dhe kjo baltë është bërë baltë e pjekur, pastaj është bërë

salsal (kur e godet lëshon tingull), pastaj e ka bërë mish, pastaj i ka krijuar eshtrat e i ka mbështjellë me mish, pastaj i ka vendosur nervat e organet e tjera. Ky ka qenë fillimi i krijimit të Ademit alejhi ue selam.

Ndërsa krijimi i njerëzve të tjerë, siç e dimë, bëhet prej një pike lëngu (spermatozoidit) nga burri që vendoset në mitrën e gruas, pastaj qëndron aty 40 ditë, pastaj shndërrohet në alek (droçkë gjaku, gjak i ngjizur), pastaj zhvillohet e formohet derisa të bëhet mudga (copë mishi që përtypet) e kështu qëndron për 40 ditë derisa të mbushë 120 ditë (këto janë katër muaj), pas kësaj Allahu dërgon një engjëll dhe fryn shpirtin në të me lejen e Allahut dhe fetusit fillon të lëvizë. Nuk mund ta dimë se si është forma e shpirtit dhe esenca e tij. Deri këtu zhvillimi i fetusit ka qenë pa shpirt, ndërsa pas kësaj kur i fryhet shpirti bëhet njeri. Pastaj vazhdon zhvillimi, dhe pas nëntë muajve lind.

Banesat ku jeton njeriu janë katër: barku i nënës së tij, jeta e kësaj bote, jeta e varrit dhe jeta në xhenet ose në xhehenem.

"أَفْرَأَ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ" - Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh i Cili me anë të penës ia mësoi", prapë thotë "Lexo", dhe qëllimi është për një domethënie të re (jo sikur tek ajeti më lartë). Tek ajeti i parë leximi ishte i ndërlidhur me rububijen e Allahut, me kaderin e Tij, ndërsa këtu është i ndërlidhur me sheriatin, me fenë, ngase feja më së shumti është e bazuar te mësimi, tek të mësuarit, sepse ajo lexohet, mësohet përmendsh dhe shkruhet.

"الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ" - i Cili, me anë të penës ia mësoi".

“عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ - ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte”.

“كَذَّابًا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَاذِبٌ - Por vërtet që njeriu shkel çdo cak kur mendon se është i vetëmjaftueshëm”. I shkel kufijtë kur sheh vetën të vetëmjaftueshëm. Qëllimi nuk është ndonjë njeri i caktuar, por lloji njerëzor. Nëse mendon se është i vetëmjaftueshëm për mëshirën e Allahut (se nuk është nevojtar për të), nuk i kushton vëmendje dhënies së të mirave prej Tij dhe se Ai e mëshiron, atëherë gjithsesi me këtë ai i tejkalon kufijtë. Nëse mendon se është i vetëmjaftueshëm për Allahun në largimin e vështirësive dhe në arritjen e synimeve dhe nuk kthehet kah Allahu, atëherë ai i tejkalon kufijtë. Nëse mendon se është i vetëmjaftueshëm për Allahun ndaj shëndetit dhe harron të sëmurit, apo ndaj ngopjes dhe harron urinë apo të uriturit, apo ndaj veshjes dhe harron se dikush nuk ka, atëherë i tejkalon kufijtë. Tejkalimi i kufijve (vetëmjaftueshmëria) është në natyrën njerëzore. Kështu ia lejon vetes rebelimin ndaj Allahut. Nga kjo përjashtohet besimtari. Ai nuk mendon se është i panevojshëm për Allahun apo i vetëmjaftueshëm. Ai e di se ka nevojë për Allahun qoftë dhe për rrahjen e qepallës. Çdo kohë, çdo gjendje e çdo vend, ai është nevojtar për Allahun.

“إِنِّ إِلَٰهِي رَبِّيَ الرَّحْمَنُ - Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!” Me këtë ajet kërcënon atë që tejkalon kufijtë. Sado që e mban veten të lartë, të ngritur, sado që tejkalon kufijtë, sado që mendon se je i vetëmjaftueshëm, sado që bëhesh mendjemadh dhe arrogant, dije se tek Allahu do të kthehesh. Andaj, nuk ka mundësi t'i ikësh caktimit të

Allahut, dënimit apo shpërblimit dhe drejtësisë së Tij. Tek Allahu është kthimi i çdo gjëje në çështjet e fesë, tek Ai është kthimi në gjykime (duhet t'i kthehemi gjykimeve që janë në Kuran e sunet) dhe tek Ai është kthimi në çështjet e universit. Nuk ka kthim tek tjetër kush përveçse tek Allahu. Çdo gjë e ka kthimin tek Allahu, edhe në çështjet fesë edhe në çështjet e universit.

"أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَى عَبْدًا إِذَا صَلَّى" - A e ke parë ti (Muhamed) atë që pengon robin (Tonë) kur falet?" Penguesi është Ebu Xhehli. Ai nuk e ka pranuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem për të Dërguar ngase kjo do t'ia ulte pozitën në mesin e njerëzve, andaj e ka luftuar atë dhe Islamin dhe ka vdekur në mosbesim. Njeriu të cilin Ebu Xhehli e ka ndaluar prej namazit, është vetë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Ebu Xhehli i kanë treguar njerëzit se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem po falet në Qabe në prezencën e njerëzve dhe po i pengon nga zotat e tyre (po u bën fitne) që të mos i adhuronin lirshëm. Dhe një ditë, duke kaluar afër Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i cili ka qenë në sexhde, Ebu Xhehli i thotë: "A të kam ndaluar ty nga falja në Qabe në prezencën e njerëzve?!" E ka qortuar ashpër. Pastaj, prapë i kanë treguar se po vazhdon të falet në Qabe, sikur i kanë thënë se nuk e ka pranuar kërcënimin tënd. Atëherë Ebu Xhehli ka thënë: "Nëse e shoh edhe një herë duke u falur në Qabe, do ta shkel në qafë me këmbën time dhe do ta mbaj derisa t'i pluhuroset fytyra!" Një ditë e sheh duke u falur dhe do të çojë në vend premtimin e tij. Afrohet te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, por para se ta arrijë atë, Allahu bën një hendek zjarri ndërmjet tyre dhe sheh

disa gjëra frikësuese, andaj zmbropset pa arritur ta dëmtojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem (e kupton paaftësinë e tij në raport me të). Pra, kjo është ngjarja për shkak të së cilës Allahu ka zbritur këtë ajet. Ai tregon se sa e çuditshme është gjendja e tij, i cili e ndalon robin e Tij që falet për hir të Tij.

أَرَعَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَى الْهُدَىٰ - **A nuk është ai (robi Ynë) në udhëzim**", në rrugën e drejtë - Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

أَوْ أَمَرَ بِالْقَوَىٰ - **ose që urdhëron për devotshmëri?!**" Edhe falet edhe urdhëron të tjerët për devotshmëri. Pa dyshim se ai, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i ka urdhëruar të tjerët në devotshmëri ndaj Allahut, ai ka qenë i devotshëm dhe ka qenë përmirësues i të tjerëve drejt devotshmërisë.

أَرَعَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ أَلَمْ يَعْلَم بِأَنَّ اللَّهَ يَرَىٰ - **Mendo, nëse ai (penguesi) mohon dhe kthen kurrizin, a nuk e di ai se Allahu i sheh të gjitha?!**" E di dhe e sheh, Ai e di kush falet dhe kush i tejkalon kufijtë. Çdonjërin do ta shpërblejë ose do ta ndëshkojë sipas dijes së Tij. Allahu e kërcënon atë që ka ndaluar robin e Tij i cili është falur për hir të Tij dhe tregon se e di shumë mirë gjendjen e tyre dhe secilin do ta shpërblejë ose do ta ndëshkojë në bazë të asaj që meriton.

كَلَّا لَئِنْ لَّمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ - **Jo, jo! Nëse ai nuk tërhiqet nga kjo, Ne do ta kapim për ballukesh (për ta hedhur në zjarrin e Xhehenemit)**". Kel-le - gjithsesi, ose është qortim ndaj tij. Nasia është pjesa e përparme e kokës. Në ajet kemi

betim (që nënkuptohet). Do ta kapim me forcë, me fuqi, me ashpërsi. Qëllimi është për Ebu Xhehlin.

نَاصِيَةٌ كُذِبَ خَاطِنَةٌ - për ballukesh gënjeshtare dhe mëkatare".

Gënjeshtra më e madhe është ajo që rrjedh prej jobesimtarëve, të cilët adhurojnë të tjerë përveç Allahut. Nuk ka gënjeshtër më të madhe dhe vepër më të shëmtuar sesa shirku që i bëhet Allahut.

"Mëkatare" i bën mëkat Allahut qëllimisht.

فَلْيَدْعُ نَادِيَهُ - Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet" -

Allahu e sfidon që nëse ai (Ebu Xhehli) është i drejtë në fjalët e tij se ka forcë dhe njerëz që e mbështetësin, atëherë le t'i thërrasë. Nedi: është vendi ku është mbledhur populli (siç kanë qenë te ne odat). Ebu Xhehli ka pasur një nedi të veten, ku ka mbledhur parinë e popullin dhe Kurejshët të cilët e kanë respektuar.

سَدْعُ الرِّبَانِيَّةِ - Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e Xhehenemit)!" -

Allahu na tregon se ka ushtarë, që janë më të fortë e më të fuqishëm, sesa populli i Ebu Xhehlit i mbledhur në nedin e tij. E ato janë Zebanijet, engjëjt që janë roje të zjarrit të xhehenemit. Ato janë të ashpra në pamje, kur t'i shohësh do të frikësohesh, janë të fuqishme, kanë forcë të madhe. Nuk tregojnë mosbindje ndaj Allahut në zbatimin e urdhrave të Tij, menjëherë binden, nuk kanë arrogancë e mendjemadhësi, por kanë përvullje e nënshtrim të plotë ndaj urdhrave të Tij. Edhe nëse dikush thërret tërë popullin e tij apo njerëzit e botës, nuk mund të ballafaqohet me këto roje të xhehenemit.

"كَلَّا لَا تُطَعُّهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ" - Kurrresi mos iu nënshtro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!" Mos ia vë mendjen atij. Duke qenë se Allahu ia ndalon Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem t'i bindet Ebu Xhehlit, atëherë kjo tregon se do ta mbrojë e përkrahë atë salAllahu alejhi ue selem prej tij. Pra, vepro ashtu siç të urdhëron Allahu, mos të të shqetësojë çështja e tij e as kërcënimet e tij. Allahu e ka mbrojtur Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe nuk ka lejuar Ebu Xhehlin të arrijë deri tek ai.

"bëj sexhde" d.m.th fal namaz. Sexhdja është vendi në të cilën njeriu është më së afërmi me Allahun.

Kjo është një sure e madhe. Allahu e fillon duke treguar mirësinë e begatinë e madhe ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në veçanti dhe ndaj umetit të tij në përgjithësi, që është: zbritja e shpalljes. E pastaj e përfundon duke përmendur sexhden, pra se duhet ta falënderojmë Allahun, duhet bërë namaz për hir të Tij dhe se duhet afruar tek Ai me bindje e respektim për këtë mirësi e cila është Islami.

Surja el Kadr - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ○ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ لَيْلَةٌ ○ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ
شَهْرٍ ○ تَنَزَّلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ ○ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ
الْفَجْرِ ○

1. Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.
2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?
3. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.
4. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.
5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.

Komentimi

"إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ" - Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) në Natën e Kadrit." Këtu Allahu kur flet për Vetveten flet në shumës "Ne", për të treguar madhështinë dhe madhërinë e Tij. Këtu sjellë përemrin "atë", i cili i referohet Kuranit. Kjo është e njohur dhe askush nuk dyshon në këtë. Allahu e ka zbritur Kuranin në natën e Kadrit. Nata e Kadrit është në Ramazan, "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)." Bekare 185. Me këtë kuptojmë gabimin e përhapur të disa njerëzve të cilët mendojnë se Nata e Kadrit

është në gjysmën e muajit Shaban, i cili është mendim i kotë, i pabazuar në argumente.

Allahu e ka zbritur Kuranin në Natën e Kadrit. Pse kjo natë quhet kështu? Dijetarët kanë dhënë dy mendime: 1. Për shkak se Kadr në gjuhën arabe tregon për pozitë të lartë, andaj thonë se edhe kjo natë ka pozitë të lartë tek Allahu, 2. Për shkak se në këtë natë caktohet se çfarë do të ndodhë brenda vitit deri në natën e kadrit të vitit të ardhshëm, caktohet çdo çështje (që ka të bëjë me veprat e njerëzve, furnizimin e tyre, dhënien jetë e vdekje etj.). E sakta është se të dy kuptimet janë të vërteta, sepse nuk ka dyshim se nata e Kadrit ka pozitë të lartë e të madhe tek Allahu, po ashtu në këtë natë caktohet se çfarë do të ndodhë brenda vitit.

"الْفَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ" - E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit? Ka ardhur në formë të pyetjes për të treguar zmadhim. Kur Allahu dëshiron të tregojë për pozitën e madhështinë e një gjëje, atëherë e këtë e sjellë në formë të pyetjes, si këtu. Pra, askush nuk mund të të tregojë se çfarë është nata e Kadrit përveç Allahut, ajo ka aq pozitë të lartë e të madhe saqë askush tjetër përveç Tij nuk ka mundësi të ta shpjegojë e sqarojë se çfarë është ajo.

"الْفَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ" - Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj", më e mirë e më e vlefshme se njëmijë muaj në të cilët nuk është nata e Kadrit. Allahu shpjegon madhështinë e saj, pozitën e saj tek Allahu. Kjo mirësi e natës së kadrit, vlefshmëria, është sa i përket shpërblimit të veprave. Bërja e veprave të mira në këtë Natë ka shpërblim sa (t'i bësh ato për) njëmijë muaj. Mirësia e atës së Kadrit

është shumë e madhe. Allahu në këtë natë zbret mirësi e bereqet të madh. Kush e ngjallë këtë natë (me adhurime), kjo me besim dhe duke shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e kaluara.

تَنْزَلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِّنْ كُلِّ أَمْرٍ - **Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.**" Allahu na tregon se çfarë ndodhë në këtë natë. Engjëjt janë banorë të qiellit, nuk banojnë në tokë. Shtatë palë qiej që janë mbi ne janë të mbushur me engjëj të cilët e adhurojnë Allahun. Në natën e Kadrit engjëjt zbresin (gradualisht) vazhdimisht derisa të mbushet toka. Zbritja e tyre tregon se ajo natë është natë e mirësisë, e bereqetit dhe e mëshirës.

Shpirti është Xhibrili alejhi ue selem. Kështu e quan Allahu në Kuran. Ai e veçon në mesin e të gjithë engjëjve, kjo për të treguar pozitën e lartë që ka tek Ai dhe vlerën e tij, se ai sallon prej të gjithë engjëjve. Pra në këtë natë zbresin engjëjt, por në mesin e tyre është edhe Xhibrili.

بِإِذْنِ رَبِّهِمْ - **me lejen e Zotit të tyre**" - me urdhrin e Tij. Është fjala për lejen universale (kur Allahu lejon me vullnetin e dëshirën e Tij të ndodhë diçka në univers, në mbretërinë e Tij).

مِّنْ كُلِّ أَمْرٍ - **zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.**" Zbresin me çdo çështje, me të cilën Allahu i urdhëron. Allahu nuk na sqaron këtu se cilat janë këto çështje. Këtë e di vetëm Allahu.

سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ - **Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.**" Kjo natë është Selam - Paqe (shpëtim) për arsyë

sepse janë të shumtë ata që shpëtojnë në këtë natë, prej mëkateve dhe pasojave të tyre. Allahu i fal një pjesë të madhe të muslimanëve, sidomos ata që kërkojnë faljen e Tij. Engjëjt vazhdimisht zbresin në këtë natë në tokë deri në agim. Kur të agojë dita, përfundon nata e Kadrit.

Surja El Bejjineh - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِينَ حَتَّى تَأْتِيَهُمُ الْبَيِّنَةُ ۖ رَسُولٌ
مِّنَ اللَّهِ يَتْلُوا صُحُفًا مُّطَهَّرَةً ۖ فِيهَا كُتِبَ قِيمَةٌ ۖ وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا
مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَةُ ۖ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيُعْبَدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ
وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ ۚ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ ۖ إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ
وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا ۚ أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ ۖ إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا
وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ ۖ

1. Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre), derisa t'u vinte Dëshmia e qartë:
2. Një i Dërguar nga Allahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kuranin),
3. të cilat përmbanin rregulla të drejta.
4. Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë.
5. E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.
6. Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.
7. Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira.
8. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë.

Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.

Komentimi

Ata - لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِينَ حَتَّى تَأْتِيَهُمُ الْبَيِّنَةُ - Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre), derisa t'u vinte **Dëshmia e qartë**" - Ithtarët e Librit janë të krishterët dhe hebrenjtë. Quhen kështu sepse tek ta kanë mbetur disa prej fletëve të zbritura prej Allahut (fletushka apo libra si shpallje prej Tij), derisa është dërguar Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, edhe pse në to ka shtrembërime, ndryshime e zëvendësime që kanë bërë (ndërhyrje). Hebrenjtë e kanë pasur Tewratin (që i ka zbritur Musës) dhe të krishterët kanë pasur Inxhilin (që i ka zbritur Isës). Ndërsa, idhujtarët (mushrikët) janë ata që adhurojnë idhuj dhe gjëra të tjera, përveç Allahut.

Bejjineh quhet dëshmia e qartë përmes së cilës sqarohet e vërteta rreth diçkaje; çdo gjë përmes së cilës sqarohet një e vërtetë në arabisht quhet bejjineh. Cila është bejjineh që përmendet në këtë ajet? Kjo sqarohet në ajetin vijues:

رَسُولٌ مِّنَ اللَّهِ يَتْلُو صُحُفًا مُّطَهَّرَةً - **Një i Dërguar nga Allahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kuranin)**" - Ky i Dërguar (resul) është Muhamedi salAllahu alejhi ue selem. Përmendet në trajtë të pashquar "**Një i Dërguar**" duke treguar me këtë respekt për të, ngase ai meriton të respektohet e madhërohet (aq sa i takon, pa tejkaluar kufijtë: teprim apo

mangësim). Allahu e ka dërguar mbi të gjithë njerëzimin, si paralajmërues dhe përgëzues. Xhibrili ia ka sjellë shpalljen prej Allahut. Ky i Dërguar lexon vetë fjalë të pastra dhe ua lexon të tjerëve.

"صُحُفٌ" - quhen vendet ku shkruhet Kurani, si: fletë, pllakë, asht, gurë, lëkurë etj. Fillimisht është shkruar nëpër këto gjëra.

مُطَهَّرَةٌ - **të pastra** - prej shirkut, prej sjelljeve e moraleve të ulëta dhe çdo gjëje që llogaritet e keqe, ngase janë të dëlira apo të shenjta.

"فِيهَا كُتِبَ قِيمَةٌ" të cilat përmbanin rregulla të drejta - Në ato faqe janë shkrimet e drejta prej Allahut, të cilat e drejtojnë njeriun në rrugën e drejtë (si: teuhidi, madhërimi ndaj Allahut, namazi, moralet e mira etj.).

وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْبَيِّنَةُ" **Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë** – Kur u erdhi dëshmia e qartë u përçanë, ku disa besuan, disa mohuan e nuk e pranuan shpalljen. Kush ka synuar të mirën (hajrin), ndjekjen e së vërtetës dhe ka qenë i singertë, Allahu ia ka mundësuar të besojë dhe e ka frymëzuar e i ka dhënë sukses drejt së vërtetës (besimit). Pra, para se të vijë shpallja, kanë vazhduar të qëndrojnë në gjendjen që kanë qenë (në mohim e shirk), e pastaj kur u ka ardhur bejjine - shpallja e qartë, janë ndarë në dy grupe: besimtarë dhe jobesimtarë.

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ ۚ" **E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të**

adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë". Njerëzit në përgjithësi, e në mesin e tyre edhe ithtarët e Librit (me Tewrat dhe Inxhil) nuk janë urdhëruar për asgjë tjetër veçse që të adhurojnë Allahun duke ia kushtuar fenë Atij, pa përzier adhurimet me lloje të shirkut. Mirëpo, hebrenjtë kanë thënë për Uzejrin se është bir i Allahut dhe e kanë adhuruar atë dhe të tjerët prej parive të tyre, po ashtu të krishterët kanë thënë se Isa është bir i Allahut dhe e kanë adhuruar atë, nënën e tij dhe shenjtorët në vend të Allahut. Me këtë kanë bërë shirk.

حَنَافًا - Hunefe është shumësi i hanif. Dhe hanif është ai që largohet prej çdo feje tjetër dhe i drejtohet vetëm adhurimit ndaj Allahut, largohet prej shirkut drejt teuhidit, duke qenë në fenë e Ibrahimit dhe të Muhamedit salAllahu alejhi ue selem.

Adhurimi këtu përmendet i shoqëruar nga dy gjëra: *ikhlas*i (që me adhurimin të synohet Fytyra e Allahut dhe xheneti, e jo gjërat e kësaj jete) dhe *hunefe* (drejtimi vetëm kah feja e drejtë, Islami).

"وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ - të falnin namazin" në kohën e tij dhe sipas dispozitave të zbritura prej Allahut. Përmendet namazi sepse ai është prej adhurimeve më të larta të trupit.

"وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ - të japin zekatin" në kohën e tij dhe aty ku duhet. Zekati është bamirësi e obliguar.

"وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ - Kjo është feja e vërtetë", e drejtë, që askujt nuk i bën padrejtësi, pra të adhurohet vetëm Allahu, të falet namazi e të jepet zekati. Namazi dhe zekati përmenden

ngase janë shtyllat më të forta të Islamit pas dy shehadeteve. Namazi është më i konfirmuar sesa zekati. Kjo që u përmend më lartë është feja e drejtë. Thotë "feja e vërtetë, e drejtë" ngase ata që kanë mohuar prej të krishterëve e hebrenjve dhe idhujtarëve nuk e kanë pranuar atë kur ka ardhur prej Allahut.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ " - Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija" - Allahu sqaron dhe konfirmon me "në të vërtetë" d.m.th.: patjetër. Ithtarët e Librit janë jobesimtarë, ata nuk janë besimtarë derisa të besojnë Muhamedin salAllahu alejhi ue selem si i Dërguar i Allahut. Nuk llogariten besimtarë edhe nëse thonë "Besojmë në Zot, besojmë në Ditën e Fundit, lutemi për të vdekurit tanë që t'i falë Allahu", derisa të besojnë Muhamedin për të dërguar, madje dhe të Dërguarit e tyre, ngase Allahu e ka përshkruar Muhamedin salAllahu alejhi ue selem në Librat që ua kishte zbritur më herët e që e kanë përgënjeshtruar (përveç një pjese të paktë).

"**krijesat më të këqija**"- duke qenë kështu atëherë prej tyre duhet pritur vetëm të keqen, ngase e keqja buron prej të keqes, të keqit, dhe nuk ka mundësi të kemi mendim të mirë për ta.

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِّ" - Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira" - pasi përmend jobesimtarët, pastaj

përmend besimtarët. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira janë katër nivele, siç përmendet kjo në suren Nisa 69: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** Të parët janë të Dërguarit e Pejgamberët, pastaj të sinqertët, pastaj dëshmitarët dhe pastaj të devotshmit.

جَزَاؤُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ - Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet" - Allahu së pari i lavdëroi pastaj përmendi shpërblimin për ta, ngase lavdërimi i Allahut për besimtarin është një gjë shumë më e lartë sesa shpërblimi që merr.

Surja Ez Zelzeleh – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زُلْزَالَهَا ۝ وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ۝ وَقَالَ الْإِنْسَانُ
مَا لَهَا ۝ يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ۝ بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا ۝ يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ
النَّاسُ أَشْتَاتًا لِّيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ ۝ فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ۝ وَمَنْ
يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ۝

1. Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit),
2. kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj
3. e njeriu të thotë: “Ç’po i ndodh asaj?!”
4. Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj,
5. sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.
6. Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre:
7. kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë,
8. e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.

Komentimi

"إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زُلْزَالَهَا" - Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit)" - qëllimi me të është dridhja që do të ndodhë në Ditën e Kiametit. Allahu në suren Haxh e përshkruan këtë dridhje: "Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua

shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër." Haxh 2. Toka nuk përjeton dridhje më të madhe sesa kjo dridhje (zelzele) në Ditën e Kiametit. Për shkak të frikës së madhe njerëzit do të duken sikur janë të dehur (nuk dinë si të sillen, si të veprojnë). Tmerri i asaj dite është i madh.

"وَأُخْرِجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا" - kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj" - do t'i nxjerrë të vdekurit e varrosur. Kur fryhet Suri (për herën e dytë) njerëzit ngjallen prej varreve dhe dalin para Allahut.

"وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا" - e njeriu të thotë: "Ç'po i ndodh asaj?!" - çdo njeri do ta thotë këtë, kur ta përjetojnë këtë dridhje të madhe.

"يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا" - Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj - do të tregojë se çfarë kanë vepruar njerëzit prej të mirave e të këqijave. Qëllimi i kësaj dëshmie është se Allahu do të tregojë drejtësinë e Tij absolute. Ai nuk i ndëshkon njerëzit përveçse për atë që kanë vepruar. Allahu ka përfshirë çdo gjë me dijen e Tij. Mjafton si drejtësi t'i thotë robit të Tij: "Ke bërë këtë të mirë e këtë të keqe", mirëpo Ai do ta ngritë drejtësinë e Tij në mënyrë që ai i cili ka bërë të këqija të mos ketë mundësi të mohojë apo refuzojë atë që Allahu i thotë, dhe kështu e inspiron tokën që të tregojë lajmet e saj. Jobsimtarët në Ditën e Gjykimit do të mohojnë se i kanë bërë shirk Allahut (me shpresën që të shpëtojnë), mirëpo atë Ditë përveç që Allahu do ta inspirojë tokën të dëshmojë,

po ashtu ua mbyll gojët dhe u flasin duart, këmbët, lëkura, duke dëshmuar kundër tyre. Andaj, nuk u mbetet justifikim për mohim, mirëpo e pranojnë dhe pastaj vjen gjykimi i Allahut.

"بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا" - sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë - Kjo është arsyeja pse toka flet dhe tregon lajmet e saj. Kur Allahu urdhëron një gjë, patjetër do të ndodhë, edhe nëse është një gjë e ngurtë, pa shpirt, nëse Allahu e urdhëron të flasë, atëherë do të flasë gjithsesi, sepse urdhri i Allahut patjetër do të ekzekutohet. Fuqia e Allahut është shumë e madhe, Ai kur iu flet gjërave të ngurta, i përgjigjen Atij.

"يَوْمَئِذٍ يَصُدُّ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِّيُرُوا أَعْمَالَهُمْ" - Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'iu tregohen veprat e tyre - secili drejtohet kah vendstrehimi i tij, përfundimi i tij. Pra banorët e xheneti drejtohen për në xhenet, ndërsa banorët e xhehenemit shtyhen me forcë për në xhehenem. Njerëzit do të vijnë grupe-grupe në Ditën e Gjykimit, dhe janë lloje të ndryshme të njerëzve, secili dallon nga tjetri, në bazë të besimit e veprave.

Do të vijnë grupe-grupe **"që t'iu tregohen veprat e tyre"** që t'i shohin ato. Allahu ua mundëson t'i shohin veprat e tyre. Nëse kanë bërë mirë, do të gjejnë shpërblime. Nëse kanë bërë keq, do të gjejnë dënim. Kjo përmes llogarisë dhe Librit ku janë regjistruar veprat e secilit. Njeriut do t'i jepet Libri i tij ose në anën e djathtë ose në të majtë. Pastaj do të merret në llogari në bazë të asaj që është shënuar aty. Atë Ditë, njerëzve do t'iu tregohen të gjitha veprat, të shumtat e të paktat, të mëdhatë e të voglat, përveç atyre veprave që u

janë falë përmes veprave të mira që kanë bërë apo kërkimfaljes.

Besimtarin e trajton Allahu në një mënyrë të mirë, siç ka ardhur në hadithe të sakta. Allahu do të vetmohet me secilin prej besimtarëve dhe i thotë: **“Ke bërë këtë, këtë, këtë.”** dhe pastaj i thotë: **“T’i kam mbuluar në dunja, do t’i fali sot.”** Ndërsa, sa i përket jobesimtarëve, Allahu do t’i thërrasë para të gjitha krijesave (i ekspozon), dhe: **“Ata do të sillen para Zotit të tyre e dëshmitarët do të thonë: “Këta janë ata që kanë gënjyer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët...”** Hud 18.

Njeriu do të shohë veprat e tij derisa t’i bëhet e qartë çdo gjë, pastaj i jepet Libri, **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”** Isra 14. Besimtari e ka për obligim të mos veprojë vepra të cilat e zemërojnë Allahun, por të veprojë vepra të cilat e kënaqin Allahun, ngase çdo vepër shkruhet dhe në ahiret do të llogaritet për të.

“فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ” - kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë" - në këtë përfshihet çdokush, i cili ka vepruar vepra qoftë sa thërrmija. Dherr ka kuptimin: milingonë e vogël, me peshë shumë të lehtë.

Kjo sure është paralajmërim, tërheqje e vërejtjes dhe frikësim për ne, ndaj Ditës kur do të dridhet toka. Po ashtu Allahu na nxit përmes saj për veprimin e veprave të mira, dhe se sado të pakta të jenë nuk do të humbasin, por do t’i

gjejmë tek Allahu dhe do të shpërblehemi për to, edhe nëse janë sa thërmija e më pak.

Surja el Adijat - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَدِيَّتِ ضَبَجًا ۝ فَأَلْمُورِيَّتِ قَدَحًا ۝ فَأَلْمُغِيرَتِ صُبْحًا ۝ فَأَثَرْنَ بِهِ
نَقْعًا ۝ فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا ۝ فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا ۝ إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ
لَكَنُودٌ ۝ وَإِنَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ لَشَهِيدٌ ۝ وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ ۝ أَفَلَا يَعْلَمُ
إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ ۝ وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ ۝ إِنَّ رَبَّهُم بِهِمْ يَوْمَئِذٍ
لَّخَبِيرٌ ۝

1. Betohem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur,
2. që nxjerrin xixa nga thundrat
3. dhe trokojnë për sulm në mëngjes,
4. duke çuar re pluhuri,
5. ndërsa çajnë armikun në dysh,
6. se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet,
7. dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon.
8. Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri.
9. Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre
10. dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse,
11. Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!

Komentim

"وَالْعَدِيَّتِ ضَبَجًا" - Betohem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur" - Adijat është cilësi ose mbiemër i një gjëje që nuk është përmendur në ajet. Atëherë cila është ajo gjë, kuajt apo devetë? Këto janë dy mendime të dijetarëve të tefsirit.

Sa i përket deveve për qëllim janë devetë që shpejtojnë gjatë rriteve të haxhit, pra ato deve me të cilat besimtarët kanë kryer ritet e haxhit. Ndërsa, mendimi më i saktë: qëllimi është për kuajt. Kuaj që shpejtojnë (që sulmojnë armikun, edhe nëse jo për të vërtetën), kjo ka qenë e njohur tek arabët, ka ekzistuar edhe para Islamit, mirëpo pas Islamit kuajt e përdorur në luftëra kanë vrapsuar dhe kanë sulmuar armikun në të vërtetën.

"ضَبَّاجًا" - dabha" - dab është një tingull (dihatje) që del nga brendësia, nga gjoksi i kuajve, kur vrapsjnë shpejt. Kjo tregon se vrapimi që bëjnë ata është shumë i ashpër, i fuqishëm e i shpejt.

"فَالْمُورِيَّتِ قَدْجًا" - **që nxjerrin xixa nga thundrat**" - kur vrapsjnë shpejt e ashpër, godasin gurët, e pastaj gurët godasin njëritjetrin dhe prej tyre dalin xixa, ose kur vrapsjnë shpejt nxjerrin xixa prej thundrave të tyre kur godasin gurët.

"فَالْمُغِيرَتِ صُبَّاجًا" - **dhe trokojnë për sulm në mëngjes**" - dijetarët thonë se kjo është koha më e mirë të sulmohet armiku, kjo sepse në mëngjes ata janë në gjumë, të pavëmendshëm, edhe nëse zgjohen kanë lodhje e dembeli dhe nuk mundën të kundërpërgjigjen.

"فَأَتَرْنَ بِهِ نَقْعًا" - **duke çuar re pluhuri**" - kur të futen në mesin e armiqve.

"نَقْعًا" - nek'a" është pluhuri nga vrapimi i shpejt.

"فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا" - **ndërsa çajnë armikun në dysh**" - duke çuar pluhur ata hyjnë në mesin e armiqve. Allahu na tregon se

cili është destinacioni i këtyre kuajve. Pra, janë aq të shpejt, të fuqishëm, kur vrapojnë, saqë nuk ndalen derisa të futen në mesin e armiqve, çajnë armikun në dysh. Kjo dhe është dobia më kryesore e kuajve. Pas kësaj, Allahu na tregon në vijim se pse solli këto betime të lartëpërmendura:

"إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ" - se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet – Allahu betohet këtu se nëse Ai nuk e udhëzon njeriun, si lloj (njerëzimi), atëherë ai është mohues i madh i mirësive të Tij. Disa dijetarë kanë thënë se me njeriun janë për qëllim jobesimtarët. Mirëpo, mendimi më afër së vërtetës është ai i pari, pra lloji njerëzor. Allahu i jep njeriut furnizim e ai përmes atij furnizim bëhet më arrogant, kryeneç, largohet edhe më shumë prej Tij, ndihet i vetëmjaftueshëm e i panevojshëm për Allahun, nuk e falënderon Atë dhe nuk është mirënjohës për atë që ia ka dhënë nga mirësitë e Tij. Sa shumë prej njerëzve ka që e veprojnë këtë!

"وَإِنَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ لَشَهِيدٌ" - dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon - janë dy mendime se për kë është fjala me **"وَإِنَّهُ" - dhe ai**". Mendimi i parë: Allahu dëshmon se robërit e Tij janë mohues të mirësive të Tij. Mendimi i dytë: njeriu dëshmon për këtë mosmirënjohje. E sakta është se ajeti përfshin të dy mendimet. Pra, Allahu është Dëshmitar për atë që është në zemrën e njeriut, Ai e sheh dhe e di çfarë ai ka në zemër dhe sheh veprat e tij, dhe njëkohësisht edhe njeriu është dëshmitar kundër vetes së tij, kjo ose me gjendjen e tij ose me gjuhën e tij.

"وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ" - Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri - e do shumë, e lakmon atë. Dashuria ndaj pasurisë është cilësi e natyrës së njeriut, mirëpo ka prej njerëzve që e duan pasurinë më pak (se të tjerët) e dikush më shumë. Pra, sa i përket niveleve të dashurisë ndaj pasurisë, njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri. Sa i takon besimtarit, ai e do pasurinë aq sa të përmbushen nevojat e tij e të mos bëhet nevojtar për të tjerët.

"أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ" - Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre - kur të ringjallen. Sikur të ishin të bindur dhe të punonin (vepra të mira) për këtë ditë e të mos ishte preokupimi kryesor i tyre pasuria!

"وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ" - dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse - në zemra, pra njetet/qëllimet e njerëzve, se me çfarë njeteti kanë bërë vepra, po ashtu veprat e zemrës (frika, shpresa, mbështetja etj.) dhe mëkatet e zemrës. Zemra është ajo e cila duhet të përmirësohet shumë. Në bazë të asaj që ke në zemër, ose do të shpërblehesh ose do të dënohesh. Ajo që është në varre do të dalë jashtë, po ashtu ajo që është në zemra do të shfaqet.

"إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّخَبِيرٌ" - Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?! - Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i mirinformuar për njerëzit se çfarë kanë vepruar. Në këtë ajet dija është lidhur me Ditën e Gjykimit, sepse ajo është Dita e shpërblimit ose e ndëshkimit (e Ai është i Gjithëdijshtëm (Alim) për njerëzit atë Ditë dhe para saj). Allahu është i Gjithëdijshtëm për ta dhe për veprat e tyre atë

Ditë ngase atë Ditë do t'i shpërblejë ose do t'i dënojë për
veprat që kanë bërë.

Surja Kariah - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْقَارِعَةُ ۝ مَا الْقَارِعَةُ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ ۝ يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ
كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ ۝ فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ ۝ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ ۝
وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ۝ فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَةُ ۝
نَارٌ حَامِيَةٌ ۝

1. Gjëmimi i tmerrshëm!
2. Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm?
3. Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?
4. Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara,
5. kurse malet si leshi i shprishur.
6. Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore,
7. ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet).
8. E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore,
9. Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit).
10. Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehenemit)?
11. Ajo është një Zjarr i vrullshëm.

Komentimi

“الْقَارِعَةُ - Gjëmimi i tmerrshëm!” - ajo që godet zemrat pasi godet dëgjimin, gjësim i madh, zhurmë e madhe, zë i

tmerrshëm. Pasi e dëgjojnë zemrat kaplohen nga një frikë e madhe. El Kariah është prej emrave të Kiametit.

مَا الْقَارِعَةُ - Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm?" Allahu e sjellë këtë pyetje për ta stërmadhuar dhe treguar madhështinë e peshën e madhe të kësaj dite.

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ - Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?" Me këtë shton edhe më shumë stërmadhimin dhe frikësimin për këtë ditë.

يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ - Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara" - kur dalin prej varreve, të gjithë njerëzit, të varrosur apo të pavarrosur, përnjëherë. Dijetarët kanë thënë se sa mirë ka ardhur ky përshkrim për gjendjen e njerëzve në atë ditë. Fluturat janë krijesa të dobëta, shumicën e rasteve ecin pa ditur kah janë duke shkuar dhe shumëherë bëhen grumbull i madh. Për shkak të konfuzionit që kanë mund edhe të bien në zjarr, pa e ditur e pa e ndjerë. Andaj njerëzit atë ditë do të jenë sikurse fluturat: të dobët, në konfuzion, grumbull i madh dhe nuk do të dinë kah të ecin (s'kanë udhërrëfyes).

فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ - kurse malet si leshi i shprishur" – si leshi apo pambuku, që e shprishin me mjete apo me duar para se të fillohet ta tjerren, dhe kur shprishet bëhet shumë i lehtë. Edhe malet e kodrat (pasi ishin të forta e të luhatshme) do të jenë të tilla, të lehta, sikurse leshi a pambuku i shprishur, e do të shpërndahen në ajër, në hapësirë.

"فَأَمَّهُ هَاوِيَةً ۝ وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ۝ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ"

"Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet). E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit)." Këtu Allahu i ndan njerëzit në dy grupe: 1. Ata të cilëve peshorja e veprave të mira u vije rëndë (nga veprat e mira të shumta), këta do të jenë të kënaqur me jetën në xhenet, nuk do të kenë lodhje, as zhurmë, as papastërti qoftë fizike apo shpirtërore, as sëmundje, as mërzi, as dëshpërim, as frikë etj.). 2. Ata të cilëve peshorja e veprave të mira u vije e lehtë (ose sepse nuk kanë asnjë vepër siç është rasti me jobesimtarët, sepse ata shpërblehen për veprat e mira sa janë në jetën e kësaj bote, nuk kanë dobi nga to në ahiret, ose kanë të mira por të këqijat janë më shumë, siç është rasti me besimtarët mëkatarë, të cilët janë lëshuar në mëkate dhe nuk janë penduar prej tyre dhe pastaj nuk u janë falur në Ditën e Gjykimit).

"هَٰوِيَةً – Hawijje" është humnerë e madhe, emër i zjarrit të xhehenemit (ose kuptimi tjetër: do të hidhet me kokë në zjarr).

"وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَ" - **Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehenemit)?**" Vjen në formë të pyetjes për ta zmadhuar frikën ndaj zjarrit të xhehenemit. Askush tjetër përveç Allahut nuk mund të ta shpjegojë dhe tregojë për realitetin e saj, sepse është një gjë e madhe.

نَارٌ حَامِيَةٌ - Ajo është një Zjarr i vrullshëm" - Nuk ka nxehtësi më të madhe sesa ai, është kulminacioni i nxehtësisë. Në këto ajete na frikëson Allahu dhe na paralajmëron të përgatitemi për këtë Ditë.

Surja Et Tekathur – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلْهَكُمُ التَّكَاثُرُ ۖ حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ ۖ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ۖ ثُمَّ كَلَّا
سَوْفَ تَعْلَمُونَ ۖ كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ ۖ لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ ۖ ثُمَّ
لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ ۖ ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ ۖ

1. Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar,
2. derisa të shkoni në varre.
3. Gjithsesi, do ta merrni vesh!
4. Madje, së shpejti do ta merrni vesh!
5. Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!
6. Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!
7. Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë.
8. Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!

Komentimi

"أَلْهَكُمُ التَّكَاثُرُ" - Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar" - na njofton dhe tregon gjendjen tonë, si njerëz. Jeni angazhuar aq shumë sa që keni kaluar në huti dhe i keni harruar ato që janë më obligative dhe më parësore për ju për t'i kryer, si: kryerja e adhurimeve, përmendja e Allahut. Me këtë ajet Allahu i drejtohet tërë njerëzimit, duke u përjashtuar nga

kjo ata të cilët janë angazhuar me çështjet e ahiretit e jo me ato të dunjasë. Të tillët janë të paktë. Janë hutuar prej qëllimit për të cilin janë krijuar, e që është adhurimi ndaj Allahut. Andaj, nuk duhet të angazhohemi me gjëra të cilat na largojnë prej këtij qëllimi.

Tekathur është garimi, rivaliteti për të shtuar, e që është ose në pasuri, ose në familje (farefis), ose në pozitë, ose në dije. Çdo gjë në të cilën ka lavdërim e mburrje ndaj njëri-tjetrit hyn në këtë ajet. Mirëpo, sa i përket shtimit në dije, kjo duhet sqaruar: nëse është fjala për dijen fetare atëherë kjo është mirë (hajër), e nëse është fjala për dijen jofetare atëherë kjo ose është e lejuar (mubah) ose e ndaluar (haram). Dhe shumica e njerëzve garojnë dhe mburren ndaj njëri-tjetrit në shtimin e dijes e cila është e ndaluar ose mubah.

حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ - derisa të shkoni në varre - derisa të vdisni.

Allahu na tregon se njeriu është i brumosur në këtë gjë, në natyrën e tij është angazhimi e rivaliteti në ato gjëra, deri kur të vdesë. Madje dijetarët thonë: *"Është e çuditshme ajo që sa më afër pleqërisë që është njeriu, i shtohen shpresat."* Është i habitur, i hutuar, nga çështjet e ahiretit, duke u angazhuar me çështjet e dunjasë. Njeriu vjetërsohet në vite dhe rinohet në shpresa.

Disa dijetarë i kanë dhënë këtij ajeti një kuptim tjetër, që është: aq shumë keni filluar të garoni e të mburreni ndaj njëri-tjetrit në shtimin e atyre gjërave saqë keni filluar të mburreni edhe me të vdekurit (p.sh. garimi në anëtarë të fisit duke numëruar edhe të vdekurit e tyre). Por, mendimi më i saktë është ai i pari.

Njerëzit kanë ardhur në këtë dunja të qëndrojnë përkohësisht dhe të sprovohen se cili do ta meritojë xhenetin e cili xhehenemin. Njeriu nuk do të qëndrojë përgjithmonë në këtë jetë, por kjo do të jetë një vizitë e shkurtë. Varri nuk është banesa ku do të qëndrojë përherë. Madje, një beduin pasi ka lexuar këtë ajet ka thënë: "*Ai që është vetëm vizitues, nuk do të qëndrojë përherë.*" Kjo tregon se ne gjithsesi do të ringjallemi (do të nxirremi prej varreve).

" كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ - Gjithsesi, do ta merrni vesh!

Madje, së shpejti do ta merrni vesh!"- dijetarët thonë se këto ajete kanë dy qëllime: 1. frenohuni, përmbahuni, mos vazhdoni në atë rivalitet, ngase kjo nuk do t'iu bëjë dobi në ahiret, 2. gjithsesi do ta merrni vesh e do të arrini të shihni fundin dhe përfundimin e çështjeve tuaja kur të ktheheni në ahiret, do ta merrni vesh se ai rivalitet nuk do t'ju bëjë dobi tek Allahu. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "**Prej pasurisë tënde nuk të përket asgjë përveç asaj që e ke konsumuar dhe e ke asgjësuar, ose asaj që e ke veshur dhe e ke grisur, ose asaj që e ke dhënë lëmoshë dhe me pasurinë tënde ke ecur përpara! Pjesa tjetër e pasurisë i mbetet tjetër kujt.**" Muslimi. Dhënia lëmoshë d.m.th. në të gjitha rrugët ku Allahu na ka obliguar ta japim pasurinë.

"Madje, së shpejti do ta merrni vesh!" - Allahu e konfirmon këtë edhe një herë. E përsëritë dy herë për ta konfirmuar dhe si qortim për t'u ndalë nga ajo gjë e cila huton nga qëllimi për të cilin është krijuar njeriu.

" كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ - Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!" D.m.th.: sikur ta dinit me dije të bazuar në

bindje do të arrini në përfundim se jeni në humbje. Mirëpo, njerëzve u mungon kjo dije, sepse shumica e tyre janë të hutuar e të pavëmendshëm pas çështjeve të kësaj jete.

"لَرَوْنُ الْجَحِيمِ" - Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!" -

Ky ajet nuk lidhet me ajetin para tij (duhet ndalur para se të nisë leximi i këtij ajeti). Kuptimi: Allahu betohet (kjo nënkuptohet) se do ta shihni xhehenemin. Xhehim është prej emrave të xhehenemit.

"ثُمَّ لَرَوْهَا عَيْنَ الْيَقِينِ" - Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigorisë" - këtu ka konfirmim përsëri. Njerëzit do ta shohin xhehenemin në Ditën e Gjykimit.

"ثُمَّ لَنَسْأَلَنَ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ" - Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!" - Kur të sillet xhehenemi në Ditën e Gjykimit dhe do ta shihni atë, të kapluar nga frika e madhe, atëherë do të pyeteni për dhuntitë e dhëna nga Allahu. Dijetarët kanë mospajtime se kujt i drejtohen këto fjalë, a besimtarit apo jobesimtarit. Por, që të dy do të pyeten për mirësitë e dhëna nga Allahu. Jobesimtarin e pyet në formë qortuese, kritike dhe dënuese; ai s'ka qenë i bindur ndaj Allahut me gjithë mirësitë e rrizkun që ia ka dhënë. Besimtarin e pyet në formë të kujtimit të të mirave që ia ka dhënë, në mënyrë që të gëzohet edhe më shumë (Ditën e Gjykimit). Kështu, besimtari arrin të kuptojë se Ai që ia ka dhënë këto mirësi në jetën e dunjasë, është Ai që ia jep edhe në ahiret (shpërblimin me xhenet). Përkundër tij, jobesimtarin kur e pyet për të mirat që ia ka dhënë, në

formë qortuese e dënuese, ai e humbet shpresën se do të ketë prej të mirave të Tij në ahiret.

Surja Asr – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَصْرِ ۝ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ۝ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ۝

1. Për kohën!
2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje,
3. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin

Komentimi

"**وَالْعَصْرِ - Për (pasha) kohën**" - Allahu betohet në kohën. Disa dijetarë kanë thënë se qëllimi me "asr" është fundi i ditës, ngase ajo është pjesa më e mirë e ditës, andaj dhe namazi i ikindisë quhet "salatul asr - namazi i asrit", të cilin dhe e ka quajtur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem "**namazi më i vlefshëm/mirë**", në hadithin te Buhariu dhe Muslimi.

Ndërsa, mendimi i dijetarëve të tjerë është se me asr është për qëllim vetë koha. Ky është mendimi më i saktë. Dhe Allahu betohet në kohën ngase në të ndodhin ndryshime të gjendjeve, rrotullohen çështjet, Ai ndërron gjendjet e tyre mes njerëzve.

Asr është koha në të cilën jetojnë krijesat. Nganjëherë në të ka mirëqenie e nganjëherë vështirësi, herë ka luftë e herë paqe, herë shëndet e herë sëmundje, nganjëherë njeriu vepron vepra të mira e nganjëherë të këqija etj.

Allahu betohet në kohën ngase njeriut nuk i është dhënë gjë më e vlefshme sesa ajo. Përmes saj e adhuron Allahun dhe arrin xhenetin- shpërblimin e Tij. Allahu pastaj tregon se pse betohet në kohën:

"إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ - Me të vërtetë, njeriu është në humbje" -

Insan është në formë të përgjithshme, duke përfshirë të gjithë llojin njerëzor, të gjithë njerëzit. Allahu sjellë një betim në kohën për të treguar gjendjen e njeriut si krijesë, se ai është në humbje. Khusur- është humbja apo mangësia. Njeriu vazhdimisht është në humbje dhe mangësi, në këtë botë dhe tjetrën, përveç:

"إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ" - përveç

atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin". Nuk thotë "i humbur", por thotë: **"në humbje"**, pra duke treguar se është i zhytur thellë në humbje, humbja e ka përfshirë atë nga të gjitha anët. Prej kësaj humbje përjashtohen ata të cilët i përshkruan me këto katër cilësi:

- 1. ata që kanë besuar,**
- 2. që kanë bërë vepra të mira,**
- 3. që këshillojnë njëri-tjetrin të vërtetën,**
- 4. që këshillojnë njëri-tjetrin për durim.**

Cilësia e parë: Besimi i bindur, i papërzier me dyshim apo mëdyshje (në gjashtë shtyllat e imanit).

Cilësia e dytë: Bërja e veprave të mira (si: namazi, zekati, agjërimi, haxhi, respektimi i prindërve, mbajtja e lidhjeve farefisnore dhe vepra të tjera të pakufizuara). Vepra e mirë

ka dy kushte: të jetë e sinqertë (për Allahun) dhe të jetë sipas sunetit.

Cilësia e tretë: Këshillimi për të vërtetën, për përmbajtje ndaj asaj, e cila është feja e Allahut.

Cilësia e katërt: Këshillimi për durim. Kjo ngase tri gjërat e para kërkojnë durim. Thirrja në fenë e Allahut kërkon durim të madh.

Imam Shafiu rahimehullah ka thënë: *"Po të mos zbriste Allahu argument tjetër, për robërit e Tij, përveç kësaj sureje, do t'iu mjaftonte atyre (si këshillë dhe nxitje për ato katër gjëra)."* Nuk është qëllimi se kjo sure do t'ju mjaftonte për të gjithë sheriatin e Allahut, por do t'ju mjaftonte për këto katër gjëra.

Surja Humeze – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ ۝ الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ۝ يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ۝ كَلَّا ۝
لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ۝ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ۝ نَارُ اللَّهِ الْمَوْقُودَةُ ۝ الَّتِي تَطْلُعُ عَلَى
الْأَفْدَةِ ۝ إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُّوَصَّدَةٌ ۝ فِي عَمَدٍ مُمَدَّدَةٍ ۝.

1. Mjerë për çdo përqeshës - shpifës,
2. që grumbullon pasuri dhe e ruan,
3. duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!
4. Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese.
5. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?
6. Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort,
7. i cili depërton deri në zemrën e njeriut.
8. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë,
9. në shtylla të gjata flakëruese.

Komentimi

"وَيْلٌ - Wejl" sipas disa dijetarëve është fjalë kërcënuese, kërcënim i pohuar dhe i konfirmuar për çdokënd që ka tipare të cilat do të jepen pas ajetit të parë. Disa dijetarë kanë thënë se wejl është një luginë në zjarr të xhehenemit, pra kërcënim për çdokënd që ka tiparet të cilat do të jepen pas ajetit të parë se i pret kjo luginë si ndëshkim. Mirëpo,

shejkh Uthejmin ka thënë se interpretimi i parë është më i saktë.

“وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ - Mjerë për çdo përqeshës - shpifës”. Këto dy fjalë tregojnë përgjithësim dhe janë cilësi përshkruese për dikë. Humezeh dhe lumezeh tregojnë për përqeshje, për tallje. Allahu e kërcënon atë person i cili përqeshet dhe tallet me të tjerët. Disa dijetarë kanë thënë se këto dy fjalë janë sinonime e disa të tjerë kanë thënë se dallojnë në kuptim. E sakta është se këto dy fjalë kanë kuptime të ndryshme. Humezeh është përqeshja me tjetrin përmes veprimeve, gjesteve, p.sh: shtrembërimi i fytyrës, nxjerrja e gjuhës, shkelja e syrit, bërja me shenjë, për përqeshje apo për të treguar se ka një mangësi (nëse është i shkurtë bën me duar) etj. Lumezeh është përqeshje përmes fjalëve.

“الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ” - që grumbullon pasuri dhe e ruan (e numëron)”, ky person ka bërë bashkë mes dy tipareve shumë të këqija: *grumbullon shumë pasuri dhe nuk e jep atë*, e ndal për vetveten, është koprrac, i privon të tjerët prej saj. Me "addede" është për qëllim numërimi, pra për shkak të dashurisë së madhe që ka ndaj pasurisë, shkon herë pas here apo shpeshherë tek arka e tij dhe i numëron paratë, në mëngjes, në mbrëmje; edhe pse e di se as nuk ka shtuar e as nuk ka pakësuar diçka prej saj, vazhdimisht kthehet te pasuria e tij, e shpeshton numërimin, nga dashuria e lakmia për të; apo vepron kështu që të ndjehet rahat e të gjejë prehje se pasuria e tij është ashtu siç ka qenë. Disa kanë thënë se "addede" d.m.th.: e ruan pasurinë, e grumbullon, e deponon për ditë të vështira, kur goditet nga skamja. Shejkh Uthejmin rahimehullah thotë: *"Edhe pse kjo fjalë"*

përmban këtë kuptim, është shumë larg së vërtetës. Kjo ngase grumbullimi e ruajtja e pasurisë për ditë të rënda ndërkohë që nxjerr prej saj atë që është obligim (zekatin ndaj atyre që kanë të drejta ndaj tij), atëherë lejohet... Qëllimi i ajetit është të tregojë se është i nënçmuar ai person i cili shqetësim e brengë kryesore e ka pasurinë saqë vazhdimisht kthehet tek ajo pasuri që e ka grumbulluar dhe e numëron.” Andaj, interpretimi se me këtë është për qëllim ruajtja e pasurisë për një kohë në të ardhmen kur është në vështirësi, është mendim i dobët.

"يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ" - duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm - se nuk do të zhduket e shkatërrohet kurrë. Mendon se do ta bëjë të pavdekshëm me trupin e tij (se nuk do të vdesë kurrë) apo me përmendjen e tij (se nuk do të vdesë kujtimi për të). Allahu përmend në këtë ajet se kjo çështje nuk është ashtu, ngase nëse njerëzit pasanikë nuk njihen në mesin e të tjerëve si dhënës e bujar, atëherë do të mbesin në kujtimin e tyre porse me kujtim të keq, pa lavdërim për të mirë, madje do të merren si shembull për të keq (do të thonë për të “Koprrac si filani...”). Jeta reale e njeriut është kur mbetet i pavdekshëm pas vdekjes së tij (përmendet për të mirë me zemër, me mendje e me gjuhë).

"كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ" - Jo, aspak! Në të vërtetë, do të hidhet në torturën shkatërruese - Pjesëza "kel-le" ka dy kuptime: 1. le ta ndalë veten e tij ai që mendon ashtu, mos të lakmojë në pasurinë e vet aq shumë, le ta frenojë veten nga mendimi se pasuria e tij do ta bëjë të pavdekshëm, 2. gjithsesi do të hidhet në hutame. Këto dy kuptime janë të sakta, ngase këtë njeri pasuria e tij as nuk do ta bëjë të pavdekshëm atë e as përkujtimin për të, por do të harrohet, apo dhe më keq

do ta kujtojnë për të keq, ngase nuk e ka dhënë atë që e ka pasur obligim nga pasuria e tij.

Këtu në ajet ka betim (të nënkuptueshëm), se do të hidhet fuqishëm në hutame. Kush do të hidhet në të, pronari apo pasuria e tij? Ngase në ajet ka ardhur e papërcaktuar kjo gjë. E sakta është se edhe ai dhe pasuria e tij do të hidhen në hutame.

Hutame - Është prej cilësive të zjarrit të xhehenemit, pra shkatërrim, thyerje dhe copëtim për atë që hidhet në të.

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ - **E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?** - Kur vjen në formë të pyetjes çështja zmadhohet, (në kuptimin) se nuk është gjë e lehtë hutame-ja.

نَارُ اللَّهِ الْمَوْقِدَةُ - **është zjarri i Allahut i ndezur fort** - Allahu ia atribuon zjarrin Vetes së Tij, ngase me zjarr vetëm Ai dënon e ndëshkon. Ai i dënon njerëzit me zjarr për shkak se ata e meritojnë këtë, kjo është drejtësi, ai është zjarr i drejtësisë e jo i padrejtësisë. Allahu është i drejti absolut.

الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْآفَاقَةِ - **i cili depërton deri në zemrën e njeriut** - për shkak të nxehtësisë së madhe që ka ky zjarr, edhe pse zemra është e ruajtur brenda në trup.

إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُّوَصَّدَةٌ - **Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë** - është i mbyllur, dyert e tij janë të mbyllura. Kur të hyjnë në të (ata që do të dënohen), dyert e këtij zjarri do të mbyllen e më nuk do të hapen.

"فِي عَمَدٍ مُمَدَّدَةٍ" - në shtylla të gjata flakëruese" - saqë askush nuk ka mundësi të bëjë hapje për të dalë që aty.

Duhet të kemi kujdes të mos biem në këto gjëra të këqija që tregohen në këtë sure.

Surja el Fil – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ ۝ أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ ۝ وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ ۝ تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ ۝ فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ ۝

1. "Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?
2. A nuk ua prishi atyre kurthin,
3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,
4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?
5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë.

Komentimi

- "أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ" - Vallë, a nuk ke parë ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?" - Allahu me këtë ajet i drejtohet Muhamedit salAllahu alejhi ue selem dhe (sipas një interpretimi edhe) umetit të tij. Këtu Allahu konfirmon se gjithsesi ka ndodhur ngjarja e njerëzve të elefantit, sikur ta shihnim me sytë tanë.

Njerëzit e elefantit kanë qenë banorë të Jemenit. Ata kishin ardhur me ushtri për ta shkatërruar Qaben. Me vete kanë marrë dhe një elefant të madh. Jemeni atëherë ka qenë nën sundimin e mbretit të Abisinisë, i cili ka qenë i krishterë. Përmes banorëve të Jemenit është përpjekur që të shtrojë ndikimin e tij në Gadishullin Arabik e të përhapë krishterimin në të. Arsyeja se pse e ka dërguar ushtrinë e

Jemenit që ta shkatërrojë Qaben ka qenë që t'i pengojë e ndalojë njerëzit nga kryerja e haxhit, sepse njerëzit vazhdimisht kanë bërë haxhin prej kur e ka ndërtuar atë Ibrahim i alejhisselam. Për t'i penguar njerëzit prej Qabes, ka ndërtuar një shtëpi në Jemen të ngjashme sikurse Qabja dhe ka bërë thirrje që të shkojnë ta kryejnë haxhin e tyre aty, e jo në Meke. Për këtë arabët janë zemëruar shumë. Njëri prej arabëve ka shkuar aty dhe ka kryer nevojën e madhe. Pastaj me të ka lyer dyert e asaj shtëpie. Kur e ka parë këtë gjë mbreti i Jemenit është zemëruar shumë dhe ka lajmëruar mbretin e Abisinisë i cili e ka urdhëruar të niset me ushtri me një elefant të madh që të shkatërrojë Qaben. Në disa transmetime thuhet se së bashku me këtë elefant kanë qenë edhe gjashtë të tjerë më të vegjël, për ta ndihmuar në shkatërrimin e saj. Dhe sipas pretendimeve të tyre, kanë ardhur për ta shkatërruar atë, mirëpo Allahu e ka ruajtur shtëpinë e Tij. Andaj, kur ka arritur kjo ushtri në vendin e quajtur Mugames, është ndalur elefanti, është ulur e nuk ka dashur të ecë përpara drejt Qabes. Sa herë janë munduar ta detyrojnë të ecë drejt saj, elefanti ka refuzuar, e nëse e kanë kthyer në drejtimin e kundër, pra kah Jemeni, ai ka ecur me vrap. Në momentin që e kanë kthyer kah Qabja, ai është ndalur. Këtë e transmeton ibn Kethiri. Kjo ka qenë shenjë prej Allahut për t'iu treguar atyre se janë gabim dhe se duhet të ndalen e të mos vazhdojnë tutje. Megjithatë, kanë këmbëngulur që gjithsesi të shkojnë ta shkatërrojnë Qaben. Andaj, Allahu u ka dërguar grupe të shumta të zogjve të cilët në sqepat e tyre kanë mbajtur nga një gur prej balte të pjekur, **"A nuk ua prishi atyre kurthin, duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh, të cilët i gjuajtën me gurë prej**

baltës së pjekur?" Dhe secili gur ka goditur nga një ushtar të ushtrisë së banorëve të Jemenit. Siç përshkruhet në transmetime, ky gur ka goditur kokën e personit dhe i ka dal prej poshtë (nga vrima anale).

"فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَأْكُولٍ" - Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë", si bima që thahet, e pastaj kafshët e përtypin, e ngrënë dhe e shkelin me këmbët e tyre.

Allahu kurthin e tyre e ka kthyer ndaj tyre. Kjo duhet të jetë mësim për çdokënd i cili mundohet t'i shkaktojë të keqe të vërtetës.

Allahu e ruajti Qaben nga shkatërrimi prej elefantit, ndonëse ka ardhur në transmetime se para Kiametit do të vijë një person i cili do ta shkatërrojë Qaben gur me gur, derisa ta rrafshojë të tërën, dhe ai është i Abisinisë. Pse Allahu nuk lejoi që herën e parë ta shkatërrojë Qaben mbreti i Abisinisë, ndërsa para Kiametit do ta lejojë këtë? Kjo për arsye sepse ngjarja e njerëzve të elefantit ka qenë si paralajmërim apo si parapërgatitje për ardhjen e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, se në atë vend do të vijë një njeri i madh, siç dhe ka qenë kjo e paralajmëruar në Librat e mëhershëm. Përmes asaj ngjarje ka dashur të tregojë se Qabja ka pozitë të lartë tek Allahu dhe se Ai e mbron atë. Po në vitin e elefantit ka lindur Muhamedi salAllahu alejhi ue selem.

Para shkatërrimit të Qabes, Allahu do të dërgojë një erë të lehtë dhe ua merr shpirtin të gjithë muslimanëve në tokë. Kur banorët përreth Qabes nuk e respektojnë atë (Qaben), e përdhosin dhe veprojnë mëkate të mëdha aty, atëherë Allahu i ndëshkon në këtë mënyrë dhe lejon që të

shkatërrohet ajo. Pastaj nuk zgjatë shumë dhe Allahu e bën Kiametin.

Surja Kurejsh – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ۖ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي ۖ
أَنْزَلَ الْقُرْآنَ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ ۖ
وَهُوَ الْكَافُّ ۖ وَالْكَافُّ ۖ وَالْكَافُّ ۖ
أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَعَامَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ ۖ

1. (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh,
2. për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë.
3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes),
4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.

Komentimi

“لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ - (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh” – Surja Kurejsh është e ndërlidhur me suren Fil (që është para saj). Në suren Fil u sqarohen banorëve të Mekës dhuntitë e shumta të cilat Allahu ua ka dhënë, prej tyre ishte dhe ruajtja prej ushtrisë së elefantit. Pastaj Allahu vazhdon në këtë sure të përmend të mirat e tjera.

Allahu e ka mbrojtur dhe ruajtur Qabenë prej shkatërrimit, në mënyrë që banorët e Mekës të kenë siguri të plotë (në mesin e Gadishullit ballkanik) e pastaj të mos mundet dikush t'i kërcënojë e t'i dëmtojë ndokush (nga që besonin se meqë Kurejshët kujdeseshin për Qabenë, Allahu i ruan, andaj nuk guxojmë t'i sulmojmë). Nëse Allahu do të lejonte

ushtrinë e elefantit të shkatërronte Qabenë atëherë pozita e Kurejshëve do të dobësohej te banorët e Gadishullit.

“إِلْفِهِمْ رَحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ - për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë” – me këtë është për qëllim tregtia që kanë bërë. Në dimër kanë udhëtuar për në Jemen, i cili ka pasur mot të përshtatshëm për të mbjella të drithërave, andaj kanë shkuar t'i blejnë e t'i sjellin në Meke. Ndërsa, në verë kanë udhëtuar në Sham, ngase moti ka qenë më i freskët gjatë verës (e jo nxehtësi e madhe sikur në Gadishullin arabik) dhe kanë blerë fruta prej tyre duke i sjellë pastaj në Meke (për banorët e saj). Ata kanë bërë këto dy udhëtime dy herë në vit dhe askush nuk i ka sulmuar e cenuar (kanë pasur siguri). Ka ndodhur që ndokush i cili nuk ka qenë prej Kurejshëve, për të qenë i sigurt gjatë udhëtimit, ka udhëtuar bashkë me ta për të tregtuar.

Këtu përmenden mirësitë e Allahut të cilat ua ka dhënë Kurejshëve përmes këtyre dy udhëtimeve, duke arritur interesa e dobi të mëdha nga kjo tregti. Fitimet që kanë marrë, ua kanë shpërndarë edhe të varfërve derisa janë pasuruar. Madje, disa kanë qenë të varfër, saqë kanë vdekur nga uria, e pastaj Allahu i bëri shkak këto dy udhëtime që banorët të pasurohen.

“فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ - Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie (Qabes)” – Kjo si falënderim e mirënjohje ndaj Allahut për ato mirësi e dhunti që ua ka dhënë, kjo është obligim, e jo të adhurojnë gjëra, idhuj, njerëz, engjëj, gurë, drunjë, shejtanë etj. Allahu ua ka dhënë ato të mira e ata të vazhdojnë të tjerë në vend të Allahut, apo të adhurojnë të tjerë me qëllim t'i afrojnë tek Ai e të ndërmjetësojnë për ta.

“kësaj Shtëpie” për qëllim është Qabja. Allahu do të tregojë pozitën e lartë të Qabes tek Ai.

“الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَءَامَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ” - i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike” – këtu përmenden dhuntitë e mirësitë e brendshme (uria) dhe të jashtme (siguria nga frika prej armiqve). Meka është vendi më i sigurt në tokë. Në të ndalohet:

- të priten drunjtë/pemët e saj,
- të këputet bari i saj,
- të përvetësohet sendi i gjetur,
- të bëhet gjueti me kafshët e saj,
- të derdhet gjaku.

Andaj, obligimi i Kurejshëve ndaj këtyre mirësive dhe i banorëve të sotshëm të saj, është të jenë falënderues e mirënjohës ndaj Allahut, duke kryer urdhrat e Tij dhe duke u larguar prej ndalesave/mëkateve.

Surja el Maun- Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَرَعَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ ○ فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ ○ وَلَا يَحْضُ عَلَى
طَعَامِ الْمِسْكِينِ ○ فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ ○ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ ○
الَّذِينَ هُمْ يُرَآءُونَ ○ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ ○.

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët
3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,
6. të cilët duan vetëm që të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

Komentimi

- أَرَعَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ - A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?" - Me këto fjalë i drejtohet çdokujt. Din - دين" nënkupton: shpërblimin dhe dënimin që ka përgatitur Allahu për njerëzit në Ditën e Gjykimit. Ata që e përgënjeshtrojnë këtë, janë ata të cilët nuk besojnë ringjalljen dhe e mohojnë atë.

- فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ - Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të

varfrit" - Në këto ajete tregon se kush është ai që e ka përgënjeshtuar Ditën e Llogarisë, pra ai që e dëbon ashpër jetimin dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit, d.m.th. ky person ka bërë bashkë mes këtyre dy gjërave të këqijave. Ky nuk tregon mëshirë e dhembshuri për jetimët, të cilët e meritojnë që njerëzit të tregojnë mëshirë ndaj tyre ngase kanë humbur baballarët dhe zemrat e tyre janë copëtuar nga kjo humbje. Jetim është ai të cilit i vdes babai para se të hyjë në moshën madhore. Allahu tregon se ai jo vetëm që nuk tregon mëshirë ndaj jetimit, por edhe e dëbon ashpër atë, e përzë me fuqi. I tilli, kur i vjen ndonjë jetim duke i kërkuar ndihmë a ndonjë gjë, apo i flet atij, e përzë dhe e dëbon ashpër. Përveç kësaj, nuk tregon mëshirë as ndaj të tjerëve: ndaj të varfërve. I varfri është nevojtar për ushqim. Dhe ai nuk nxit veten e as të tjerët për ta ushqyer të varfrin. Arsyeja e kësaj është sepse zemra e tij është e ngurtë si gur. Pastaj Allahu vazhdon të përmendë cilësitë e këtyre njerëzve:

- فَوَيْلٌ لِلْمَصَّالِينَ - Mjerë për ata, të cilët kur falen" - Fjala "wejl - وَيْلٌ" tregon për kërcënim të ashpër. Përmendet shpesh në Kuran. Njerëzit e tillë:

- الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ - janë të pakujdesshëm për namazet". Falen veçmas apo bashkë me njerëzit, porse ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm, nuk e falin siç duhet, në formën dhe në mënyrën më të mirë, apo e vonojnë, apo nuk e bëjnë rukun siç duhet, apo sexhden, apo qëndrimin në këmbë, apo uljen (teshehudin), duke mos i kryer siç kërkohet, apo nuk i lexojnë ato që janë obligim të lexohen në namaz, nga Kurani apo dhikret e pozitive etj., falen

porse nuk janë të përqendruar gjatë faljes, me zemër, kanë harresë ndaj namazit. Ky ajet përfshin shumë grupe të njerëzve, e jo vetëm dyfytyrëshit, të cilët falen sa për sy e faqe, për sy të botës.

Allahu i ka nënçmuar ata që tregohen harrestarë apo të shkujdesur ndaj namazit, kjo qëllimisht, për shkak të neglizhencës që kanë për namazin. Kurse harresa në namaz nuk është e nënçmuar (p.sh. harron sa rekate po fal, apo harron ndonjë obligim të namazit etj.). E prej shkujdesjes ndaj namazit është mosfalja në xhami me xhemat.

-الَّذِينَ هُمْ يُرَآءُونَ- të cilët duan vetëm që të duken". Edhe kjo është gjë e nënçmuar, pra kur adhurimet i kryen me qëllim që të afrohet te njerëzit, që të ketë vlerë e pozitive në shoqërinë ku jeton, e jo me qëllimin që të afrohet tek Allahu. I tilli, që bën dyfytyrësi (rija), kur jep lëmoshë ka për qëllim lavdërimin prej njerëzve dhe të thonë se sa bujar që është, apo kur fal namaz e zbukuron në atë mënyrë që njerëzit ta lavdërojnë e të thonë se sa mirë e fal namazin. Këta, origjinën e adhurimit e bëjnë për Allahun, mirëpo dëshirojnë që përmes këtij adhurimi njerëzit të thurin lëvdata për ta; këta me afrimin që ia bëjnë Allahut përmes adhurimit, kërkojnë të afrohen te njerëzit. Ndërsa, që adhurimi t'i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut në origjinë, atëherë kjo është shirk i madh, p.sh.: falja për një mbret apo dikë tjetër, diku i bërë ruku e sexhde atij, apo një varri, apo të vdekurit etj. Ai që bën kështu ka bërë shirk të madh, dhe nëse vdes në këtë gjendje kurrë nuk do të hyjë në xhenet.

Kjo gjë ndodhë më së shumti te dyfytyrëshit (munafikët). Allahu thotë: **“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të**

mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashton ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak."

Nisa 142. Ata ngritën për ta falë namazin, por janë neglizhentë e të shkujdesur ndaj tij, e falin me përtesë, dhe qëllimi i tyre është që të tjerët t'i shohin se po falen. Nuk lejohet që të kesh këtë tipar sikur të dyfytyrëshve.

Te ky ajet (i sures Maun) hyn dhe forma tjetër e dyfytyrësisë, që është: kur njeriu vepron një vepër me qëllim që të dëgjojnë të tjerët për të e ta lavdërojnë, p.sh.: lexon Kuran me zë të lartë dhe bukur në mënyrë që të tjerët ta dëgjojnë e pastaj ta lavdërojnë.

- "وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ - dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve". Ky ajet edhe pse është përkthyer kështu në shqip, fjala "maun - مَاعُونَ" nënkupton: enët, pra ua ndalojnë e nuk ua japin njerëzve enët e tyre, p.sh.: dikush i kërkon një kove, apo tepsi, apo tenxhere, apo një enë për të pirë ujë me të dhe nuk ia jep e nuk e ndihmon me këtë, apo enë me ushqim për nevojtarët. Kjo është njëjtë dhe kur dikush i kërkon një poç elektrik e nuk ia jep ta ndihmojë. Qëllimi është se nuk u ndihmojnë të tjerëve kur ata kanë nevojë. Edhe kjo gjë është e nënçmuar tek Allahu.

Mosdhënia apo pengimi i "maun-it" është dy lloje:

1. Kur me këtë veprim bën mëkat, p.sh.: kur dikush i kërkon ujë të pijë, i etur shumë gati për vdekje, e nuk i jep.
2. Kur nuk bën mëkat, porse e humbet një mirësi të madhe (nëse nuk e jep).

Secili duhet të shohë në veten e tij se a e posedon ndonjërin prej këtyre cilësive në mënyrë që të pendohet e të përmirësohet, se përndryshe, siç thotë Allahu: "wejl", e pret një kërcënim i ashpër dhe i madh prej Tij. E nëse nuk gjen nga këto cilësi te vetja, atëherë ta falënderojë Allahun.

Surja Keuther – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ ○ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَر ○ إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ ○

1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira,
2. andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!
3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë.

Komentimi

- **إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ** - "Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira". Këtu Allahu i tregon Muhamedit salAllahu alejhi ue selem për mirësitë e shumta që ia ka dhënë. Fjala "keuther - كَوْثَرٌ" nënkupton për mirësi të shumta, të mëdha. Allahu i ka dhënë atij mirësi të shumta në të dy botët. Prej këtyre mirësive është:

- *lumi i madh në xhenet i quajtur "Keuther"*, i cili është më i bardhë sesa qumështi, më i ëmbël sesa mjalti dhe me aromë më të mirë sesa e miskut. Gotat me të cilat besimtarët pinë prej tij, janë sikur yjet (janë shumë) dhe janë të bukura si ta. Dijetarët thonë se ai që ka pirë prej sheriatit të Allahut në këtë botë, do të pijë dhe prej burimit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në ahiret. Ai që s'ka pirë prej sheriatit të Allahut në këtë botë, nuk do të pijë as prej burimit të tij salAllahu alejhi ue selem në ahiret. Siç thotë

ibn Kajimi se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka dy burime: një në këtë botë që është suneti i tij dhe tjetri në botën tjetër, e ai që merr prej sunetit të tij në këtë botë (duke e zbatuar) do të pijë edhe prej burimit të tij në ahiret; ka që pinë, ka që privohen nga kjo (në këtë dunja dhe ahiret), ka që pinë shumë derisa të ngopen, ka që pinë pak. E kush ka pirë (marrë) shumë prej sunetit derisa është ngopur, edhe në ahiret do të pijë prej burimit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem derisa të ngopet. Kjo në varësi sesa njeriu ka punuar me sunetin profetik në këtë jetë.

- *Veçimi i tij me disa gjëra, siç ka thënë vetë ai në hadith: "Më janë dhënë pesë gjëra të cilat nuk i janë dhënë askujt prej Pejgamberëve para meje: ndihma ndaj armiqve me frikë një muaj përpara, bërja xhami (vendfalje) e tokës dhe pastrim, shefati (ndërmjetësimi), bërja të lejuar plaçkën e luftës dhe Pejgamberët e dërguar më herët janë dërguar vetëm te popujt e tyre e ndërsa unë jam dërguar për të gjithë njerëzimin."* Këto janë prej mirësive të Allahut që ia ka dhënë, sidomos kjo e fundit, gjë e cila tregon se ai salAllahu alejhi ue selem do të ketë më shumë pasues sesa Pejgamberët e tjerë para tij.

Kush i udhëzon njerëzit për një të mirë është si ai që e zbaton atë, pra ka shpërblimin si ai. E ai që e ka orientuar umetin islam është Muhamedi salAllahu alejhi ue selem. Prandaj, për çdo pjesëtar të këtij umeti atij i shkon një pjesë e shpërblimit, për çdo vepër që bën, ngase ai e ka udhëzuar dhe drejtuar umetin për tek çdo vepër e mirë. Edhe kjo është prej mirësisë së madhe që ia ka dhënë Allahu.

-*"Pozita e lavdëruar - El mekamu mahmud"*. Allahu e përmend në Kuran: **"Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar."** Isra 79.

- فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَرْ - andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!" Allahu kërkon prej Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem të jetë falënderues për këto të mira. Në urdhrin **"falu"** përfshihen të gjitha namazet, veçanërisht ai që shkon bashkë me therjen e kurbanit, e që është namazi i Bajramit. Ky urdhër përfshin namazet farze (të obligueshme) dhe ato nafile (vullnetare), si dhe namazin e Bajramit dhe namazin e xhumasë.

Në këtë ajet është fjala për therjen e veçantë që përdoret vetëm për devetë, ngase dobia që përfitohet prej deveve është shumë më e madhe sesa dobia që përfitohet prej lopëve e deleve. Devetë janë më të mëdha dhe del mish më shumë nga to (për të varfrit). Ky urdhër në këtë ajet vlen për të gjithë umetin islam. E kemi obligim që namazin ta bëjmë sinqerisht për Allahun dhe të therim kurbanin sinqerisht për Atë.

- إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ - Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë" - Karshi atyre të mirave të shumta që Allahu ia ka dhënë, i tregon Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem është se ai që të urren është fatprerë, nuk ka hajër në të, i janë ndërprerë të mirat. Kurejshët e Mekës thoshin se Muhamedi salAllahu alejhi ue selem është farësosur, nuk ka hajër në të as në pasuesit e tij; këtë e kanë thënë pas vdekjes së djalit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, Kasimit. Ata thoshin se edhe nëse i lindin djem, i vdesin, nuk i mbeten pasardhës. Allahu tregon këtu se fatëprerë e

farësosur është ai që e urren Muhamedin salAllahu aljehi ue selem. Tek i tilli nuk ka hajër, i janë ndërprerë të mirat e nuk ka kurrfarë bereqeti, është i pikëlluar e i dëshpëruar, edhe nëse shfaqet i lumtur e qeshë me zë. Njëjtë themi dhe për atë i cili e urren fenë (sheriatin) me të cilin ka ardhur Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, apo një shenjë prej fesë, apo një adhurim prej adhurimeve me të cilat ka ardhur ai dhe të cilin na ka mësuar (p.sh.: urren obligushmërinë e namazit, zekatit etj.).

Surja el Kafirun – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ﴿١﴾ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ﴿٢﴾ وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٣﴾ وَلَا أَنَا عَابِدٌ
مَا عَبَدْتُمْ ﴿٤﴾ وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٥﴾ لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ ﴿٦﴾

1. "Thuaj: "O ju mosbesimtarë!
2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni
3. dhe ju nuk adhuroni Atë që unë adhuroj.
4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni
5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!
6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"

Komentimi

Surja Kafirun njihet si njëra prej dy sureve të ikhlasit - sinqeritetit, vërtetësisë (e tjetra është surja Ikhlas). Quhen kështu sepse përmbajnë në vete sinqeritetin ndaj Allahut. Kur njeriu i lexon dhe beson përmbajtjen e tyre, kjo tregon për sinqeritetin e plotë ndaj Allahut. Gjithashtu, në to ka lavdërim ndaj cilësive të përsosura të Allahut.

- قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ - Thuaj: "O ju mosbesimtarë!" Së pari, Allahu i drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem me këto fjalë që ai t'iu drejtohet jobesimtarëve, të shpallë tek ta e të thotë "O ju jobesimtarë!", pra t'i thërrasë ata. Kjo

përfshin të gjitha llojet e jobesimtarëve: paganë, hebrenj, të krishterë, komunistë etj. Muslimani e ka për obligim, me zemër e gjuhë, t'i drejtohet e t'i tregojë jobesimtarit që e ka afër se ai është i distancuar dhe i shfajësuar prej tij dhe prej adhurimit të përzier me shirk që ia drejton Allahut, duke i thënë:

لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ مَا أَعْبُدُ وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ وَلَا أَنْتُمْ عِبُدُونَ - " - Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni dhe ju nuk adhuroni Atë që unë adhuroj. Unë nuk do të jem kurrë adhurues të atyre që ju i adhuroni dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!" - Këtu shohim se ka përsëritje të fjalive. Qëllimi me "nuk adhuroj çfarë ju adhuroni" d.m.th.: idhujt, që adhuroni në vend të Allahut, ndërsa me "dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj" për qëllim është Allahu.

Ajetet 2 dhe 3 tregojnë për veprën, për folje (nuk adhuroj dhe as ju nuk adhuroni). Ndërsa, shejkhul Islam ibn Tejmije rahimehullah lidhur me përsëritjen (ajeti 4 dhe 5) ka thënë se *qëllimi është pranimi*, pra se unë nuk pranoj përveçse adhurimin tim dhe as ju nuk e pranoni adhurimin tim që ia drejtoj Allahut, unë nuk i adhuroj idhujt dhe as nuk jam i kënaqur me adhurimin që ia kushtoni atyre dhe as ju nuk e adhuroni Allahun të Vetmin dhe as nuk jeni të kënaqur me adhurimin tim që ia kushtoj Atij.

(Në Kuran, te përsëritjet ka dobi të mëdha dhe ato nuk bëhen kot pa kurrfarë dobie).

-لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ- " - Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!" Ju keni fenë tuaj në të cilën jeni dhe me të cilën e

adhuroni Allahun, ndërsa unë kam fenë time, jam i pastër prej fesë tuaj, i distancuar, njashtu dhe ju jeni të distancuar nga feja ime me të cilën e adhuroj Allahun.

Kjo sure përmban pastrim e distancim prej adhurimit ndaj dikujt tjetër përveç Allahut, qoftë nëse kjo ka të bëjë me ata që adhurohen në vend të Allahut apo me vetë llojin e adhurimit. Në këtë sure ka singëritet të plotë për Allahun, se nuk na lejohet të adhurojmë dikë tjetër së bashku apo krahas me Allahun, ngase Ai është i Vetmi dhe nuk ka ortak.

Surja Nasr - Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ۖ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا ۖ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ۝

1. "Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)
2. dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe,
3. atëherë madhëroje me lavëdrim (e falënderim) Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.

Komentimi

- "إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ - **ndihma e Allahut**" nënkupton: ndihma e Allahut ndaj dikujt për të triumfuar ndaj armikut e për të ngadhënjyer. Ndihma dhe triumfi është gëzimi më i madh që e arrin njeriu (në rastin kur kjo bëhet me të drejtë). Allahu ia përmend në këtë ajet Pejgamberit salAllahu alejhu ue selem ndihmën dhe triumfin që ia ka dhënë ndaj armikut (mushrikëve).

- "وَالْفَتْحُ - **dhe çlirimi**". Edhe pse së bashku me ndihmën ka ardhur çlirimi, Allahu këtu në ajet, çlirimin e renditë pas ndihmës, për të potencuar rëndësinë që ka pasur ky çlirim dhe pozitën e madhe tek Ai. "**Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi**" për të treguar se ky çlirim nuk është sikur

çlirimet e tjera, ka një pozitë më të veçantë e një vlerë më të madhe. Sahabët e kanë ditur se për qëllim është çlirimi i Mekës.

Allahu ia ka mundësuar Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem të çlirojë Mekën në vitin e tetë hixhri. Ai salAllahu alejhi ue selem ka bërë marrëveshje të paqes me Kurejshët, në Hudejbije, në vitin e gjashtë hixhri. Mirëpo, Kurejshët e kanë thyer këtë marrëveshje. Andaj Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka përgatitur ushtri dhe ka shkuar për ta çliruar Mekën. Ka dal prej Medinës me dhjetëmijë ushtarë, fshehtas, dhe ka hyrë në Meke si fitues e triumfues. Mushrikët e Mekës janë mbledhur rreth tij (rreth Qabesë, ku ka qenë), dhe pasi ka fal dy rekate në Qabe, ka dal te dera e saj i mbështetur në të dy anët e derës dhe ka thënë: **"O grumbull i kurejshëve! Çfarë mendoni se do të bëj tash me ju?"** Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem kishte ikur prej Mekës para tetë vitesh, ngase mushrikët e kishin kërcënuar me vrasje, me burgosje, me gjëra të frikshme, e ndërsa tash ishte kthyer si triumfues dhe me mundësinë të bëjë çfarë të dojë me ta. Ata i thonë: *"Mendojmë se do të veprosh mirë. Ti je vëlla fisnik dhe biri i një vëllai fisnik."* Atëherë ai u ka thënë: **"Unë ju them ashtu siç iu tha Jusufi vëllezërve të tij: "S'ka qortim për ju sot. Allahu ua fal juve (Jusuf 92)." Shkoni se jeni të lirë!"** Allahu këtë çlirim e ka quajtur "fet'han mubine - çlirimi i qartë", siç thotë në Kuran: **"Ne të dhamë ty një çlirim (fitore) të qartë..."** Fet'h 1. Kur njerëzit e panë këtë çlirim të Mekës, duke arritur (muslimanët) të marrin kryeqytetin e kurejshëve, e cila ka qenë qendra kryesore e tyre, e kuptuan se përfundimi i lumtur i takon Muhamedit salAllahu alejhi ue selem dhe

shokëve të tij dhe se roli i Kurejshëve ka mbaruar (s'kanë më ndikim dhe rrënjë në jetën e banorëve të Gadishullit arabik).

- وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا - dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe". Fillimisht njerëzit para këtij çlirimi hynin në fe individualisht, madje në disa raste edhe fshehtas. Ndërsa, pas këtij çlirimi njerëzit hynin në fe grupe-grupe; vinin delegacione (prijës të fiseve me parinë e tyre) të shumta në Medinë te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem për të pranuar Islamin, saqë ky vit (viti i nëntë) është quajtur "Viti i delegacioneve".

- فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا - atëherë madhëroje me lavdërim (e falënderim) Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve". Pas këtyre mirësive të shumta të dhëna nga Allahu, mendja njerëzore do të thoshte "atëherë falëndero Allahun", mirëpo Allahu thotë **"madhëroje (lartësoje) me lavdërim (e falënderim) Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai"** (tesbih me hamd dhe istigfar). Nëse mediton në këtë, do të arrish urtësinë se pse Allahu e urdhëron Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem ta bëjë tesbih Atë. Pra, pasi arrite çlirimin e Mekës dhe triumfin, kjo tregon se të është afruar vdekja, andaj nuk të ka mbetur tjetër veçse ta bësh tesbih Allahun së bashku me hamd (subhanekAllahu ue bihamdike) dhe të bësh istigfar.

Tesbih: Lartësim dhe pastrim ndaj Allahut, nga të gjitha të metat (që mund t'i vishen). Këtë duke e shoqëruar me hamd: lavdërim ndaj Allahut, për cilësitë e Tij të përsosura, me dashuri e madhërim ndaj Tij.

-*Istigfar*: Kërkim i faljes (magfiretit) tek Allahu, pra kërkim që Ai të t'i mbulojë mëkatet, dhe përveç kësaj edhe t'i shlyejë (mos të dënojë për to).

Surja Mesed – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ ۝ مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ ۖ وَمَا كَسَبَ ۝ سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ
لَهَبٍ ۝ وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ ۝ فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ ۝

1. Iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit dhe u shkatërroftë i tëri!
2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.
3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,
4. po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,
5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.

Komentimi

Kjo sure është prej sureve provë që tregojnë se Muhamedi salAllahu alejhi ue selem është i Dërguar i vërtetë. Në këtë sure tregohet se Ebu Lehebi (xhaxhai i tij) gjithsesi do të vdesë si jobesimtar dhe se do të jetë i shkatërruar. Ashtu dhe ka ndodhur. Kjo sure ka zbritur sa ka qenë ai gjallë. Madje, atij, Ebu Lehebit, nuk i ka shkuar kurrë nëpër mendje të thotë rrejtshëm "jam bërë musliman" në mënyrë që me këtë të tregonte (gjoja) se Muhamedi salAllahu alejhi ue selem nuk e thotë të vërtetën, pra që ta përgënjeshtronte këtë sure.

Ebu Lehebi e ka luftuar dhe kundërshtuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem deri në momentet e fundit të jetës së vet. Pikërisht për të, Allahu ka zbritur sure, e cila do të lexohet deri në Ditën e Gjykimit.

Me këtë sure, Allahu i kundërpërgjigjet vetë Ebu Lehebit. Kur Allahu ia ka zbritur Kuranin Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem e ka urdhëruar që të thërrasë haptazi (ngase fillimisht ka thirrur fshehtazi). Dhe ka thirrur haptazi, parinë e Kurjeshëve, në fjalën La ilahe ilahe ilAllah, i ka përgëzuar ata që i përgjigjen kësaj thirrje dhe i paralajmëruar ata që e kundërshtojnë atë. Ebu Lehebi ka thënë: "Qofsh i shkatërruar! A për këtë na ke mbledhur?!" Në këtë mënyrë ka dashur ta nënçmojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe thirrjen e tij. D.m.th.: A për këtë gjë kaq të ulët na ke mbledhur? Kjo është gjë aq e ulët saqë nuk meriton të mbledhësh parinë e Kurejshëve. Andaj, Allahu ka zbritur këtë ajet **"Iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit dhe u shkatërroftë i tëri!"** si kundërpërgjigje ndaj tij.

Kunja e tij ka qenë: Ebu Leheb, që do të thotë: *Babai i flakëve të mëdha*. Këtu dhe ka përshtatshmëri mes gjendjes së tij dhe përfundimit të tij. Ky njeri do të jetë në një zjarr të ndezur fortë, me flakë të mëdha, që përcëllojnë. Kunja e tij përshtatet me gjendjen dhe përfundimin e tij (zakonisht emri përputhet me veprën).

- ثَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ - Iu shkatërrofshin duart Ebu Lehebit dhe u shkatërroftë i tëri!" - Së pari Allahu filloi me dy duart e Ebu Lehebit, ngase me duar njeriu vepron, merr, jep, ato janë prej gjërave kryesore me të cilat punon e vepron.

مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ - **Nuk do t'i bëjnë dobi as pasuria dhe ajo që ka fituar.**" Ky ajet interpretohet në dy mënyra: a) pjesëza 'مَا - mee' është pyetëse, që nënkupton: "Çfarë i bëri dobi atij pasuria dhe ajo që ka fituar?!" Pra, qëllimi është: Asgjë. b) pjesëza 'mee' është mohore, që nënkupton: Nuk do t'i bëjë dobi asgjë pasuria dhe ajo që ka fituar. Të dy këto interpretime janë të ndërlidhura dhe e shoqërojnë njëra-tjetrën. Pasuria dhe fitimet e tij nuk do t'i bëjnë dobi atij, edhe pse zakonisht i bëjnë dobi njeriut, p.sh.: shpenzimet për ushqim, ilaçe etj. Por, pasuria nuk i bën dobi njeriut për të shpëtuar nga zjarri i xhehenemit, askujt.

وَمَا كَسَبَ - **ajo që ka fituar**". Këtu përfshihet çdo gjë nga e cila përfiton: fëmijët, pasuria, pozita etj. Përfshihet çdo gjë përmes së cilës arrin fuqi, forcë, pozitë dhe vend në zemrat e njerëzve. Të gjitha këto nuk bëjnë dobi tek Allahu, nuk e ndihmojnë asgjë për të shpëtuar nga zjarri.

سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ - **Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara**"- d.m.th. do të dënohet gjithsesi dhe është afër kur do të dënohet. Kjo do të ndodhë afër dhe arsyeja për këtë është se kënaqësia e kësaj bote dhe qëndrimi në të është shumë i shkurtër, sado që ai të jetojë gjatë, ahireti për të është afër.

وَأَمْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ - **po ashtu edhe gruaja e tij, bartësja e druve**"- të njëjtën gjendje do ta ketë edhe ajo. Gruaja e Ebu Lehebit ka qenë prej grave më të ngritura të Kurejshëve, prej fiseve më të njohura. Mirëpo, kjo nuk i bën dobi tek Allahu përderisa ka qenë bashkëpjesëmarrëse me burrin e saj në armiqësi ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem,

Dhe së bashku të dytë, burrë e grua, kanë vdekur në mohim (kufër).

"bartësja e druve"- Allahu e përmend atë në këtë formë duke treguar nënçmim ndaj saj. Ajo ka bartë shumë dru. Ka shkuar në shkretëtirë për të mbledhur dru, pastaj i ka bartur dhe i ka vendosur nëpër rrugën ku ka ecur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Në ato dru ka pasur edhe gjemba. Nga urrejtja e madhe ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i ka vendosur në rrugën ku ai ka ecur me qëllim që t'i shkelë e t'i hyjnë në këmbë e ta lëndojnë.

"فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ" - në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme." Ajo me këtë litar në qafë ka shkuar në shkretëtirë, siç treguam. Një grua e ngritur, e megjithatë e ka nënçmuar veten e saj duke dal në shkretëtirë të mbledhë dru (që ta lëndojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem).

Surja el Ikhlas – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝

1. "Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!"
2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.
3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.
4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

Komentimi

Shkaku i zbritjes së kësaj sure: Kanë ardhur hebrenjtë te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe i kanë thënë: "Na përshkruaj Zotin tënd!" Atëherë Allahu e ka zbritur këtë sure.

- "قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ - Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!"

Me këtë ajet Allahu i drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhu ue selem dhe umetit të tij që të thonë: "**Thuaj: "Ai Allahu është Një dhe i Vetëm"**". Allahu për të cilën po bisedoni është Ehad - Unik, në madhësinë dhe lartësinë e Tij, nuk ka dikush që t'i përngjajë apo t'i shëmbëllej Atij, Ai nuk ka ortak, Ai është Unik në Qenien e Tij, Ai është Unik në Rububije - në Zotërim, Ai është Unik në uluhije - i Vetmi i Cili meriton adhurimin dhe Ai është Unik në Emrat dhe

Cilësitë e Tij- askush nuk i shëmbëllen dhe nuk i përngjason Atij.

- **“اللَّهُ الصَّمَدُ”** - Rreth domethënies së kësaj ka interpretime të shumta prej dijetarëve. Mirëpo, kuptimi më i denjë është: Allahu është i përsosur në Cilësitë e Tij. Es Samed d.m.th.: Absoluti i Përsosuri në Cilësitë e Tij, Ai për të Cilin të gjitha krijesat kanë nevojë, janë nevojtare për Atë. Ibn Abasi ka thënë: *“Samed d.m.th.: i Përsosur në Dijen e Tij, i Përsosur në butësinë e Tij, i Përsosur në Plotfuqishmërinë e Tij, i Përsosur në Forcën e Tij...”* Duke dashur të tregojë se Allahu është i Përsosur në të gjitha cilësitë dhe atributet e Tij. Duke qenë se Allahu është i Përsosur dhe absolut në Cilësitë e Tij, kjo tregon se Ai është i Vetëmjaftueshëm, nuk ka nevojë për askënd prej krijesave të Tij.

- **لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ - Ai as nuk lind, as nuk është i lindur**". Ai nuk ka lindur dikë, për arsye se Ai nuk ka dikë që është i barabartë me të, nuk ka dikë që i shëmbëllen Atij a i krahasueshëm me Atë. I linduri rrjedh prej prindërve dhe është pjesë e tyre. Duke qenë kështu, ai është i njëjtë me ta, u përngjason atyre, është i krahasueshëm me ta. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për Fatimen: **"Ajo është një pjesë e imja."** Fëmija i përngjan prindit. E Allahu nuk ka dikë që i shëmbëllen apo që është i ngjashëm me Atë. Pastaj, njeriu zakonisht ka nevojë që fëmija i tij ta ndihmojë në vështirësitë që has apo që të mbetet vija trashëguese. Ndërsa, Allahu nuk ka nevojë për asgjë prej këtyre gjërave. Allahu është i Vetëmjaftueshëm. Është e palogjikshme që Ai të ketë fëmijë, **"Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka**

bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Dijshëm për çdo gjë." Enam 101.

Me këtë pjesë të ajetit, Allahu u kundërpërgjigjet:

-mushrikëve, të cilët kanë thënë se engjëjt janë bijat e Allahut,

-hebrenjve, të cilët kanë thënë se Uzejri është biri i Allahut,

-të krishterëve, të cilët kanë thënë se Isa është biri i Allahut.

-**"وَلَمْ يُولَدْ - as nuk është i lindur"**- Allahu është i Pari, pa fillim, askush nuk i ka paraprirë Atij. Atëherë si ka mundësi që Ai të jetë i lindur?! Ai as nuk ka lindur as nuk është i lindur.

-**"وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ" - Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"** – Kjo në të gjitha Cilësitë e Tij. Ai e lartëson Vetën e Tij nga të qenët prind që lind, apo nga të qenët i lindur, apo të ketë dikë të ngjashëm a të krahasueshëm me Atë.

Kjo sure ka vlerë shumë të madhe. Prandaj, Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë për të: **"Ajo është e barabartë me një të tretën e Kuranit."** Buhariu dhe Msulimi. Ajo është aq madhështore, me vlerë të madhe, që përmbledh kuptime e dobi të mëdha që kanë të bëjnë Cilësitë e Allahut, saqë është e barabartë me një të tretën e Kuranit.⁵ Nuk e zëvendëson një të tretën e Kuranit, por është e barabartë në vlerë.

⁵ Nga kjo nuk nënkuptohet se nëse dikush e lexon tre herë suren Ihlas është sikur të lexojë tërë Kuranin dhe se nuk ka nevojë ta bëjë hatme.

Surja el Felek – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ شَرِّ
النَّفَّاثِ فِي الْعُقَدِ ۝ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝

1. Thuaj: “Kërkoj mbrojtje/strehë te Zoti i agimit,
2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar
3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri
4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)
5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.

Komentimi

- **قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ** - Thuaj: “Kërkoj mbrojtje/strehë te Zoti i agimit”- Zoti i agimit është Allahu. Felek d.m.th. kur diçka çelë. Disa dijetarë kanë thënë se për qëllim është agimi, e disa të tjerë kanë thënë se është çdo gjë që çelë, si: agimi, farat, kokorrat e ndryshme (prej drithërave).

- **مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ** - nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar”- Nga sherri i çdo krijese. Këtu hyn dhe sherri i shpirtit (nepsit) tonë, i cili është i prirë për të keq, që e shtyn njeriun drejt të keqes dhe kështu njeriu vazhdimisht gjendet në një luftë me shpirtin e tij. Gjithashtu përfshihen njerëzit, shejtanët, xhindët, kafshët etj.

- وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ - dhe nga sherri i natës (dhe i hënës), kur kaplon terri" – Disa dijetarët kanë thënë se me “غَاسِقٍ” është për qëllim nata, e disa kanë thënë se është për qëllim hëna. Porse, përfshihen të dyja: nata dhe hëna. Gjatë natës dalin kafshë të ndryshme, shpërndahen shejtanët dhe magjistarët. Andaj, kërkojmë prej Allahut të na mbrojë prej të keqes së natës, ngase të këqijat më të mëdha bëhen gjatë saj. Ndërsa, pse hëna quhet “غَاسِقٍ” është sepse ajo mban pushtetin gjatë natës, ndriçon gjatë saj. Qëllimi është: të na ruajë Allahu prej të këqijave që bëhen gjatë natës.

- وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ - dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)"- lidhin nyje, litarët e penjtë, fryjnë në to dhe përmendin fjalë të ndryshme magjike, emra shejtanësh etj. Ajo frymë është e keqe, e fëlliqur, kur bëhet bashkë me atë që përmendet, atëherë godet personin e caktuar (që e kanë për qëllim). Kjo magji ndikon realisht te personi që i bëhet magji.

Këtu përmendet shumësi i femërores "nef-fathat" (në arabisht), ngase zakonisht ato që bëjnë magji janë gra, por gjithsesi këtu përfshihen edhe ata burra që veprojnë kështu. Gjithashtu dijetarët thonë se me këtë fjalë është për qëllim frymëmarrja a pështyma që nxirret nga magjistarja apo magjistari duke fryrë në nyje.

- وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ - dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë." Smirëziu është ai i cili e urren dhe nuk e do të mirën a dhuntinë të cilën Allahu ia jep dikujt, andaj ndihet keq, ngushtohet në zemër, tregon smirë e zili. Ziliqari është dy llojesh: 1. Ai që e urren me zemër mirësinë e dhënë ndaj dikujt por që nuk shfaq armiqësi ndaj tij apo t'i

bëjë keq, megjithatë brengoset, dëshpërohet, ngushtohet, se pse Allahu ia ka dhënë atë të mirë atij, 2. Ai që e urren mirësinë e dhënë ndaj dikujt por edhe vepron: e armiqëson dhe e kundërshton tjetrin.

Zakonisht zilia (hasedi) shoqërohet me përgojim (gibet), me tallje, me përqeshje, e ndoshta dhe me shpifje. E keqja kthehet te vetë ziliqari. Mirëpo, zilia e tij (me këtë urrejtje e mospëlqim) mund të bëhet shkak që personi tjetër të goditet me mësysh (me lejen e Allahut), andaj dhe ka ardhur në ajet "**nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë**".

Të gjitha të këqijat janë në njërën prej këtyre tre llojeve: nata, magjistari (fallxhori) dhe ziliqari, dhe në mënyrë të fshehtë.

Mënyra e shpëtimit prej këtyre tre të këqijave:

- lidhja e zemrës fort për Allahun,
- mbështetja plotësisht në Allahun, duke ia dorëzuar çështjet Atij,
- veprimi i shkaqeve (dhikri i ligjshëm).

Surja en Nas – Komentim

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ۝ مَلِكِ النَّاسِ ۝ إِلَهِ النَّاسِ ۝ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ۝
الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ۝ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ۝.

- 1."Thuaj: "Kërkoj mbrojtje/strehë te Zoti i njerëzve,
 2. Sundimtari i njerëzve,
 3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,
 4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)
 5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,
 6. (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!"
-

Komentimi

- قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ - Thuaj: "Kërkoj mbrojtje/strehë te Zoti i njerëzve" - Allahu është Zoti i njerëzve, i engjëjve, i xhindëve, i qiejve dhe i tokës, i diellit dhe i hënës, i çdo gjëje. Por, për shkak të një urtësie këtu i veçon njerëzit.

- مَلِكِ النَّاسِ - Sundimtari i njerëzve" - Atij të Cilit i takon sundimi më i lartë, veprimi i plotë i pakushtëzuar dhe i pakufizuar në univers.

- إِلَهِ النَّاسِ - i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve" - Ilah- I Adhuruari. Për qëllim është meluh dhe meabud, i Adhuruari me të drejtë. Kur zemrat e njerëzve e njohin Allahun siç duhet, atëherë do ta adhurojnë me dashuri dhe madhërim.

- **مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ** - nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)". Cytje (vesvese) si: iluzione, dëshira të kota, imagjinata, gjëra jo reale, jo ekzistuese etj. **"Që fshihet"**, që largohet, e kthen shpinën, kur përmendet Allahu. Pra, djalli bën cytje, e në momentin që përmendet Allahu, ai ikën, largohet.

- **الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ** - e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve", në zemrat e tyre.

- **مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ** - (qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve!" Sa i përket cytjeve të djajve prej xhindëve, kjo është e njohur, ndërsa djajtë prej njerëzve sot janë të shumtë, të cilët i zbukurojnë devijimet, të këqijat, mohimin, idhujtarinë etj., saqë këto i depërtojnë njeriut në mendjen dhe zemrën e tij. E pastaj kur të arrijnë qëllimin e tyre largohen, pra ata janë khanas.

Suren Iklas, Felek dhe Nas, Pejgamberi salallahu alejhi ue selem i lexonte kur shtrihej për të fjetur (në gjumin e natës). Ai ka bashkuar shuplakat e duarve, ka lexuar këto sure dhe ka fryrë në to dhe pastaj ka fërkuar fytyrën e trupin. Këtë e ka bërë tre herë. Gjithashtu ato i ka lexuar pas çdo namazi farz. Prandaj, është mirë që ne të veprojmë me këto sunete.

Ky material i transkriptuar nuk është i kontrolluar nga hoxha.